

UNITED  
NATIONS  
United Nations  
Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**TRANSKRIPTI  
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË  
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 30.11.2006**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE DANA 30.11.2006.GODINE**

---

***NENTOR – NOVEMBAR 200***

## **RENDI I DITËS**

- 1. Koha për pyetje parlamentare dhe**
- 2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2007.**

## **ДНЕВНИ РЕД**

- 1. Време за посланичка питања,**
- 2. Прво разматрање Нацрта закона о буџету Косова за 2007.годину.**

## **AGENDA**

- 1. Time for parliamentary questions,**
- 2. First reading of the Draft Law for the Budget of Kosovo for 2007.**

## **Seanca plenare u mbajt në sallën e Kuvendit të Kosovës**

### **Mbledhjen e kryesoi kryetari i Kuvendit Kolë Berisha**

#### **Mbledhja filloi në orën 10.**

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Të nderuar deputetë, i nderuari zëvendësministër dhe ministra të kabinetit qeveritar, mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë momentalisht janë 80 deputetë, prandaj janë plotësuar kushtet që të mund t'ia fillojmë punës.

Në pajtim me rregullat 6 dhe 23 të Rregullores së punës Kryesia e Kuvendit ka përgatitur dhe Kuvendit ja ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare sipas ftesës që u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Fjalën e ka z. Ferid Agani

**DEPUTETI FERID AGANI** – Faleminderit z. kryetar. Të nderuar kolegë deputetë, të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar. Grupi Parlamentar për Integrim i mbështetur edhe nga disa deputetë nga grupet e tjera parlamentar, e ka parashtruar kërkesën me shkrim që në këtë seancë plenare të shqyrtohet si pikë e veçantë e rendit të ditës çështja e shtyrjes së vendimit për përcaktimin e statusit politik të Kosovës. Kjo kërkesë i është dorëzuar Kryesisë së Kuvendit në procedurë të rregullt dhe grupi ynë parlamentar pret se Kuvendi të deklarohet rreth kësaj kërkesë në bazë të rregullës 23 pika 2 dhe që me këtë të mundësitet që Kuvendi i Kosovës të informohet fillimisht nga anëtarët e Grupit të Unitetit për rrjedhat e procesi. Në këtë aspekt të zhvillohet një debat lidhur me këtë çështje për implikimet e këtij vendimi dhe të nxirren përfundime përkatëse. Ju faleminderit !

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Kryesia i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e tjera dhe kërkesën tuaj, por është përcaktuar për sot që të debatohet rreth buxhetit të Kuvendit. Kjo kërkesë do të jetë në njëren prej seancave të ardhshme dhe do të procedohet për të.

Fjalën e kërkon z. Agani.

**DEPUTETI FERID AGANI** – Z. kryetar mendoj se Rregullorja e punës është shumë e qartë në këtë aspekt. Vendimin lidhur me atë se a do të jetë një pikë e veçantë e rendit të ditës si çështje e trajtimit në Kuvend të Kosovës nuk e merr Kryesia e Kuvendit të Kosovës, por Kuvendi i Kosovës, atëherë kur parashtrohet nga një grup prej së paku 6 deputetëve. Pra Rregullorja është shumë e qartë në këtë aspekt, prandaj ju kisha lutur që kërkesën e grupit tonë parlamentar ta qitni në votim në Kuvendin e Kosovës.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Kryesia e përcakton rendin e ditës, po e përsëris edhe një herë se kjo do të procedohet në seancën e ardhshme plenare, por jo sot, sepse pika të cilën e kemi shtruar sot kërkon një kohë më të gjatë.

Fjalën e ka z. Xhemajli.

**DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI** - Kryetar i Kuvendit të Kosovës edhe çka ende duhet me ndodhë në Kosovë që Kryesia e Kuvendit të zgjohet nga gjumi dhe ta shohë realitetin

në fytyrë, në sy në Kosovë dhe ta ftojë këtu Grupin Negociator të japë llogari. E dini shumë mirë që ky grup ka qenë këtu, por asnjë rekomandim nuk i është dhënë nga Kuvendi i Kosovës. Ju lutem të ndërpritet seanca dhe të merremi vesh që të thirret Grupi Negociator dhe të vazhdojmë ashtu siç e tha edhe deputeti Agani. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BEERISHA** – Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

**DEPUTETI ALUSH GASHI** – I nderuari z. kryetar. Jua përkujtoj se si Kuvend i Kosovës më 17 nënëtor të vitit 2005 e ka miratuar një rezolutë ku në mënyrë të përpiktë është përcaktuar në një farë forme mandati i Delegacionit të Unitetit. Ne si grup parlamentar qëndrojmë fuqimisht, me zbatim në përpikëri të të gjitha pikave të rezolutës së miratuar në Kuvend të Kosovës. rezolutë që nuk është kontestuar nga asnjë grup parlamentar në këtë Kuvend. Lidhur me çështjen, për të cilën bisedohet sot në fillim, në mbledhjen konsultative të shefave të grupeve parlamentare para mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, shefat e grupeve parlamentare me përjashtim të grüpuit i cili sot e ngrit këtë çështje, janë pajtuar që kjo çështje të përcillet në kuadër të rezolutës së miratuar. Ne si grup parlamentar në mbështetje edhe në grupet e tjera parlamentare kemi kërkuar që Delegacioni i Unitetit të vijë në Kuvend. Ata kanë ardhur në Kuvend, janë duke punuar në terren dhe ata do të vijnë z. kryetar përsëri në Kuvend, atëherë lidhur me këtë çështje nuk e lëmë në përgjegjësi të Kryesisë së Kuvendit, sepse përfaqësuesit e LDK-së në Kryesi të Kuvendit, por edhe të partive të tjera, përveç Grüpuit për Integrim e kanë mbështetur këtë qëndrim. Prandaj nuk ka qenë kërkësë e grupeve parlamentare shumicë që kjo çështje të jetë në rend dite për seancën e sotme. Ne njëzëri jemi pajtuar që sot si pikë e veçantë e rendit të ditës të jetë buxheti, andaj z. kryetar, ju lutem që ta procedoni në bazë të rendit të ditës që na keni ofruar me kohë sipas Rregullores së punës. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e kërkon Ferid Agani.

**DEPUTETI FERID AGANI** – Fillimisht informoj Kuvendin dhe më vjen keq edhe kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së nuk e ka këtë të njojur se Grupi Parlamentar për Integrim nuk është i përfaqësuar në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, prandaj nuk ka mund të jetë kundër një qëndrimi të tillë. Ne vetëm insistojmë të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, sepse ky kuvend e ka miratuar më 1 qershor të këtij viti, pra ne nuk mund të sillemi në mënyrë volontere, kur dëshirojmë të thirremi në rregullore, kur dëshirojmë të jemi kundër dhe neglizhentë ndaj saj. Nëse dëshirojmë të kemi funksionim demokratik të Kuvendit të Kosovës, atëherë kërkesa në bazë të rregullës 23 pika 2 duhet të qitet në votim. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e kërkon Gani Koci.

**DEPUTETI GANI KOçi** - Z. kryetar, mua më vjen keq se thatë se Kryesia e përcakton rendin e ditës dhe kjo po nënkupton që ose ata që i ke afér të kanë informuar gabimisht ose ju nuk e keni lexuar rregullat 23 të Rregullores dhe rregullën 29, po ashtu të Rregullores për raste urgjente. Prandaj në rastin konkret të kërkësës së Grupit Parlamentar që është bërë me nënshkrime dhe procedurat e nevojshme, të veproni konform rregullës 29 të Rregullores së Kuvendit, përndryshe e shkelni qëllimi Rregulloren e Kuvendit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Nuk është çështje urgjente. Fjalën e kërkon z. Koci.

**DEPUTETI GANI KOçi** – Në qoftë se për Kuvendin e Kosovës nuk është çështje urgjente, atëherë pse Kuvendi i Shqipërisë nxori rezolutë pikërisht për shtyrje të këtyre vendimeve. Nuk konsideroj se kjo çështje ka qenë më urgjente për Kuvendin e Shqipërisë sesa për Kuvendin e Kosovës.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Thamë se nuk është urgjente, sepse nuk është Grupi Negociator këtu komplet, prandaj ju lus të vazhdojmë me rendin e ditës që e kemi paraparë.

**1. Miratimi i procesverbaleve nga seanca plenare të mbajtura me 16, 17 dhe 20 nëntor.**

A ka dikush vërejtje për të? Nëse ka vërejtje të bëhen me shkrim, nëse nuk ka atëherë konsideroj se Kuvendi miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 16, 17 dhe 20 nëntor.

Kalojmë në pikën tjeter të rendit të ditës.

**2. Koha për pyetje parlamentare.**

Ju njoftoj se me rregullën 26.1 të Rregullores së punës së Kuvendit koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Në afatet e përcaktuara me Rregullore janë parashtruar 5 pyetje parlamentare.

Pjetjet i janë dërguar Qeverisë dhe u janë shpërndarë të gjithë deputetëve. Ju njoftoj se koha për pyetje zgjat 1 minutë, përgjigja e ministrit 3 minuta, pyetja plotësuese 1 minutë dhe përgjigja plotësuese 2 minuta.

Deputeti Xhevati Bislimi ka pyetje për kryeministrin e Kosovës. Fjalën e ka z. Koci.

**DEPUTETI GANI KOçi** – Rendin e ditës e kemi marrë vetëm me një pikë të rendit të ditës: Shqyrtimi i propozim buxhetit për vitin 2007. Në thirrje që na janë dërguar nuk ka aso pike të rendit të ditës, pyetje parlamentare, prandaj nuk di se nga po hyn kjo në rendin e ditës këtu.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Pjetjet e deputetëve janë të përhershme dhe nuk ka asgjë kontestuese këtu.

Meqenëse për pyetjen 1 dhe 2 nuk është kryeministri prezent, kalojmë në pyetjen e tretë të rendit të ditës: Deputeti Ferid Agani, ka pyetje për kryeministrin e Kosovës. Edhe kjo shtyhet për seancën tjeter.

Deputetja Gjylnaze Syla, ka pyetje për ministrin e financave Haki Shatrin.

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA** – I nderuari z. ministër pyetja ime ka të bëjë me vendimin e Kuvendit të Kosovës të marrë në seancën e 7 korrikut të vitit 2005. për zgjidhjen e përkohshme të gjendjes së pensionistëve. Lidhur me ndarjen e shumës për pensionist prej 6 milion eurove pyetja ime është : Çfarë keni bërë ju si ministër i

Ekonomisë dhe Financave që ta siguroni këtë shumë - 6 milionë- dhe a kanë marrë pensionistët dhe invalidët e punës shtesën e tillë të vendosur nga Kuvendi i Kosovës? Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, z. ministër ju e keni fjalën.

MINISTRI HAKI SHATRI – Faleminderit për pyetjen e bërë edhe pse kam qenë i angazhuar rrëth përgatitjes së buxhetit, jam munduar të gjej përgjigjen në institucionet tonë dhe përgjigja për pyetjen është kjo: "Me kontrollimin e pagesave që janë bërë në Departamentin e Thesarit nuk figuron që është paguar një shumë e caktuar që përmendet në vendimin e shtatorit të vitit 2005 për pensionistët, pra për këtë destinim" Arsyet e kërkua pse nuk janë bërë këto kanë dalë pengesa kyçë. Me rastin e marrjes së vendimit nga ana e Kuvendit të Kosovës nuk janë përcaktuar burimet e të hyrave dhe fondeve se nga do të paguhën këto para. Pengesa tjetër ka qenë që nuk janë të përcaktuar as kriteret se për çfarë destinimi dhe si do të ndahen këto para nga ana e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale. Më vonë kemi pasur një kërkesë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që kjo shumë e parave të ndahet për pagesën e dimërishtëve për pensionistët, por edhe me këtë rast nuk kemi marrë as kritere, as kushte të pagesës së këtyre parave dhe e fundit që e ka penguar Ministrinë e Financave të insistojë për gjetjen e fondeve që kanë qenë shtrëngimet dhe rekonditimet e fuqishme që bëjnë institucionet financiare ndërkombëtare që na monitorojnë. Që të mos zgjerojmë me linjën buxhetore të transfereve sociale, sepse edhe ashtu kjo linjë është e stërvitgarkuar për kushtet e Kosovës dhe nëse kjo do të bëhet, atëherë vlerësimet e këtyre institucioneve për Këshillin e Evropës do të jenë negative dhe si pasojë do të kemi edhe probleme që pasojnë me vendimet politike lidhur me statusin dhe me anëtarësimin e Kosovës në të ardhmen në këto institucionë. Kjo është përgjigjja ime për sot, por nëse ka nevojë për përgjigje shtesë unë në takimet e tjera të këtij Kuvendi do të përgjigjem. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – A keni për të plotësuar pyetjen? Deputeti Xhezair Murat, ka pyetje për ministrin Ibrahim Selmanaj.

POSLANIK DŽEZAIR MURAT – Dozvoli te predsedničë da vas pozdravim, vas ministre, zamenika premijera i kolege. Mi u Skupštini smo imali debatu 7. jula 2005g. vezanu za problem penzionera. U medjuvremenu su penzioneri posetili sve šefove parlamentarnih grupa i insistirali da još jednom pokrenemo jedan debatu vezanu za ovaj problem. Ja konkretno pitam ministra za rad i socialnu politiku: Šta je sa osnovicom penzionera od 40€ koja je statična, ikoja se ne menja s obzirom na to da sve podleže promenama i da smo mnogo puta konstatovali da je njihov status ispod svakog nivoa, da li se nešto o tome čini. To je mojo prvo pitanje.

KRYETARI I KUVENDIDT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Z. ministër e keni fjalën.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Z. kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra. Unë kam dy pyetje të cilat janë adresuar për Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe siç jeni në dijeni. pensionistët në Kosovë gjëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të vlerës 40€ që do të thotë se janë pensionistë të pleqërisë dhe se Qeveria e Kosovës, e para dhe ajo e fundit tash më nuk kanë trashëguar buxhet që mund t'i mbështesë pensionistët dhe një shumë e fondeve e cila është trashëguar nga pensionistët kontributdhënës nuk është në

Kosovë, por është në Serbi. Ky është një problem që nuk mund ta zgjidhim ne, por është problem që do të zgjatë tutje. E rëndësishme është se në bazë të rekomandimeve që kanë dalë nga Kuvendi i Kosovës që të hartojmë Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, të gjitha procedurat të cilat kanë qenë dhe afati kohor që të kryhet Projektligji, Ministria e Punës dhe Mirëqenis Sociale në bashkëpunim me profesionistë dhe të tjerë ka mbërri ta hartoje një projektligj të tillë, që i ka kaluar të gjitha procedurat deri në Kabinetin Qeveritar. Në ditën e djeshme kemi diskutuar rrëth Projektligjit dhe presim vlerësimin e fundit nga partnerët relevantë :siç janë: Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar ,do ta bëjmë edhe një analizë të kostos financiare dhe të mundësisë sa do të përballojë buxheti i konsoliduar i Kosovës. Përderisa nuk e kemi një projektligj të aplikueshëm në Kosovë ,nuk mund të ngremë vlera të pensioneve dhe kjo do të jetë gjendja për pensionistët. E rëndësishme është se ne kemi mbërritur ta kemi një draft që me siguri mund të ketë ndërhyrje edhe nga ekspertët e Bankës Botërore. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. A keni diçka për të plotësuar z. Murat?

**POSLANIK DŽEZAIR MURAT** – Ministar je odgovorio na drugo pitanje, ono je upravo bilo posvećeno dokle je stigla procedura o izradi Zakona o penziskom i invalidskom osiguranju, zato što su i Savez nezavisnog sindikata penzionera, i Udruženje penzionera svoj kadar ponudili Ministarstvu, eksperte koji su bili na usluzi Ministarstvu kako bi taj zakon što brže prošao proceduri i došao do nas. Oni izražavaju mišljenje da se sa tim previše kasnilo. Danas je ministar dao objašnjenje da će on biti vrlo brzo u proceduri tako da sam ja zakružio svojo pitanje, ali u onom delu gde stoji otprilike današnja konstatacija ministra da mi nismo nasledili niti budžet niti sredstva vezana za poboljšanje akontacije. To više nije penzija koja je nepomična i ja smatram da smo kao Skupština imali mogućnosti da u toku.....

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Unë në fillim ju njoftova për kohën që keni në disponim, ti vazhdohet.

**POSLANIK DŽEZAIR MURAT** - Nismo iskoristili sve mogućnosti kako bismo došli do jednog našeg specifičnog Kosovskog fonda vezan samo za ovu problematiku, vezano za ono što smo govorili pre godinu dana za akcize robe itd, itd, u svakom slučaju dobro je obećanje ministra da će vrlo skort doći zakon, i to je bilo krani cil mog pitanja. Hvala !

**KRYETARI I KUVENDIDT KOLË BERISHA** – Ministër keni diçka? Hydajet Hyseni e ka kërkuar fjalën.

**DEPUTETI HYDAJET HYSENI** – Faleminderit z. kryetar. Më lejoni që unë edhe një herë t'ia kujtoj Kuvendit se nuk ka marrë ende përgjigje për pyetjen e bërë para një vitit për pasojet e tërmetit. Pyetja u është drejtuar Qeverisë dhe ministritë përkatëse. Si duket pyetja nuk është e plotë, prandaj më lejoni ta plotësoj.

A i ka shqyrtuar Qeveria ankesat e qytetarëve sidomos ato që flasin për shfaqje korupsioni dhe kriterë partiake në ndarjen e mjeteve për zhdukjen e pasojave të tërmetit dhe nëse i ka shqyrtuar si i vlerëson at?. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Zëvendëskryeministër urdhëroni.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI LUTFI HAZIRI - Inderuari kryetar, të nderuar deputetë, i nderuari deputet Hyseni.

Në pyetjen tuaj rrëth pasojave të tërmetit dhe shfrytëzimit të fondit, unë jam përgjigjur me shkrim në kohën e caktuar sipas procedurave që kërkon Rregullorja dhe dokumentet në fuqi në Parlamentin e Kosovës. Qeveria e Kosovës nuk ka pranuar ankesa nga ana e qytetarëve. Ne kemi pranuar raportin e auditorit sipas kërkesës, e kemi shqyrtuar dhe kemi parë rekomandimet, kështu që gjithçka që adresohet dhe duke pasur parasysh ligjin në fuqi, i cili i ka dedikuar mjetet nga ana e Qeverisë së Kosovës me kërkesë, me vendim të Parlamentit të Kosovës në shumën prej 5 milion eurove. Këto mjete të dedikuara i janë alokuar komunës së Gjilanit në përqindjen më të madhe, komunës së Vitisë, komunës së Kamenicës dhe komunës së Novobërdës. Mënyra e harxhimit të mjeteve sipas destinimit, shpërndarja e këtyre të mirave për sanimin e pasojave ka qenë e drejtë ekskluzive e organeve komunale të cilat nuk kanë pasur mundësi asnjëherë që këtyre mjetet t'ua ndërrojnë destinimin. Atëherë gjithçka që lidhet me këtë çështje me pasojat dhe me ankesat e qytetarëve ne në kohën që do të vijë do t'i shqyrtojmë dhe do t'ju raportojmë, po ashtu do të kërkojmë nga asambletë komunale të këtyre 4 komunave të paraqesin me shkrim dokumentacionin e domosdoshëm dhe mënyrën e shpërndarjes. Unë personalisht kam qenë kryetar i komunës deri më 3 dhjetor të vitit 2004. Kjo asistencë ka qenë në fazën e implementimit dhe ju siguroj që deri në atë fazë dhe më vonë kjo është bërë në përputhje me procedurat. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Fjalën e kërkon z. Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI - Meqë kjo pyetje u zgjat shumë do të duhej pyetja shtesë të kishte pak më shumë kohë. Megjithatë unë nuk do ta keqpërdor, natyrish që nuk jam i kënaqur me përgjigjen, por dua të sqaroj se pyetja ka qenë pyetje e qytetarëve dhe ka qenë pyetje për përgjigje publike. E falënderoj ministrin që e dha një pjesë të vogël, shumë të vogël të përgjigjes. Megjithatë mendoj se Qeveria është borxh ndaj qytetarëve të Gjilanit dhe të viseve të tjera të dëmtuara që t'i hulumtojë rastet dhe ta bëjë një raport të komplektuar, përndryshe na mbetet ne deputetëve që ta iniciojmë këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Nëse nuk ka pyetje të tjera përfundon faza e pyetjeve dhe e përgjigjeve.

Kalojmë në pikën tjetër.

### 3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2007 me autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2007.

Projektligi u është shpërndarë deputetëve më 14 tetor 2006 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin përkatës z. Haki Shatri që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligin e ofruar.

MINISTRI HAKI SHATRI – I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, të nderuar të pranishëm.

Kam nderin që në emër të Qeverisë të prezantoj për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2007.

Ky është dokumenti më i rëndësishëm vjetor që propozohet për miratim në këtë Kuvend. Procedurat e përgatitjes të miratimit të tij, përcaktohen me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në pajtim me këtë puna në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave ka filluar qysh në shkurt të këtij viti. Paraprakisht janë aprovuar edhe në Kuvend korniza afatmesme e shpenzimeve dhe programi i investimeve publike për periudhën 3 vjeçare 2007-2009 ,por janë përcaktuar edhe limitet e shpenzimeve për organizatat buxhetore.

Korniza afatmesme e shpenzimeve dhe programi i investimeve publike janë vlerësuar pozitivisht nga institucionet financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian dhe kanë rekomanduar në bazë të tyre mbështetje buxhetore, e cila është konkretizuar në Konferencën e Donatorëve në fillim të prillit të këtij viti, me ç' rast janë premtuar si mbështetje për buxhetin e konsoliduar të Kosovës 55 milion euro. Dokumentet e sipërpërmendura përbajnjë kornizën makroekonomike të shpenzimeve buxhetore për vitin 2007. Kjo po ashtu është në pajtueshmëri dhe me rrethanat ekonomike të Kosovës. Fondi Monetar dhe Banka Botërore, Komisioni Evropian vazhdimisht kanë monitoruar ecurinë buxhetore dhe kanë bërë presion në ndryshimin e strukturës së shpenzimeve në favor të rritjes së investimeve kapitale.

Edhe bashkësia ndërkombëtare në standartet për Kosovën, standardi i pestë, e pastaj përmes stabilizim-asocimit ka këruar sigurim të qëndrueshmërisë dhe të stabilitetit buxhetor, si kusht për zgjidhjen e statusit dhe mbështetjen buxhetore para dhe pas statusit. Siç jemi në dijeni përpjekjet e Qeverisë në këtë drejtim u vlerësuan pozitivisht dhe mëgjithse vazhdon trysnia e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e Bankës Botërore në drejtim të heqjes dorë nga implementimi i disa ligjeve me kosto të lartë buxhetore ose nga procedimi i mëtejshmë i disa ligjeve të tjera, të cilat kanë kosto të lartë buxhetore, mos pajtueshmërinë me këto institucione lidhur me përgatitjen e buxhetit për vitin 2007 nuk kemi.

Të nderuar deputetë, Kosova si vendi me ekonomi më të pazhvilluar në rajon, me probleme strukturale zhvillimore, papunësi të theksuar, varfëri prezente dhe infrastrukturë ekonomike të dobët, nuk mund të sigurojë nga burimet e veta vëllim të të hyrave buxhetore në pajtim me nevojat që kemi. Shkalla e ngarkimit të ekonomisë me ngarkesa fiskale sipas propozimit të këtij buxheti sillet në 29% dhe janë shumë afër kufijtë e lejuar për ngarkesa të mëtejshme fiskale të brutoproduktit vendor. Çdo ngarkesë shtesë do të ndikojë negativisht në koston e jetës dhe në jetën normale ekonomike. Në pajtim me këtë dhe në rezultatet e arritura në të hyrat buxhetore në vitin 2006, janë projektuar të hyrat buxhetore për vitin 2007, të cilat janë për 4% më të mëdha sesa në vitin buxhetor 2006. Për zgjerimin e të hyrave buxhetore kanë shërbyer si bazë dhe fakti se ecuritë ekonomike në Kosovë për këtë vit kanë qenë më pozitive sesa vlerësimet e mëhershme që ka bërë Fondi Monetar Ndërkombëtar,sipas analizave të Bankës Botërore janë shumë më pozitive dhe sillen rrëth 3.5% shtim ekonomik.

Duke u bazuar në këto rrethana lehtësuese, projekioni i të hyrave është avancuar në 682.8 milion euro dhe ky është versioni që në fjalorin e buxhetit quhet më pesimist, pra është versioni që është plotësisht i realizueshëm, sepse ka edhe versione të tjera, që krijojnë optimizëm se mund të kemi edhe të hyra më të mëdha. Në këtë projektbuxhet ndryshon pozitivisht edhe struktura e të hyrave buxhetore. duke dinamizuar rritjen e të hyrave në

brendi për 12.5%, kurse ato që vilen në kufi për 2.9%. Të hyrat jo tatinore dhe të hyrat vetjake e të komunave, janë projektuar më të ulëta se në vitin paraprak. Kufijtë e shpenzimeve buxhetore janë zgjeruar për 17.5% milion euro ose për 2% në krahasim me vitin buxhetor 2006. Edhe pse këta kufij janë për 20 milion euro më shumë se rekomandimet e mëhershme, pas rezultateve të arritura në vjetin e të hyrave për këtë vit dhe të ecurive pozitive ekonomike kemi siguruar pajtueshmëri me institucionet financiare ndërkombëtare për këta kufij të shpenzimeve. Në bilancin e të hyrave dhe të shpenzimeve buxhetore nuk hyjnë donacionet për buxhet të Këshillit të Evropës dhe të Bankës Botërore, pra në shifrat që i kemi sot për shqyrtim dhe miratim janë vetëm të hyrat vetjake dhe shpenzimet që sigurohen nga të hyrat vetjake buxhetore.

Në këtë bilanc që është vetëm nga të hyrat buxhetore, deficiti buxhetor i projektuar për vitin 2007 do të jetë 34 milion euro dhe është shumë më i ulët se në vitin buxhetor 2006. Ky deficit do të mbulohet nga keshi i rezervave të Qeverisë që mbahen të depozituara në bankë dhe pritet që keshi nga rezerva e keshit të Qeverisë në fund të vitit 2007 ,po ashtu do të jetë 75 milion. Kjo shumë është e mjastueshme për vazhdimin e funksionimit normal të institucioneve shtetërore edhe në fillim të vitit 2008. Struktura e shpenzimeve buxhetore në vitin 2007 do të ndryshojë dukshëm në favor të rritjes së investimeve kapitale, të cilat janë rritur për 29 milion euro në krahasim me vitin 2006 dhe paralelisht me këtë edhe të zvogëlimit të shpenzimeve operative, pra linja buxhetore e mallrave dhe e shërbimeve përrreth 8 milion euro. Siç mund të vërehet në tabelën nr. 1 investimet kapitale do të janë 2.5% më të mëdha se në vitin 2006, nga të cilat investimet kapitale në institucionet qendrore do të janë 3.7% më të mëdha. Në kuadër të investimeve në institucionet qendrore, dallohen ato vetëqeverisëse që kanë rritje 4.2 dhe fuqi rezervë që kanë 2.9% shtim. Si kategoria më e rëndësishme e shpenzimeve publike në vitin 2007, investimet kapitale kapin shumën prej rreth 199.7 milion euro dhe janë shumë afér linjes buxhetore më të madh. Pagat dhe mëditjet, pra afrohen ta zënë vendin e parë me këto ndryshime.

Përmes rritjes së fondevë për investime , Qeveria ka siguruar bazën materiale për realizimin e prioriteteve të saj që lidhen me energjinë, ekonominë dhe edukimin. Për energjinë janë rekomanduar 21 milion euro për minierat e linjtit dhe 15 milion euro përfurnizim, për importim të rrymës 10 nga të cilat do të janë përfurnizim dhe 5 që lidhen me rastet sociale. Investime shtesë do të ketë nga mbështetja e donatorëve, por që këto investime nuk janë përfshirë në këtë projekt dokument, sepse- thashë më herët- që donacionet për buxhet nuk janë përfshirë në këtë dokument. 5 janë rekomanduar përnivelin qendror të arsimit, 34.3 milion euro dhe granti përkomuna 76.6 milion euro, pra gjithsej 110.9 milion euro me çka mbulohen reformat e reja të reformës në arsim në vitin 2007. Vetëm në investimet kapitale në arsim sillen rreth 16.7 milion euro, për 7 milion euro sesa në vitin 2006. Për ndërtimin e rrugëve të reja dhe rehabilitimin e rrugëve ekzistuese janë rekomanduar për Ministrinë e Postëtelekomunikacionit rreth 36 milion euro ose 7 milion euro se sa në këtë vit.

Linja buxhetore paga dhe mëditja ende zë vendin e parë me 202.9 milion euro edhe përkundër përpjekjeve të Qeverisë për reformën e shërbimit civil dhe zvogëlimin e kësaj linje buxhetore, trashëgimi i numrit enorm të stafit civil është sfida kryesore për ?Qeverinë edhe në vitin 2007. Në këtë drejtim çojnë edhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe në vazhdën e aktivitetave që kemi bërë kemi arritur që numri i rekomanduar i shërbyesve civilë në vitin 2007 të jetë për 1.500 persona më i vogël se sa në vitin 2006, por nuk do të ketë përjashtime nga puna ,ashtu siç është përfolur shumë herë në mjetet e informimit dhe në strukturat e tjera. Linja buxhetore përmallra dhe shërbime është zvogëluar për 8 milion euro dhe kap shumën prej 132.2 milion euro. Zvogëlimet e

kësaj linje janë bërë nga Qeveria edhe në vitin 2005 edhe në vitin 2006. Linja buxhetore e subvencioneve dhe e transfereve me rrëth 154. milion euro , mbulon transferet sociale, pensionet bazike dhe pensionet e nevojat e tjera emergjente. Po ashtu mbulohen edhe shpenzimet e të gjitha organizatave buxhetore për shërbimet komunale. Me buxhetin e vitit 2007 do të mbulohen shpenzimet e regjistrimit të popullsisë, zgjedhjet lokale dhe qendrore. Përveç ruajtjes së nivelit të rezervës së Qeverisë dhe Përfaqësuesit Special janë rezervuar edhe 4.5 milion euro për vazhdimin e procesit të negociatave dhe të nevojës së menjëherë pas statusit.

Risi paraqet mundësia e vazhdimit të projekteve kapitale të papërfunduara në vitin 2006, në vitin 2007 dhe këto projekte kapitale kapin shumën prej 18 milion euro. Grandi qeveritar për komunat me strukturë mbetet i njëjtë dhe është proporcionalisht i rritur, me rritjen e të hyrave, por të hyrat vetjake të komunave janë më të vogla për 6 milion euro,por kjo nuk i pengon ato të grumbullojnë të hyra vetjake më të mëdha dhe që ato mjete menjëherë t'i realizojnë për projektet e tyre gjatë vitit buxhetor 2007. Në anën tjetër janë shënuar disa rezultate pozitive në kalimin e përgjegjësive në menaxhimin e buxhetit nëpër komuna sidomos në decentralizim ku kemi 3 komuna të reja të cilat në vitin 2007 do të marrin kompetencë të menaxhojnë vetë buxhetet e tyre. Në relacionin me komunat ka qenë një dukuri pengesë, e cila e ka përcjellë procesin e përgatitjes së buxhetit e kjo është mosrespektimi i afateve nga ana e kuvendeve komunale dhe e limiteve buxhetore. Ministreria e Ekonomisë dhe Financave dy herë i ka shtyrë afatet për komunat dhe jemi të detyruar që pas aprovizimit të buxhetit komunat,që ato nuk u përbahen rekomandimeve nuk do t'ju lejojmë grantet deri në miratimin e buxheteve të tyre. Fjala është për 3 komuna të veriut dhe për disa komuna në brendi të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Jemi të vetëdijshëm se me vëllimin e buxhetit të propozuar për vitin 2007 nuk plotësohen nevojat e shumta që kemi e as kërkesat e shumta të organizatave buxhetore e as nuk janë në harmoni me dëshirat tona të përbashkëta. Kky projektbuxhet paraqet mundësinë tonë reale e cila pritet të ndryshojë plotësisht gjatë vitit 2007 dhe atëherë do të plotësohen kushtet për mbulimin e më shumë kërkesave dhe nevojave publike.

Aktualisht subjektet që na mbështesin dhe na monitorojnë në të cilat synojmë të anëtarësohemi në të ardhmen e afërt, na rekomandojnë sjellje me kujdes dhe përgjegjësi dhe mbikëqyrje rigorozë të shpenzimeve buxhetore. Duke u nisur nga këto argumete dhe të tjera, të shumta ,që jam i gatshëm të ofroj qoftë gjatë kësaj seance, qoftë në periudhën e diskutimeve nëpër trupat e Kuvendit ,ju thërras ta aproponi në këtë fazë dhe krijoni kushte për miratimin përfundimtar të buxhetit për vitin 2007 në fillimi të vitit 2007, gjegjësisht para fundit të vitit 2006.

Ju falënderoj për vëmendje dhe kërkoj falje për prezantimin e gjatë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e kanë shefat e grupeve parlamentare, për LDK-në Naser Osmani,

DEPUTETI NASER OSMANI - I nderuari kryetar, i nderuar zëvendëskryeministër, të nderuar ministra, të nderuar deputetë . Më lejoni të shpreh kënaqësinë time që sot po e debatojmë buxhetin e prezantuar për vitin 2007 nga Qeveria e Kosovës si dhe për disa trende pozitive që kam vërejtur lidhur me këtë draftligj. Rritja e shpenzimeve buxhetore parashihet të jetë më e madhe se në vitin paraprak për 17.5 milion euro, ndërsa deficiti i përgjithshëm është zvogëluar nga 44 milion, sa ishte në vitin 2006, në 30 milion për vitin

2007 dhe këtë duhet vlerësuar mjaft pozitivisht. Gjithashtu jam i kënaqur që shoh një rritje të ndjeshme në fushën e investimeve kapitale, që do të thotë se për këtë qëllim do të jenë në dispozicion 199.7 milion euro, për 19.3 milion euro më tepër se në vitin 2006 ku do të jenë të përfshira edhe mjetet e bartura nga viti paraprak për ato projekte që nuk kanë përfunduar. Kjo shumë do të ishte edhe më e madhe për 7.4 milion euro sikur Qeveria t'i përmbahej marrëveshjes paraprake të 23 dhe 31 tetorit të vitit 2006 me Fondin Monetar Ndërkombëtar që këtë shumë Qeveria e ka ridestinuar në shpenzimet operative dhe me këtë e ka rrezikuar nënshkrimin e letrës së qëllimit të mirë me fondin Monetar Ndërkombëtar. Megjithatë ne z. kryetar duhet që me keqardhje të konstatoj se Qeveria vazhdon të mos i respektojë afatet për dorëzimin e Projektligjit për buxhet, të cilat janë të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Edhe këtë vit Projektligji për buxhet i është dorëzuar Kuvendit me një vonesë 2 javore që do të ndikojë në Komisionin për Buxhet dhe Financa të veprojë me një dinamikë të përshpejtuar. Sot nuk do të thellohem në ndonjë analizë të hollësishme rrëth aspektit të përbajtjes së Projektligjit, në përgjithësi, mbesin vërejtjet se duhet ende të përmirësoset raporti në favor të hyrave nga tatimet e brendshme, të cilat janë ende diku vetëm  $\frac{1}{4}$  e të hyrave nga tatimet, kurse  $\frac{3}{4}$  ende mblidhen në kufi, gjë që sugeron se ende po e mbushim buxhetin në bazë të tatimeve nga mallrat e importuara. Përderisa ekziston një gjendje e tillë duhet të jemi shumë të kujdeshshëm që të mos ngutemi me nënshkrimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me disa shtete me të cilat nuk kemi konkurrencë tregtare të balansuar ose në të kundërtën të na ofrohen shpjegime se si do të ndikojnë marrëveshjet për tregti të lirë në të hyrat e buxhetit të Kosovës.

Projektligjit, ashtu siç e kemi marrë, i mungon pasqyra e projekteve të investimeve kapitale dhe kërkoi nga Qeveria të na vëré në dispozicion këtë dokument si dhe kornizën makroekonomike mbi të cilën janë përgatitur buxheti dhe dokumentet e tjera sqaruese që mund të na ndihmojnë në shqyrtimin e buxhetit. Ne jemi shumë të interesuar që t'i kuptojmë prioritetet e Qeverisë në lidhje me investimet kapitale dhe Komisioni për Buxhet do të shikojë për së afërmët që këto projekte, në fakt do të shikojmë në progresin që do të bëjë Qeveria në realizimin e projekteve gjatë vitit të ardhshëm. Nuk dëshirojmë që të përsëritet ajo që kemi vërejtur nga raporti finanziar 9 mujor për këtë vit ku investimet kapitale ngecin në realizim në një shumë prej 120 milion euro. Gjithashtu mendoj se Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë duhet të amendamentohet në mënyrë të përshtatshme për të lejuar krijimin e fondeve, për t'i tejkaluar disa probleme që i kemi me disa projektligje si p.sh Projektligjin për sigurimin shëndetësor të cilin Qeveria vetë e ka sponsoruar, e i cili është në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Në të kundërtën Qeveria duhet të bëjë zgjedhje alternative tjeter, por thjesht situata e krijuar rrëth këtij projektligji është e papranueshme dhe nuk guxon të zgjas më tutje. Për këtë kërkoj një përgjigje nga kryeministri dhe ministri i financave lidhur me mendimin e tyre për të adresuar problemin që e kemi me projektligjin për sigurime shëndetësore.

I nderuar kryetar, të nderuar deputet jemi plotësisht të vetëdijshëm për sfidat e reja pas statusit ku do të përballemi me krijimin e institucioneve të reja dhe bartjen e përgjegjësive nga UNMIK-u te institucionet e mirëfillta vendore.

Ndarja e 4.5 milion eurove do të krijoj vetëm një hapësirë të vogël por të domosdoshme për t'i konsoliduar këto institucione. Bartjen e përgjegjësive e presimi me padurim edhe për çështjet tjera të caktuara që deri më tanë nuk i kemi shikuar me shumë simpati, siç është kompetenca e përfaqësuesit special të sekretarit të përgjithshëm lidhur me transferet e shumave të caktuara të cilat mund të bëhen edhe pas miratimit të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës, gjithashtu edhe rishikimi i buxhetit në mes të vitit nuk duhet të bëhet pa u marrë

pëlqimi i Kuvendit dhe për këtë do të shikojmë mundësinë që të sigurojmë që buxheti të mos rishikohet pa pëlqimin e Kuvendit.

Z. kryetar Komisioni për Buxhet dhe Financa do ta shqyrtoj me kujdes këtë projektligj dhe do t'i paraqes me kohë raportet e tija këtij Kuvendi. Më lejoni që të jap një mesazh për të gjitha organizatat buxhetore të Komisionit për Buxhet dhe Financa që ka përpiluar një kalendar për një numër të këtyre organizatave duke përfshirë këtu edhe ministritë, po ashtu edhe organizatat me kompetenca të rezervuara siç është AKM-ja. Sa i përket AKM-së ajo do të shfrytëzoj për këtë vit mbi 75 milion euro dhe deri më sot AKM-ja nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ka marrë diku mbi 300 milion euro. AKM-ja duhet të jap llogari për planet që ka, për shpenzimet e këtyre mjeteve si dhe të tregohen në raportet e auditimit të gjitha ato mjete të marrura deri më tanë nga Buxheti i Kosovës se këto mjete janë shpenzuar ashtu siç duhet, kërkoj nga ju z. kryetar dhe nga ju deputet të nderuar që sot të shprehim qartë përkushtimin e Kuvendit për të siguruar një gatishmëri të nevojshme të të gjitha organizatave buxhetore për të dhënë shpjegime para të zgjedhurëve legitim të qytetarëve të Kosovës. Për të gjitha shpenzimet e kërkua e që të arsyetohen para Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, dëshiroj po ashtu t'i inkurajoj të gjitha komisionet funksionale të Kuvendit që të shqyrtojnë këtë Projektligj në aspektin e sektorëve të cilat ata i mbulojnë dhe të paraqesin para komisionit për buxhet sugjerimet e tyre eventuale, natyrisht që rregullorja e punës e mandaton Komisionin për Buxhet si i vetmi komision që i raporton Kuvendit lidhur me Projektligjin për buxhet, por unë dua që të shpreh shqetësimin tonë si Komision që të marrim parasysh edhe sugjerimet e Komisioneve tjera. Duke shpresuar se një proces cilësor të shqyrtimit të mëtutjeshëm të këtij projektligji kaq të rëndësishëm, e përkrah miratimin e tij në shqyrtimin e parë. Ju faleminderit!

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, nga PDK-ja deputeti Jakup Krasniqi.

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI** – I nderuari kryetar, të nderuar deputetë. Për institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, për qytetarët e Kosovës si tatimpagues dhe shfrytëzues të drejtëpërdrejtë e të tërthortë të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, nëse ka arritur të konsolidohet, hartimi dhe miratimi mbi të gjitha shfrytëzimi, të gjitha këto periudha të marra së bashku kanë një rëndësi të veçantë për Kuvendin e Kosovës. Janë përgjegjësi kryesore ani pse deri më tanë ne si Kuvend nuk i kemi shfrytëzuar. Mendoj që këtë e tregon ky raport që po e debatojmë sot nuk është përpunuar as nga Komisioni kryesor i Kuvendit të Kosovës. Përgjegjësitë tona si në përgatitjen dhe miratimin e mbi të gjitha në kontrollimin e shfrytëzimit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës kanë qenë e me gjasë do të vazhdojnë të jenë nën çdo nivel. Natyrisht se për këtë merita më e madhe është e koalicionit qeverisës dhe e Qeverisë që nuk na obligojnë të marrim pjesë që na takon në hartimin e as në kontrollimin e shpenzimeve buxhetore. Për këtë të fundit ekzekutivi dhe shfrytëzuesit e tjerë të buxhetit duhet ta falënderojnë shumicën parlamentare të kësaj legislature që nuk ua ka prishur tymin e duhanit për asgjë. Unë do të veçoja një kërkësë që bëhet në Projektligjin për nenin 9.6 sipas të cilit shfrytëzuesit i jepet mundësia të lëvizë nga një projekt në tjetrin dhe kështu e zvogëlon rolin e Kuvendit të Kosovës për të kontrolluar shfrytëzimin e buxhetit. Ky nen duhet të hiqet, është i panevojshëm, kështu si është dhënë. Në këtë rast ne po flasim për miratimin e buxhetit të vitit 2007, por nuk mund të themi se buxheti i konsoliduar i Kosovës nuk është përgatitur në mënyrë profesionale se shihet se në gjuhën shqipe është një përkthim i dobët

vende- vende edhe i paqartë. Prandaj mendoj se profesionalisht është përgatitur për të mos u kuptuar ky projektligj, si duket ky ka qenë edhe qëndrimi kryesor i hartuesit të Projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2007. Projektligji i buxhetit të konsoliduar të Kosovës është i ngarkuar me shkronja dhe shifra të imta për të humbur interesimin për lexim. Kjo mënyrë e përgatitjes nga ne deputetët që nuk kemi edhe aq durim për lexim e lëre më për të lexuar e kuptuar është i mirëseardhur e sidomos për ata që duhet vetë të votojnë. Kur është fjala për të hyra skemat janë në vija tepër të trasha. Projektbuxhetin e karakterizon një vlerësim joreal i burimeve të të hyrave. Vlerësimi joreal fillon nga të hyrat e mbledhura në kufi të cilat janë paraqitur në mënyrë sintetike, por mungojnë të dhënë analitike dhe na pengon për të dhënë kontributin tonë në aprovimin e buxhetit. Nëse i bëjmë një vlerësim të përafert dhe real bartësit e doganave mbi të cilat llogariten dhe paguhen, dogana, akcizat, TVSH-ja në kufi, ky lloj i të hyrave ka mundësi të jetë së paku 20% më i lartë se sa është. Në ngritjen e të hyrave kufitare do të ndikonte në zvogëlimi i evazionit fiskal dhe zvogëlimi i kontrabandës për disa artikuj. Mendoj se ky kuvend duhet të debatojë edhe mundësinë dhe ta shikojmë se a ka konflikt interesë se këtu kemi si grumbulluesit dhe hartuesit dhe njëkohësisht mbledhësit e mjeteve financiare dhe ata që bëjnë grumbullimin e këtyre mjeteve financiare edhe i shpërndajnë. Më duket që këtu ka edhe konflikt interesë.

Sa u përket tatimeve të brendshme shuma e paguar prej 40.2 milion është simbolike, kur dihet se borxhi ndaj administratës tatimore për periudhën paraprake kalon shifrën 100 milion euro. Sikur të kishim një ngarkesë të bazuar në qarkullimin real, kjo shumë do të ishte shumë më e lartë. Ne si miratues të këtij buxheti nuk kemi mundësi t'i përcjellim se cilët janë artikujt e konsumit të gjerë që e mbushin buxhetin e konsoliduar të Kosovës p.sh do të duhej të dinim sa janë të hyrat nga derivatet e naftës nga duhani, nga kafja dhe alkooli, sa për qind e këtyre artikujve arrijnë t'u ikin taksave doganore, cilat janë masat të cilat do të shfrytëzohen për të mos lënë rrjedhën e buxhetit në xhepat e kontrabandistëve, cilat janë dobësítë në grumbullimin e mjeteve financiare në dogana, në TVSH, në tatim në fitim? Deri më tanë a është evidencuar ndonjë dobësi dhe të çfarë natyre janë ato, kur Qeveria synon t'i bëjë përmirësimet e duhura, cilat biznese nuk i kryejnë obligimet e tyre, a janë evidencuar biznismenët e pandërgjegjshëm, nëse janë evidencuar çfarë masa janë ndërmarrë ndaj tyre, nga cili lloj i biznesit privat pritet ngritja e të hyrave në buxhetin e konsoliduar të Kosovës? Gjatë këtyre 2 viteve kanë ndodhur ndryshime, nëse kanë ndodhur ato ndryshime, ku kanë ndodhur, a e keni analizuar faktin se pse në tremujorin e tretë ka pasur ngritje të të hyrave, pse kjo nuk ka ndodhur më herët, pse këto gjëra nuk thuhen në projektligjin e vitit 2007? Ne konsiderojmë se vlerësimi i drejtë i burimeve të të hyrave, menaxhimi efikas, zvogëlim i evazionit dhe i kontrabandës, do të mundësonë që ne sot të diskutojmë të hyrat e tjera buxhetore. Niveli më i lartë i të hyrave do të mundësonë edhe plotësimin më të mirë të nevojave të qytetarëve në shëndetësi, në arsim, në infrastrukturë, pensione dhe ndihma sociale, përmdryshe me ndarje të tillë nuk mund të presim reformë të arsimit, edukimit në shëndetësi, në ndihma sociale dhe në investime të tjera kapitale.

Sa u përket të dalave buxhetore pozicionet janë sintetike, projektet nuk janë të nominuara, nuk dihet vlera e paralogaritur e projekteve, nuk dihet koha e fillimit dhe përafërsisht as ajo e përfundimit të objekteve. Në Projektligjin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës në tabelën nr. 2 janë dhënë shpenzimet sipas ..... kryesor për organizatat buxhetore të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes dhe për fuqi të rezervuara dhe komunat si organizata buxhetore. Krahasime do t'i bëj për dy të parat. Në paga dhe mëditje dallimi është prej 5 milion 892.663 euro në favor të fuqive të rezervuara. Nuk thuhet pse ka dhe

nga është ky dallim kaq i madh, pastaj te mallrat dhe shërbimet dallimi është prej 19.809.454 euro në favor të institucioneve të përkohshme, ndërsa në shpenzimet kapitale dallimi është për 3.163.43 euro në favor të IPV-ve. Pse ky dallim kaq i vogël, ku fuqitë e rezervuara investojnë për shpenzime kapitale? Unë në këtë projektligj nuk mund ta di. Ne që duhet ta miratojmë këtë projektligj a duhet ta dimë se çka duhet të miratojmë, pse Qeveria nuk na sqaron cili është numri i shërbyesve civilë në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe cili është në fuqitë e rezervuara si dhe nga dallimi prej gati 6 milion euro për paga edhe pse shërbyesit civilë të fuqive të rezervuara janë shumë në numër më të vogël se shërbyesit civilë në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes.

Nëse FMN-ja nuk lejon ngritjen e pagave në shërbimin civil, pse po lejohet ngritja e pagave në fuqitë e rezervuara, ku shërbyesit civilë të organizatave buxhetore jetojnë në kushte të njëjtë dhe me të njëtin standard jetësor. A nuk është ky diskriminim? Unë për këto dallime që janë në Projektbuxhet nuk kam sqarim nëse përgjegjësit ma kërkojnë këtë unë nuk di si t'ua sqaroj atyre. Nëse ne e miratojmë Projektbuxhetin e konsoliduar të Kosovës a duhet të dimë se çfarë projektesh kanë ofruar institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes për shpenzime kapitale, ku ato do t'i shpenzojnë 85.108.592 euro, pastaj fuqitë e rezervuara ku do t'i investojnë?. Të gjitha, marrë së bashku, bëjnë 167.505.141 euro. Po të shikohen si shifër nuk janë më pak se 167 euro të vëna në shërbim të qytetarëve, vërtet se sa kjo shumë është duke u vënë në shërbim të qytetarëve apo të biznesit në Kosovë. Te pozicioni mallrat dhe shërbimet nuk ka specifikaciin të shpenzimeve të parapara, sa para do të ndahen për shpenzime të telefonave, të derivateve, të mirëmbajtjes së mjeteve, dreka zyrtare etj. Nuk ka arsyetim për këto shpenzime. Si duket kjo mënyrë i konvenon Qeverisë aktuale që paratë e tatimpaguesve t'i shpenzojë pa kritere. Në këtë grant janë llogaritur edhe 7 milion euro për Ministrinë e Telekomunikacionit, të ndara për mirëmbajtjen e rrugëve, paraqiten si mallra dhe shërbime.

Këtë gjë të shpenzimeve kapitale, ne si grup parlamentar jemi të interesuar ta dimë se mbi bazën e të cilave projekte janë ndarë mjetet financiare për shpenzime kapitale të këtyre ministrike; Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Telekomunikacionit, Ministrisë së Shërbimeve Publike, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Kuvendit e të Presidentit, d.m.th në të gjitha këto njësi jepen shuma të mëdha kapitale, por nuk dihet se për çka, për cilat objekte kapitale jepen këto mjete financiare. Pra, buxheti nuk na ofron asnjë të dhënë sidomos këto shpenzime kapitale të ministrike të përmendura kanë rëndësi nationale, prandaj jemi të interesuar të dimë për çfarë investimesh bëhet fjalë, ku do të investohen dhe pse. Projektbuxheti nuk ka ofruar asnjë të dhënë për këto.

Një çështje tjeter që kërkon të trajtohet në Projektbuxhet dhe projektbuxheti nuk na ka ofruar asnjë mundësi, është buxheti për komuna, sepse është fjala për buxhetin e komunave. Ne nuk e dimë se si ky buxhet u ndahet komunave, çka merret parasysh, vazhdon ndarja e granteve të komunave mbi bazën e kritereve paraprake që është numri i banorëve, pa udhëhequr llogari mbi diferençat dhe nevojat e komunave me zhvillim më të dobët ekonomik. Ne e dimë se pas Luftës së Dytë Botërore disa rajone në vazhdimësi kanë qenë në mënyrë tradicionale të lëna pas dore. Çka ka bërë Qeveria që të subvencionojë në këto komuna të pazhvilluara në raport të Projektbuxhetit nuk thuhet asnjë fjalë.

A ka të paraparë ndonjë stimulim buxhetor për komunat e varfра? Edhe kjo pyetje nuk gjen përgjigje në Projektbuxhetin e ofruar, Qe 7 vite kategoritë e luftës nationale kanë mbetur pa asnjë trajtim, përvèç ndjekjeve kriminale që u janë bërë këtyre kategorive për fajin e vetëm se e kanë liruar Kosovën që dikush edhe pa asnjë meritë të hyjë në këtë Parlament.Kjo mënyrë si na është ofruar ky projektbuxhet pa projekte gjithnjë jep mundësi

për shfrytëzim të lirë jashtë politikave programore. Kjo formë e shfrytëzimit të buxhetit nuk mund të quhet ndryshe përvèç krijim i mundësive për vjedhje të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, siç është vepruar deri më tanë, ashtu si ka ndodhur edhe gjatë dy viteve të shkaura. Materiali i ofruar nuk u mundëson delegatëve të Kuvendit të jepin kontribut për buxhetin si njëri prej dokumenteve më të rëndësishëm që aprovon Kuvendi i Kosovës dhe që është punë e Qeverisë e shprehur në vlerë. Më lejoni ta theksoj një fjali të Uelsonit në Konferencën e Paqes të Parisit më 1990. Për sa kohë ndodh rritja e varfërisë së skajshme themelet e Qeverisë do të vazhdojnë të rrënohen. Bërrja dhe shfrytëzimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës nuk ofron perspektivë për zhvillimin ekonomik dhe për qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIDT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të AAK-së deputetja Xhylnaze Syla.**

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA –** I nderuari z. kryetar, anëtarë të Kabinetit Qeveritar, deputetë të nderuar.

Buxheti për vitin 2007 duhet të sigurojë të ardhmen e familjeve dhe të individëve në Kosovë si dhe të trasojë rrugën për të ardhmen në familjen evropiane. Nga Projektligji për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 është e qartë se buxheti i paraparë nuk ka mundësi t'i mbulojë të gjitha nevojat që ne i kemi si infrastruktura më e mirë, furnizimi i rregullt me rrymë, pensionet dinjitoze, shërbim cilësor mjekësor, shkollim kualitativ, por edhe ambient më të pastër, drejtësi më të avancuar dhe paga më të larta. Fondet që i posedojmë dhe që janë pasqyruar në këtë projektligj nuk i plotësojnë të gjitha nevojat, por menaxhimi i mirë mundëson përbushjen e nevojave më të rëndësishme. Për plotësimin e tyre Qeveria duhet ta ushtrojë përgjegjësinë fiskale duke kufizuar rritjen e shpenzimeve, duke u fokusuar në rezultatet e programeve dhe duke zvogëluar harxhimet e panevojshme. Planifikimi dhe shpenzimi i mjeteve nga buxheti do të jetë racionalë dhe me interes për Kosovën. Nga të dhënat tabelare për buxhetin dhe duke i krahasuar me atë të vitit të kaluar, vërehet se menaxhimi i buxhetit është përmirësuar. Por, po ashtu, vërehet se Ministria e Ekonomisë dhe financave ka punuar shumë që buxheti në aspektin fiskal të jetë i përgjithshëm dhe në pajtim me rekonditimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore. Kjo ka rëndësi të madhe, sepse neve na duhet mbështetja e këtyre institucioneve në punën tonë për të ndërtuar shtetin me ekonomi të fortë që kujdeset për nevojat e qytetarëve të vet.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave në këtë projektligj ka demonstruar përkushtimin për disiplinë fiskale dhe stabilitet financiar që ua dëshmon institucioneve ndërkombëtare synimin tonë që të jemi sot kandidatë serioz për investimet dhe nesër për huazimet. Mëgjithatë të dhënat në vazhdim reflektojnë gjendjen se ende 7 vite pas luftës buxheti i konsoliduar i Kosovës varet, në pjesën më të madhe, nga tatimet e importeve në kufi. Nga përbajtja e tabelave del se buxheti i konsoliduar i Kosovës për vitin 2007 është 717.5 milion euro, kurse totali i të hyrave buxhetore është 682.8 milion euro. Shprehur në përqindje, nga të hyrat e përgjithshme, afersisht 64% janë nga tatimet në kufi, kurse 20.5% nga tatimet e brendshme që është më shumë se vitin e kaluar dhe është treguar se janë mbledhur më shumë tatime të brendshme ose ka një rritje të vogël të bazës tatimore. Nga kjo rrjedh konstatimi se është arritur trend pozitiv në krahasim me vitin e kaluar, kur ka ekzistuar deficit prej 43.8 milion euro, kurse më 2007 ai zvogëlohet në 34.7 milion euro. Por buxheti ende nuk ka arritur të jetë investues, prandaj tanë është koha e ndryshimeve dhe kalimi në fazën tjetër, duke filluar nga eliminimi i mangësive, duhet ndërtuar buxhet të

vetëqëndrueshëm dhe me trende të rritjes, dihet se brenda qeverive gjithnjë ekziston një konflikt në mes qëllimit- për të promovuar rritën ekonomike dhe zhvillimit- në njëren anë dhe në anën tjetër të dëshirës për të siguruar se burimet janë shpërndarë në mënyrë të drejtë. Kur burimet janë të vogla si në rastin tonë, atëherë politikat e suksesshme për të promovuar rritën ekonomike gjenerojnë rritën e burimeve financiare vendore dhe ndërkombëtare, që mundësojnë që objektivat shoqërore të trajtohen fuqishëm. Në këtë kontekst është evidente se shpenzimet e planifikuara të Qeverisë për vitin 2007 janë shpenzime të pamjaftueshme publike në edukim. Në një perspektivë më afatgjate rritja , zhvillimi dhe përtëritja e rritjes strategjike duhet të jenë në qendër të aktiviteteve të Qeverisë. Numri i madh i të rinxje mund të ketë përparësi, por vetëm nëse ata kanë arsimim të mirë dhe janë konkurrues në rajon, Evropë dhe në botë. Me këtë nënkuptojo se neve na nevojitet një sistem arsimor që do të krijojë edhe punëdhënës e jo vetëm punëtorë. Duhet alokuar fondet për investime në arsim dhe shkencë , si dhe grante konkurruese në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë. Ky është sugjerimi im i parë. Sugjerimi i dytë ka të bëjë me investimet në projektet zhvillimore në bujqësi që nga kategoria e subvencioneve të mbështetet ekonomia rurale që të lëvizet nga produktiviteti joefikas ka sektori më produktiv i orientuar kah tregu. Është evidente edhe nevoja për stimulimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Sugjerimi i tretë është se kategoria e shpenzimeve përmallra dhe shërbime duhet të rishikohet. Nëse buxheti nuk është shpenzuar për këtë destinim në mënyrë ekonomike dhe të arsyeshme, kjo vijë buxhetore duhet me u ul dhe me u aloku në fonde për investime publike ose stimulim të zhvillimit ekonomik. Pa investim nuk ka rritje të buxhetit,që është indikacion për të kuptuar gjendjen e buxhetit dhe për të bërë ndryshime të nevojshme, të dhënat janë precize dhe të detajuara për shpenzimet e AKM-së në vitet 2006 dhe 2007. Unë nuk dëshiroj më tej të komentoj për buxhetin e AKM-së, meqë nuk i kam të dhënat e nevojshme, por dëshiroj të rikujtoj se në vitin e kaluar AKM-së i është ndarë fondi prej gati 68 milion euro dhe për vitin e ardhshëm janë paraparë 76 milion euro,por asnjëherë nuk është raportuar për këto shpenzime. I propozoj Kuvendit të mos ngutet me aprovin e buxhetit të AKM-së para se ne ta kemi raportin e këtyre shpenzimeve. Ky është sugjerimi im i katërt.

Grupi Parlamentar i AAK-së beson se për të ndërtuar llogari të qëndrueshme financiare Kuvendi duhet të marrë raporte të rregullta nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave në pajtim me nenin 40 të Ligjit për menaxhimin e financave publike, ky është sugjerimi im i pestë.

Zonja dhe zotërinj buxheti, po ashtu ,duhet të orientohet nga realiteti i së sotmes dhe sfidat e së nesërmes, planifikimi i fondeve për transferin e kompetencave dhe për zbatimin e statusit, por edhe të kapaciteteve të reja qeveritare, duhet të parashihen në këtë projektligj. Z. ministër e kemi pyetjen se si e keni paraparë sigurimin e këtyre fondeve. Ministria e Ekonomisë dhe Financave ishte dashur të paraqesë synimet e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror për vitin buxhetor 2007, rekomandojmë që MEF-i të vazhdojë të shikojë për burime të reja të të ardhurave.

Në fund më lejoni ta përbyll fjalën time me qëndrimin e grupit parlamentar lidhur me shqyrtimin e parë të këtij projektligji. Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet në parim me sugjerimet e dhëna. Ne do të jemi aktivë në Komisionin për Buxhet dhe Financa në punën e mëtejme të ligjit. Mbështetjen e këtyre sugjerimeve e konsiderojmë kontribut të Kuvendit në ngritjen e përgjegjësisë profesionale, por edhe të llogaridhënisë dhe të përgjegjësisë ndaj qytetarëve të Kosovës që janë kontribues të buxhetit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të Orës Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIMI JASHARI - I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra të nderuar kolegë deputetë.

Është hera e tretë që kjo përbërje e Kuvendit të Kosovës të diskutojë për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, që mund të themi me plotë gojën se i përsërisim të njëjtat fjalë. Pra, mund ta marrim fjalimin e viti 2004 ose 2005 kur kemi diskutuar për buxhetin e viti 2005 dhe ta lexojmë sot dhe të jetë plotësisht në përputhje edhe me sjelljen e Qeverisë edhe me kërkesat apo vërejtjet tona ndaj Qeverisë.

Pse është ky mos komunikim apo ky dialog i shurdhmemecëv?. Qeveria vazhdon me të sajën, ne si Kuvend sot fatmirësisht unë nuk pashë përfaqësues të opozitës në Kuvend që të gjithë thuaja se i patën vërejtjet unike që nga përfaqësuesi i grupit më të madh parlamentar deri te znj. Syla, e cila po ashtu me tone pak më të zbutura ishte mjaf kritike se si është prezantuar buxheti në këtë seancë. Çështja është se kjo Qeveri dhe ky ministër i Financave nuk dinë të punojnë ndryshe. Ky ministër i Financave përpinqet, por problemi është ta quaj ashtu mbasse kualifikim që mund të më kontestohet mua e drejta që ta vlerësoj dikend që është krejt i fahut tjetër, mirëpo rezultatet e punës e dëshmojnë këtë. Nuk është fjala ime, në qoftë se në vazhdimësi buxheti i Kosovës është buxhet i varfërisë, i fukarallëkut, atëherë lind pyetja çka duhet të bëhet me këtë sistem që e prodhon këtë buxhet të varfërisë?. Ky sistem që prodhon këtë buxhet të varfërisë duhet të ndryshohet, por problemi është se kjo qeveri dhe kjo Ministri e Financave nuk e ka kapacitetin për ta ndryshuar sistemin, fatkeqësisht, nuk mund të mbushte buxhetin me këtë sistem, pra duhet të bëhet diçka ndryshim dhe kjo diçka nënkuption ide, por idetë mungojnë. Prej aty fillon burimi i varfërisë, prej aty fillon dhe burimi i këtij buxhetit të varfërisë.

Nuk mund të merrem shumë me buxhetin që e kemi përpara pa e analizuar buxhetin që po e përmbyllim.

E kemi një buxhet të cilin jemi duke e shpenzuar dhe i cili është pasqyra më e mirë se si do të vazhdojë shpenzimi edhe i këtij buxheti. Në qoftë se e marrim dhe e analizojmë buxhetin 2006 do të shohim që aty kemi keq menaxhim, keq- qeverisje, kemi papërgjegjësi dhe të gjitha këto sjellje vetëm me një automatizëm do të kalojnë edhe gjatë shpenzimit të buxhetit të viti 2007, qoftë ai 700 milion euro, qoftë ai 650 milion euro, shumat pak paraqesin rëndësi.

Kanë rëndësi për xhepin e qytetarit, por për sjelljen e Qeverisë nuk kanë shumë rëndësi. Në qoftë se ky e tha parafolësi zotëri Osmani, që shpenzimet kapitale në Kosovë, të cilat paraqesin vetëm 20% të nevojave elementare të Kosovës për një funksionim ,pra në qoftë se 180 milion euro të parapara për t'u shpenzuar në këtë vit paraqesin vetëm 20% të nevojave, duhet të ketë edhe 5 herë aq që të përbushim minimalisht nevojat e funksionimit të mirë të Kosovës. Në investime kapitale realizohen deri në fund të 9 - mujorit vetëm 60 milion, pra vetëm një e treta e atyre shumave, atëherë lind pyetja çka po ngjet me këtë qeveri ose prioritetet buxhetore për investime kapitale nuk po definohen si duhet, ose e kemi një mosdisiplinë totale nëpër agjensione shpenzuese, saqë njeriu nuk qan kokën, i shfrytëzon lidhjet e veta për t'i miratuar në Ministri të Financave investimin kapital dhe pastaj nuk e qan kokën që atë investim kapital ta realizojë në kohën e paraparë. P.sh. më e mira është që Akademia e Shkencave dhe e Arteve në buxhetin e viti 2006. ka

qenë 1 milion euro shpenzime kapitale për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, askush nuk e vë në diskutim që Akademia e Shkencave dhe e Arteve ka nevojë për ndërtimin. Ajo është i vendosur në një objekt i cili as për afërsisht nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat minimale për një hapësirë humane të punës. Mirëpo çështja është se i tërë viti 2006 po shkon dhe ai investim kapital nuk ka filluar as të realizohet, si është miratuar ai investim kapital në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave. Këtu lind pyetja, në qoftë se ata nuk i kanë pasur projektin gati, në qoftë se nuk e kanë pasur hapësirën të gatshme për ndërtim, nuk i kanë pasur lejet, si mund të miratohet milionëshi? Tash e kemi të njëtin rast, ai milion vetëm përcillet vetëm me automatizëm kalon në buxhetin e vitit 2007 dhe jam shumë i dyshimitë që edhe në buxhetin e vitit 2008 do të na kalojë. Pra, dyshoj shumë se ata e kanë siguruar hapësirën për ndërtim, se e kanë siguruar projektin teknik për ta realizuar atë investim.

Vijmë te një situatë, Kosova e varfér me vetëm 180 milion investime kapitale e ka luksin që 1 milion euro t'i ngrijë e t'i kalojë nga një vit në tjetrin në kushtet kur të gjithë jemi dëshmitarë që në Kosovë kemi deflacion, për shkak të mungesës së parasë kesh në qarkullim.

Të nderuar kolegë deputetë në Kosovë, çmimet po bien, por nuk po bien çmimet për arsyet logjikës ekonomike, por po bien çmimet sepse tregtarët të mbushur mall janë të detyruar ta shesin mallin nën çminin e blerë për të krijuar, për të gjeneruar para. Kësaj i thonë shpenzim i substancës dhe kjo po i ngjet tash e dy vite në Kosovë, për shkak të mungesës së parasë kesh, në qarkullim, kurse Ministria atje e ndalë 1 milion dhe nuk e lëshon në qarkullim, ka pasur prioritetë të tjera të cilat kanë mundur të realizohen me atë milion, dhe që ajo para ka mundur të qarkullojë në qarkullim, dhe që edhe biznesi edhe afarizmi ynë ta shohë një grimë hajër prej asaj pareje dhe nuk është vetëm 1 milion. Në Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës zyrtari i lartë i Ministrisë ka thënë që sivjet do t'i kemi 18 milionë të tillë, pra 10% nga shuma e investimeve kapitale parashihet që do të taprojnë, të jenë suficit, në fund të vitit dhe ata 18 milionë do të jenë para të ngrira, para që nuk janë lëshuar në qarkullim, para të cilat nuk kanë mundur të shndërrohen në mall, që Kosova ta shohë një grimë hajër prej tyre.

Dhe, ky sistem, kjo mënyrë e qeverisjes, kjo mënyrë e menaxhimit të buxhetit është alarmante, më vjen shumë mirë sot që edhe z. Osmani është mjaft kritik, që edhe zonja Syla e pat një ton sadopak më të zbutur, por edhe kritik që të fillojë kjo qeveri gradualisht ta konstatojë mënyrën e një nevoje të re të komunikimit në Kuvend. Kjo mënyrë e re shpresojmë se do ta zgjojë nga gjumi Qeverinë dhe do të fillojë gradualisht të merret me problemet reale që me një përgjegjësi shumë më të lartë t'i qaset kësaj problematike.

E kam edhe një që të mos jem shumë kritik dua ta përgëzoj edhe për diçka Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave se nuk dua të jem vetëm kritik. Në pasqyrat për komunat vërehet një progres, mënyrë e prezantimit të shënimave edhe të kërkesave të komunave të caktuara. Pra bëhet një ndarje konform kodeve buxhetore për çdo drejtori veç e veç. Ky është një progres, është një përparim t'jua them të drejtën që krijon hapësirë për transparencë. Në qoftë se deri në këtë vit nuk e kemi pasur këtë rast, kjo është hera e parë që në Kuvendin e Kosovës për çdo komunë i kemi sipas zërave buxhetorë shpenzimet e parapara për kryetarin kryeshefin, për administratën, për drejtoritë e veçanta. Është përparim, sepse krijon rrëthanë të re të cilën do të kemi mundësi që të analizojmë më

mirë dhe më me transparencë punën e qeverive komunale. Mirëpo këtu automatikisht kjo mënyrë e re e të paraqiturit të të dhënavë më bën t'i bëj disa pyetje.

Psh. si është bërë ndarja e buxhetit për komunat e caktuara p.sh. do t'i marr vetëm dy në krahasim. Është këtu komuna e Gjilanit, pra komuna prej nga vij unë, e kemi pozicionin zyra e kryetarit me 5 të punësuar dhe e cila për pozicionin paga dhe shtesa, i ka të parapara 146 mijë euro, 147 mijë euro dhe e kemi këtu komunën e Prizrenit, e cila te zyra e kryetarit i ka 14 të punësuar, jo 5, i ka 149 mijë euro. Pra cili është kriteri bazë ku për të njëjtin zë buxhetor për një zyre të kryetarit të Prizrenit dhë për një zyre të kryetarit të Gjilanit, duke pasur parasysh numrin e të punësuarve 5 në Gjilan dhe 14 në Prizren i kemi shumat e njëjta. A është kjo një farë preference politike edhe brenda koalicionit për politikanë të caktuar në komunat e caktuara, apo cila është përgjigjja? Unë e kam të qartë, prandaj po e lëmë me pyetje. Ju faleminderit shumë. Shpresoj që herëve të tjera të jem më pak kritikë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Grupi 6+ deputeti Xhezair Murati

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Gospodine predsedniče, ministre, kolege. Mislim da oblast budžeta u sfakom društvu koje vodi računa o sebi dobija sve veći prioritet i ovakve rasprave treba da budu prilika kada çemo biti kritični ali samo kritični kada çemo razmenom mišljenja i predloga doći do željenih ciljeva i oni veçina nas je posetila mnogo razvijene zemlje gde smo videli da je oblast budžeta centar oko čega se vode najveće polemike i gde iza čega stoji največa odgovornost u jednom društvu. Ja se nadam i naše društvo da će ići tim putem i mislim kako koje na čelu komisije za budžetu u Parlamentu Kosova g. Osmani da i oni su stavili u službi pomoći ideja samokritičnosti itu imamo kvalitetne pomakne.

Što se tiče ministarstva koje veoma složeno treba sigurno da se stvori navika kvartalnog iznošenja problematike pred nama ovde kako ovaj svu tu odgovornost preneli građanima koji su nas birali za ovo. Ja bih danas kao pripadnik manjih zajednica krenuo upravo od problema koji se vuku u ministarstvu koje nosi naziv Ministarstvo za zajednice i povratak. To ministarstvo zove se zajednica a pripadal je samo jednoj zajednici. Ja mogu ovde odgovorno da kažem da nikada tu sluha nije bilo za potrebe ostalih zajednica, jer se jedna od malih zajednica izdvojila u odnosu na one manje i ja spadam u one manje, nije bilo sluha. U tom slučaju ovaj mislim da će u narednoj godini i premijer i zamenik premijera i resorni ministar imati više uvida na time kako se koriste sredsta ovog ministarstva i one malih zajednica. U tom slučaju ako smo do sada napravili propuste koje smo imali da vidimo koji je odgovoran za takve prepuste, i u tom smislu ja želim da ovo pitanje da bude otvoreno na jedan legalan način kako to zaslužuje ova Skupština, dalje, sigurno je da bismo preko analize budžeta za iduću godinu trebali izdvojiti prioritete u radu kojim budemo samo se dogovarali iprioritetnoj državne službe što su policija obrazovanje pravosuđe penzioneri i tako dalje sigurno treba da nađemo mogućnosti kako ne bi godinama tapkali u mesto kad se u pitanju recimo materialne nadoknade ovih službi ako želimo da nam društvo krenemo kuda ciljamo.

Dalje, ja bih ovaj rekao da dovršimo ono misao vezano za ministarstvo koji se zova ministarstvo zajednice, mi nismo imali pristupa tu ministarstvu niti imamo centra objašnjenja dakle kako možemo doći do toga da u sredinama gde žive manje zajednice

pomogne u smislu favorizovanja projekata koji se neće baviti povratkom, nego zadržavanjem prvo, ja smatram da prioritet za državanje pripadnika malih zajednica a potom je mnogo skuplja investicija u njegov povratak. Po gotovoaku su zemljama gde su se već ovaj privremeno snašli i tako dalje, šta je sa kulturnim centrima koji treba da integrišu male zajednice još uspešnije, mada moja zajednica spada u uspešnoj integrisane, ali to nije dovoljno mi idemo ka tome da svi budemo ovaj što uspešnije integrisani, ja se zalažem za iduću budžetsku godinu da, ja kad se drugi govorili ja sam čutala i ovaj je sigurno jedan od standarda da se čujemo molim vas, izvinite kolege ovaj ja sam čutao do sada, možda ovo nije važno ali radi se o malim zajednicama, ali je ipak važno.

Predsedniče ja imam primedbu zašto niste umirali pojedine kolege kojima ova matematika nije interesantna. Izvinite ali, ako je suvišno ja mogu da prestanem.

Ja bih ovom prilikom spomenuo još neke vitalne probleme za male zajednice, recimo nigde u budžetu ministarstva za obrazovanje nema stavke o subvencijama za izdavanje udženika za manjite, tiraž je mali, ne isplati se njihovo štampanje, šta da činimo a mnogo puta o tome smo govorili, tiraže su mali, učenici bez udžbenika ne mogu dalje, šta je sa infrastrukturom malih zajednica, bar tamo gde su veće obaveze kad se u pitanju putevi vodovodi iako imamo uspeha u sredinam gde moja zajednica živi ima napretka u tome, a ima sredina gde, šta je sa recimo elektronskom mrežom i signalom RTK-a za sredine gde žive manjine i to veoma bitna stavka, dalje gde je mesto biznisa za pripadnika malih zajednica kad su u pitanju tenderi makar i oni mali, kako bi se i predstavnici ovih zajednica zaposlili, i tako dalje, sve su ova vitalna pitanja ja kažem za sve građane a po gotovu ove male zajednice kad je u pitanju Ministarstvo zdravstva znamo jedno iskustvo koje smo još imali gde ga nismo još okončali i tako dalje, ovde se sad pominje čak i otpuštanje radnika za iduću godine o 200 i nešto radnika i tako dalje, mogu li kapitalne investicije u ovo oblasti pričekati malo, pričekati a da rešimo ono što je prioritetno u toj oblasti tako dalje, dakle ima tu mnogo mnoga toga što o čemu bi smo mogli govoriti o Ministarstvu obrazovanja recimo stavka obuka nastavnika iznosi 240 hiljada euro zamislite obrazovanje oblast koja je temelj svakog društva svakog inašeg gde je sa ovom simboličnom sumom treba da uhvatimo korak sa okruženjem i tako dalje, e pa ako zakasnimo u obrazovanju sa okruženjem onda kud ćemo gospodo, očemo dalje biti radna snaga za zapad i tako dalje, i tako dalje, dakle pitanja je mnogo, odgovora je malo i tako dalje ja kao šef parlamentarne grupe 6+ naravno i kao pripadnik grupe poslaniček koja je u kualiciji uz sve primedbe koje su izneli, i od kolega iz opozicije, i od one koje će biti smatram da će Ministarstvo i Vlada uzeti u obzir sve ove ozbiljne primedbe i naravno da u načelu moramo odnosno prihvatom predlog budžeta ali on može mnogo još da se brusi, da se doteruje, menja i tako dalje kako bi smo ovaj i došli do onoga gde svi želimo jedno stabilno mirno prosperitetno ovaj i u to ime mi podržavamo izveštaj primedbe. Hvala

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëro, Numan Baliq

DEPUTETI NUMAN.BALIQ – Dopustite da u svoje ime u ime Grupe za integraciju iznesem neke stavove koje se tiču budžetu Kosova i naše mišljenje po to pitanju. U cejelini posmatrano budžet je onaj koji odražava napredak u tome smislu koji ima značajne napretke u određenim oblastima, slažem se sa onima što je rečeno naprijed, ali bih obratio pažnju na one djepove koje se tiču nedostataka u oblasti budžetiranja. Posebno na neke, na krupna izdvajanja, na pojedine oblasti koje su malo zapostavljene i šta bis se mglo uraditi u tom smislu da se asprave te stvari.

U celini posmatrano naš je stav i moj je stav da postoji jedna tendencija statičnog prenošenja budžeta iz godine u godinu, danema dovoljno odlučnosti, da nema dovoljno inventivnosti, da Vladi koja se najbolje najbolje odslikava preko budžeta, nema krupnih zahvata, nema ambiciznosti, nema značajni zaokreta i prmena koje bi vodile ka brzim usponima. U celini je nastavak jednog sporog i kontinuiranog razvoja institucije Vlade i budžeta. Misli da su ovi zaokreti i zahvati budžeta neophodni tako da počeću sa nabrajanjem u oblastima, pored onog konstantnog nabrajanja redom znači predsednik Skupštine, Skupština, Vlada, Predsednik Kosova, Ministarstvo finansija. Dolazimo do jedne nove stavke, ali nova stavka koja nije u smjeru poboljšavanja funkcije, imamo jednu novu stavku koja se tiče odvajanja za pregovore za status Kosova, možda ona zajbolje odražava status, odnosno karakter sadašnje Vlade. Potpuno je u neskladu ono što se govori i ono što se radi, dakle Vlada govori da će status Kosova biti riješen u januaru a najkasnije u februaru sledeće godine, a sa druge strane se izdvaja četiri ipo miliona eura, znači to je jedna nesuglasije koje govori o jednoj nepouzdanosti Vlade i nerazumjevanje vezano za ovo pitanje. Takodje, ima nekoliko drugih ovih stavova vezano za ovo. Kaže se Kosovo će biti nezavisno u februaru i nema više pregovora, znači nemamo s kim da pregovaramo ako nemamo skim da pregovaramo onda što će tih četiri ipo miliona eura i čemu one služe, to su odgovori na koje Ministar finansija i Vlada Kosova trebaju dati odgovor, naravno sve ovo idu i odgovori gde su dosada potrošena sredstva vezano za pregovore o statusu Kosova. Nije dovoljno. Ovde ću ponoviti jedan princip da se iznese krupna tabela u krupno i da samo piše ta i ta stavka 5 miliona ili 10 miliona ili 15 miliona bez ikakvog detaljnog objašnjenja, to je nedopustivo i sa ovog mesta zahtjevam da se u vezi sa ovim ptanjem dadne detaljan pregled o pojedinačnim stavkama, o dosadašnjim potrošenom novcu vezano za pregovore i o budućem novcu oko toga o planu kako će se on potrošiti ubuduće.

KRYETARI – po vlasim per buxhetin e vitit te ardhshem ju lutem

BALIQI – razumjem veoma dobro g. Predsedniče, pitanje je sasvim opravдан. U vezi sa budžetom za Ministarsvo za poljoprivredu, šumarstvo i seoski razvoj. Kosovo je kao što se zna bilo i još uvijek je seosko područje, selačka zemlja gde je više od 60% je poljoprivredno područje. Njeverovatno je za razvoj sela izdvojeno 415.000 eura, kao što sam i ja sa sela koji su mnogi od vas imam taj dug prema selu da to ovde kažem, ujedno Ministarstvo koje je potpuno zapostavljeno i već radi na uništavanju sela ne govorimo o emigraciji, grad i premeštanje i mnogo dojučerašnjih selana u centlove gradove koji sada pristupni po cijelom Kosovu. Mislim da je nodopustivo da od bužeta koji ima 717 miliona eura da se manje od pola miliona eura izdvoji za razvoj sela, to je nedopustivo. Sve razvijene zemlje u svjetu gaje svoje razvijenosti i počiva na razvoju poljoprivrede i sela, prema tome možemo da se ovakva politika ignorisanja čitavih područja nastavi u okviru Vlade. To su ona krupna zaokretanja promjene koje inventivne i ambiciozne vlade uvek preduzimaju ako hoće da znakovito pomjere jednu zemlju napred i da izvuku iz zaostalosti nažalost ova Vlada jošuvek nema.

U vezi sa Ministarsvom za transport i telekomunikacije, ponovo ću govoriti o krupnim stavkama. Interesantno je da je u okviru ovog Ministarstva za izgradnju novih puteva ukupno izdvojeno osam ipo milijuna eura a da je za opravku puteva za održavanje i rehabilitaciju puteva izdvojeno 18 miliona eura. Upada u oči da ova Vlada apsolutno poseže kao i ranije za npopularnim mjerama. Upravo su najveća govorkanje u narodu da najveći broj tih sumljivih tendera i griješno potrošenih para upravo ide u te, u

održavanju puteva neprekidnog krpljenje puteva i radjenja puteva čiji rok trajanja jedna budžetska godina, pa se naredne godine ponovo pokripi i to traje dok se naravno ne prodje fiskalna godina. Nedopustivo je da se za izgradnju puteva ponavljamajam izdvoji 8 miliona a da se dvostruko više odnosno više nego toliko izdvoji za opravku i rehabilitaciju puteva, i nigde nije predvidjeno pravljenje autoputeva, autostrada Kosova, jedina teritorija na prostorima nekadašnje Jugoslavije koja nema nijedan kilometar autoputa, pogledajte okolinu. U Albaniji se grade trasniće prema sjeveru i prema jugu, i prema Skadru i prema Vlori, prema Grčkoj na sve strane i prema Ohridu takodje. Mi nemamo jošuvec nijedan kilometar autoputa. Sve ostaje na dobrim planovima, na budućnosti, na to kako ćemo mi nekada da bog da imamo sve i svačega. Mislim da je nedopustivo ovakva politika globalnih odnosa u svim ovim sferama koje sam ja spomenio.

U oblasti Ministarstva zdravlja takodje upadaju u oči neke krupne stavke koje su statično nepovoljne i ne obećavajuće. I ovde imamo ono što je tokom minulog štrajka u Kliničkom centru gde je puno govorenog a to je ta nespremnost Vlade da posegne za tim hrabrim potezom koji se tiče povećavanje plata. Zašto na Kosovu Vlada Kosovo nije u stanju da poveća plate u ukupnim civilnim službama a posebno na Kosovu, molim vas moramo staviti prst ovde i reći sebi kako uspjeli sve vlade u susjedstvu čak i one za koje smatram da su mnogo nerazvijene ili su tu negde sa nama, hajde da su nešto malo razvijene, uzmem za primer Crnu Goru i Makedoniju daleko ispred nas vezano za plaće lekara i zdravstvenog radnika. Razumjem, naravno postje ograničenje na međunarodnog monetarnog fonda, razumjem na pravila koje postoje da sve to moramo poštovati ali kako je uspjelo svima da plate u susjedstvu budu dava puta, tri puta i pet puta veće nego kod nas a mi to nikako ne možemo, onda nešto nije u redu sa nama. Molim Vas moramo obratiti pažnju na ovo i posebno ako imamo u faktu dva krupna odvajanja a to su, recimo za platu na nivou Ministarstva zdravlja odvojeno 18 miliona, dok je za robe i usluge izdvojeno 21 milion eura, pa koje su sada robe i usluge i kakvih se to sve roba i kako sve to vrsta usluga treba da namiri to Ministarstvo zdravlja pa da nama bilo dobro. Nešto nije u redu, apsolutno da nije u redu. Ovo nije kritizerstvo, nije namera da ja ovde baljam drvo i kamenje na nekoga, nego da se ozbiljno razmišljamo zašto nama nikako ne uspjeva 7 godina iza rata da se pomaknu plate da jedan ljekar ima platu 210 eura, to je nedopustivo a u susedstvu imaju 800, 1500 i 2000 eura, to je nedopustivo, nešto nije u redi ni sa nama ni sa Vladom ni sa Ministarstvom zdravlja, to se mora mjenjati, mora se menjati.

U vezi sa primarnim zdravstvom, takodje mi ovaj od čuvenih odslučavajućih fenomena koji govore o karakteru Valde, o tome šta se priča i o tome što se radi. Kaže se Ministarstvo zdravlja prema usvojenim reformama, oprostite primarno zdravstvo prema usvojenim reformama u svjetu, svugdje u svetu obavlja 80% zdravstvenih usluga, molim vas, 80% zdravstvenih usluga prema svjetske zdravstvene organizacije danas se obavlja preko primarnog zdravstva. Vidite koliko su izdvajanja za primarno zdravstvo 455 hiljada eura, znači 0,87% od ukupnot manje od 1% od ukupnog budžeta Kosova, pa kako je moguće sa tako malim izdvajanjima da unaprijedimo granu koja obslužuje 80% svih pacijenata na Kosovu a da ne govorimo na to da postoji djelovi na Kosovu gde su domovi zdravlja u jadnom stanju, gdje nemaju opreme, gdje nemaju tehnike, nemaju možda ultrazvuke ili bilo čega što je neophodno za rad, EKG aparate i tako dalje, laboratorije i tako dalje ili posebno dramatičan slučaj kao što je Peć i gde glavni familijarni centar u Peći uopšte nema zgradu doma zdravlja, dakle nemaju zgradu, nemaju mesto gde će se nalaziti. Ne mogu da prihvatom budžet Vlade Kosova koji ne predviđa da se u narednoj godini izdvoji 300 hiljada ili 500 hiljada eura za izgradnju Doma zdravlja u Peći. To su stvari

koji moraju popraviti. U vezi sa Ministarstvom za povratak potpuno se slažem da to Ministarstvo za povratak i zajednice treba služiti svim zajednicama da se ne treba pretjerano mješati u UNDP, da se ne može izvršiti izdvajanje samo za srbe, da se treba rešiti afera Petković i da to Ministarstvo treba služiti svim zajednicama koje se tamo nalaze. Ovde bih takodje ono što sam zaboravio da kažem da za Ministarstvo zdravlja nema nikakve stavke koje se tiču razvoja banje i Pećke banje, koja je nekada bila centralna institucija na Kosovu i koja danas nema mogućnosti u budžetu ne postoji ona je jednostavno zapuštena, to je jedan bivši sanitorijum, jedna centralna institucija koja je potpuno zapostavljena. Ima naravno mogih stvari koje sam htelo da kažem ali zbog nedostatka vremena ovde ću da završim i da se zahvalim i nadam se da će ovo biti ozbiljna razmptreno i da čemo dobiti detaljan izveštaj iz svega ovoga. Hvala Vam!

KRYTARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju lutem ,fillojmë me punë, Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

DEPUTTI SABRI HAMITI – Zotëri kryetar i Kuvendi. Unë dola më shumë për një sqarim. Deputeti Jashari, duke biseduar për investimet kapitale të cilat nuk realizohen, mori një shembull të veçantë në logjikën e vet, karakterizues për këtë problem që shqyrtoi, që është e drejtë e tij ta shqyrtojë dhe unë nuk e kontestoj asesi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe ai përmendi që ekziston një milion euro për ndërtesën e Akademisë, që përsëritet nga viti i kaluar. Unë e plotësoj, jo nga viti i kaluar, por nga viti i parakaluar- kemi dy vite. Pra, unë po sqaroj asgjë më tepër që kjo shumë përcillet. Deputeti Jashari tha që ai dyshon se nuk ekziston plani as projekti, dhe as leja.

Unë e informoj kolegun, që ekziston leja për ndërtim, ekziston plani i ndërtesës, ekziston lokacioni dhe ndërtimi i ndërtesës së Akademisë, e cila si institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit kupola e dijes së Kosovës, është i domosdoshëm për shkak se ky institucion është i vendosur në një shtëpi të vjetër prishtinase, në një lokal tepër të ngushtë. Pra, problemi ku qëndron? Problemi qëndron që në lokacionin që i është ndarë Akademisë ekziston në Institutin Gjyqësor, i cili ka qenë nën kompetencat e ESB-es deri vonë dhe ata nuk kanë gjetur mundësinë që edhe pse me planin urbanistik duhet të zhvendoset ajo shtëpizë prej aty që t'i gjejnë vend dhe ta zhvendosin. Më vonë ky institut kalon në kompetenca vendore, t'i quajmë ..... Qeveria ende nuk ka ndodhur kjo. Problemi ekziston ,të gjitha rregullat janë plotësuar, ai 1 milion shëtit për shkak të këtij problemi. Çka thotë kjo? Kjo thotë që nuk ka fuqi ekzekutive të vendimeve që merren. Ky është sqarimi im. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në sallë momentalisht kemi 71 deputetë. Urdhëroni z. Jashari replikë.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Më falni z. Hamiti. Absolutisht nuk keni kundër , esenca e fjalës sime ishte që Akademia ka nevojë për ndërtesë. Esenca ishte që ndodhet në një hapësirë të papërshtatshme. Thelbi qëndron aty që 1 milion euro janë të ngrira dhe duhet të tempohen në kohë edhe të projektohen ashtu që të mos rrinë të ngrira ,sepse kjo ekonomi ka nevojë për para. E kur 1 milion euro rrinë të ngrira, ato pars nuk lëshohen në qarkullim. Këtu është thelbi. Pra unë jam dakord që Akademia duhet ta ketë ndërtesën e vet. Jemi dakord që ai investim të kryhet , por nuk ka mundësi të realizohet, të lihet për vitin e ardhshëm ,të mos parashihet për sivjet. Ju thatë që nga viti i parakaluar, unë supozova që

mund të bartet edhe për vitin tjetër, pra 1 milion euro po na enden vazhdimisht të ngrira. A ka nevojë për rrugë, për shkolla, për investime të cilat nuk kanë probleme, kur të krijohen rr Ethanat të bëhet ai investim. Nuk është çështja se ato para patjetër duhet të rrinë aty për Akademinë, kur krijohen rr Ethanat.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Profesor Hamiti urdhëroni.

**DEPUTETI SABRI HAMITI** – Shikoni unë jam anëtar i Akademisë dhe po përpinqem të sillem si akademik në këtë rast. Shembulli nuk është ilustrativ, unë edhe këtë desha ta them dhe të jap shpjegime. Kolegu herën e parë tha dyshoj, mirë është e drejta e njeriut të dyshojë. Në këtë rast s'ka çka kuption në kuptimin e rregullsisë së kërkesav. Nëse ekonomia e Kosovës ka pësuar pse 1 milion i Akademisë është bartur prej vitit tjetër, është harxhuar, atëherë kjo punë rregullohet po unë po ju them që ka tepër shumë miliona të tjerë, që në investime kapitale nuk janë kryer dhe nuk është shembulli tipik. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Mos ta bëjmë tash temë këtë rast, pasi e kemi pikën e rendit të ditës të caktuar. Fjalën e ka deputeti Afrim Arzuallxhiu,

**DEPUTETI AFRIM ARZUALLXHIU** – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra prezantë, kolegë të nderuar. Jemi duke diskutuar për një projektligj të rëndësise të veçantë, prandaj edhe unë si të gjithë të tjerët jam munduar ta analizoj Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 dhe natyrisht në suazat e mundësive të mia të jap kontributin tim në këtë aspekt. E meta kryesore, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji mendoj se është mungesa e pasqyrave të detajuara të shpenzimeve kapitale të mallrave dhe shërbimeve, Ndoshta ju zoti ministër e dini sigurisht se përmendësh këto nuk janë bërë, janë hartuar në bazë të projekteve, mirëpo meqenëse ne nuk i kemi ato projekte, nuk na janë ofruar atëherë informata, për ne është e mangët, për analizë. Gjatë analizës kam pasur parasysh këto tri elemente: Projektligjin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2006, Projektligjin e buxhetit për vitin 2007 dhe natyrisht gjendjen momentale në Kosovë.

Me krahasimin e projektligjeve të buxhetit për vitet 2006 dhe 2007 jam munduar t'i gjej dallimet për parimet dhe dobësitë e projektligjit të propozuar. Dallimet në mes të dy projektligjeve janë shumë të vogla, saqë ndoshta edhe nuk është dashur fare të përpilohej ky projektligj për vitin 2007, por me një fjalë ta kryejë këtë punë. Projektligji i buxhetit 2006 do të vlejë edhe për vitin 2007.

Cilat janë përparimet në krahasim me vitin 2006, ku në disa ka zvogëlim të buxhetit të kryetarit të Kuvendit, të presidentit, të Zyrës së kryeministrat, MEF-it, Ministrisë së Mjedisit, të Planifikimit Hapësinor, të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, të Ministrisë për Administratë e Qeverisje Lokale natyrisht në favor të disa ministritë të cilat kanë pasur edhe nevojë, Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me rritje prej 1. milion euro, Ministrisë së Shëndetësisë 3.3 milionë, Ministria e Arsimit 7 milionë, e Punës dhe e Mirëqenies Sociale 2 milion e kështu me radhë.

Pra, ndryshimet janë të mira, por këto ndryshime janë kozmetike, kurse ndryshime thelbësore nuk ka. Si rrjedhojë e gjithë kësaj, meqenëse nuk ka ndryshime esenciale në

këtë projektligj ,del se jemi jashtëzakonisht të kënaqur me gjendjen ekzistuese në të gjitha fushat , del se politikat sociale janë të mira dhe se duhet të vazhdohet me to. Gjendja e pensionistëve është shumë e kënaqshme me 40 euro duhet të vazhdojnë të jetojnë deri në fund të jetës, gjendja e familjeve të dëshmorëve, e invalidëve, e bonjakëve nuk është e mirë, ngase mbi 50% e popullatës jeton në varfëri,kurse një pjesë e madhe në varfëri të skajshme dhe nuk është problem për këtë Qeveri, nuk ka lidhje, nuk ka derte. Shumë shpejt harruam situatën në shëndetësi që kërkon përkushtim të veçantë dhe zgjidhje urgjente të problemeve në këtë fushë. Po ashtu edhe situata në arsim për Qeverinë ,sipas këtij projektbuxheti ,mund të konkludohet se është e kënaqshme e kështu me radhë.

Kam shpresuar se Projektligji për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 do të jetë dukshëm më i madh dhe se Ministria për Ekonomi dhe Financa do të mundohet të gjejë rrugë për zgjidhjen e problemeve të cekura për rritjen e buxhetit. Kam shpresuar sepse, kam pasur bindjen se Ministria për Ekonomi dhe Financa, megjithatë është ministria kadrovikisht më komplete, ndoshta Ministria e vetme ku edhe ministri dhe zëvendësministri janë ekspertë të kësaj fushe, që deri më tani e ushqen popullin me pretime për status. Brengë ime është se me çka do ta ushqejmë popullin pas definimit të statusit që shpresoj që do të bëhet mars të 2007-ës. Prandaj mendoj se me kohë duhet të parandalohen të këqijat që mund të na ndodhin dhe natyrisht shumë gjëra varen nga ky buxhet që mendoj se është shumë i vogël dhe me këtë buxhet natyrisht se nuk do të mund të sigurohen mjetet e nevojshme për realizimin së paku të një minimumi normal. Shtrohet pyetja ku të merret buxhet më i madh: Sipas mendimit tim duhet të veprohet në dy drejtime. E para, mendoj se kjo çka është në Projektligj nuk është as optimumi i mundësive reale të Kosovës,në fakt është shumë nën minimumin real e të mos flasim për maksimum, gjegjësisht ndoshta është edhe 50% real të buxhetit. Ku bazohem për këtë që po them do të bëj një përllogaritje të thjeshtë. Të hyrat prej TVSH-së, që realizohen, TVSH-së së brendshme dhe në kufi janë rrëth 220 milion euro,që është tregues i brutoqarkullimit në Kosovës në bazë të TVSH-së që kap shumën 1. 5 miliardë euro. Nëse I ndajmë ato në 2 milion banorë dhe në 365 ditë në vit, qarkullimi në Kosovë është 2 euro për kokë banori.

A është kjo reale? A mund me qenë bruto qarkullimi kaq i ulët. Mendoj se kjo nuk është reale. E tërë kjo dëshmohet se diçka nuk është në rregull në sistem ose pjesa më e madhe e mallrave kalojn nëpër kufi pa u doganuar ose baza doganore është shumë nën nivelin e çmimeve reale të prodhimeve që importohen ose që të dyja. Kjo është një çështje me të cilën Qeveria shumë seriozisht duhet të merret dhe me çka do të mund të siguroheshin mjete të konsiderueshme me të cilat do të mund të zgjidheshin shumë probleme apo të zbuteshin shumë. E dyta një prej faktorëve shumë të rëndësishëm që do të ndikonin pozitivisht në ndryshimin e gjendjes buxhetore është ndryshimi i nevojshëm në politikat ekzistuese të gabuara fiskale. Sipas meje politikat fiskale janë shumë shumë të ngushta të lidhura me gjendjen sociale, politikat fiskale janë aq të mira sa është e mirë gjendja sociale e populates. Me politikat fiskale dhe me tatime të ulëta mund të mburremi vetëm atëherë nëse kemi edhe gjendjen sociale edhe për t'u mburrur. Më mirë është të kemi tatime pak më të larta, mirëpo të kemi gjendjen sociale më të favorshme.

Arsyetimi se UNMIK-u apo dikush tjetër, Fondi Monetar Ndërkombëtar, apo Banka Botërore do të na pengojë, nuk mund të qëndrojë. Mendoj se askush nuk mund të na detyrojë që edhe më tutje të lejojmë gjendje të mjerueshme të pensionistëve, invalidëve, familjeve të dëshmorëve, bonjakëve e kështu me radhë, me 40 euro nuk mund të sigurohen

as barërat, e lere ma diçka tjetër. Unë nuk di kjo qeveri çka është duke pritur, a mos është duke pritur që Qeveria të sigurojë këtë, të realizojë këtë. Arsyetimi se fondi është i plaçkitur nuk është arsyetim, se këta janë njerëz tanë, janë prindërit tanë edhe ky mjerim është i patolerueshëm. Mendoj se edhe me këtë buxhet, në këtë drejtim asgjë nuk jemi duke bërë, se mundësitet ekzistojnë, por varet a ekzistojnë qëllimet dhe dëshirat për zgjidhjen e këtyre problemeve. Unë do të jap dy shembuj, për zgjidhjen e këtij problemi.

Nëse TVSH-ja, që është 15%, momentalisht ngritet 20%, që kanë edhe shumica e shteteve në region, atëherë të hyrat do të rriteshin për 75% deri 100 milionë euro, me çka do të zgjidhni shumicën e problemeve sociale. Sigurisht së pari edhe problemet e pensionistëve, kurse në anën tjetër standardi i gjithmbarshëm do të bie diku 2 deri 3 %, që është diçka e pranueshme, diçka e kapshme dhe e realizueshme. Jeta me 40 euro në muaj është e padurueshme. Është koha e fundit të bëhen dallime për ata që kanë punuar dhe për ata që nuk kanë punuar gjatë marrjes së pensioneve.

Edhe një shembull tjetër. Nëse ngritet çmimit të naftës dhe i benzinës për 20 centë, çka do të ndodhë? Meqenëse Kosova për momentin shpenzon 300 milion litra në vjet përafërsisht, me 20 centë faktikisht do të siguroheshin edhe 60 milionë euro. Ne së pari kemi pasur diku 1 euro benzinën edhe asgjë nuk ndodhi, domethënë 20 centë nëse ngriten çmimet e naftës dhe të deriveave të saj, mund të sigurojmë zgjidhjen e problemit të pensionistëve, se Qeveria duhet të hartojë urgjentisht politika të tillë afatgjata fiskale me çka do të evitohen.....

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Selvije Halimi me kartelën e Berat Luhës.**

**DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Ju faleminderit z. kryetarë, të nderuar deputetë.**

Për të analizuar Projektbuxhetin për vitin 2007 ne na kanë munguar projektet detaje të investime kapitale, po ashtu edhe të mallrave e të shërbimeve, gjegjësisht zërave buxhetore. Çështje tjetër është kur plotësohen dokumentet për projektet investive, të cilat do t'i marrë Qeveria si prioritet. Aty bëhet edhe një parallogaritje se investimi i caktuar kur do t'i sjellë përfitim Qeverisë, gjegjësisht institucioni dhe në këtë projektbuxhet në këto tabela nuk shihet një parallogaritje e tillë.

Qeveria e Kosovës, si duket, kur e ka hartuar Projektbuxhetin për vitin 2007 e ka harruar programin e Qeverisë të Kosovës 2004-2008. Me jua përkujtuar vetëm disa prioritete kryesore të kësaj qeverie që as me projektbuxhetin e vitit 2005 as të 2006-shtës, si po shihet as me projektbuxhetin e vitit 2007, nuk shihet as përsëafërmë se ka bërë një ndarje të prioriteteve të saj, gjegjësisht ka realizuar priorititetet në programin e vet qeveritar, mbi bazën e të cilit punon. Pas zgjedhjes së kryeministrit Qeku, kryeministër i Kosovës ka premtuar priorititetet në tri EEE, Energetikë, Ekonomi dhe Arsirim. Edhe me këtë projektbuxhet nuk shihet se këtyre tri E-ve për vitin 2007 po u jepet prioritet, do të thotë që në start shihen dështime.

Në faqen tetë të programit qeveritar thuhet se Qeveria do të iniciojë që gjatë vitit 2005 të nxirret plani strategjik zhvillimor ekonomik i Kosovës i mbështetur nga plani strategjik sekutorial.

Deri më tash kemi një shpenzim bukur të madh për këtë plan zhvillimor dhe që përfundon në vitin 2006 ,por këtë plan ende nuk e kemi. Gjithashtu janë bërë shumë shpenzime në planet strategjike sektoriale të cilat nuk duhen të inkorporohen në planin zhvillimor të Kosovës, në planin zhvillimor ekonomik edhe ato kanë mbetur ose të aprovuara vetëm nga Qeveria pa u sjell në Kuvend, ose nuk kanë shkuar fare në Qeveri, mirëpo shpenzimet për ato plane janë bërë, pavarësisht se ka pasur në disa plane sektoriale donacione të huaja. Edhe buxheti i Kosovës ka bërë një shpenzim të konsiderueshëm në hartimin e këtyre planeve, atëherë çka të bëhet me Projektbuxhetin e vitit 2007 , sa është serioz ky projektbuxhet dhe sa është përmbushur premtimi në programin qeveritar vetëm për vitin 2005, pa e analizuar vitin 2006 fare, domethënë jemi mbrapa për një vit qysh në start.

Të nderuar deputetë dhe jut ë kabinetit qeveritar, unë në Projektbuxhetin e vitit 2007 në Projektligjin kërkoj që kriteret e përgjithshme për hartimin e memorandumeve të mirëkuptimit të organizatave buxhetore, qendrore, të hyjnë në këtë projektbuxhet si kriterë të përgjithshme,në mënyrë që kur të lidhen në memorandumet me organizatat buxhetore për mënyrën e shpenzimit të të hyrave vetanake, të mos ketë laramani, apo të mos shkohet me standardet e dyfishta. Sigurisht ministri i Ekonomisë dhe i Financave e di shumë mirë se për çka e kam fjalën.

Më pastaj, duke iu referuar një shkresë të 11 gushtit 2006 ,mbi cilat kërkohet që të bëhet një rivlerësim i investimeve kapitale të vitit 2006 dhe të bëhet një konfirmim për projektet apo investime kapitale të vitit 2007 të parapara e dhe vitit 2008 dhe më pastaj duke pasur për bazë vendimin që do të bëhen bartjet buxhetore për investimet kapitale për ato projekte, të cilat nuk janë kryer, mendoj që Ministria e Ekonomisë dhe Financave, gjegjësisht ministri Shatri duhet që këtë vendim, meqenëse është marrë si i tillë , ta zbatojë për të gjithë sektorët qeveritar, gjegjësisht për të gjitha ministritë. Edhe këtu besoj që ministri e di për çka e kam fjalën ,sepse jam tash në fund një dokumenti të cilin e kam në shumë 400 ose 500 mijë euro,për të cilat ende nuk po lejohet bartja.

Çështje tjeter, ne si deputetë të këtij Kuvendi ende nuk kemi sqarim të arsyeshëm apo qoftë edhe të paarsyeshëm ,sepse dështoi sistemi i nivelizimit të pagave dhe për vitin 2007 kemi një diferencë shumë të madhe në paga.

Një ministri e kësaj qeverie pagën mesatare e ka 212 euro për të shkuar në Ministrinë ku paga mesatare më të lartë, gjegjësisht është, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave është 317 euro, kurse paga më e ulët në Ministrinë e Shëndetësisë. Unë kërkoj që ,meqenëse ky projektbuxhet aprovohet në parim , të rishqyrtohet mundësia dhe të ngritten pagat në sektorin shëndetësor nuk mund të ketë page mesatare 212 euro,kurse e Ministria e Financave 317 euro. Pse kjo laramani kaq e madhe, pavarësisht çfarë rëndësie ka.

Çështje tjeter, ne kemi ftuar dje në komisionin për zhvillim rural dhe planifikim hapësinor kemi ftuar ministrat e këtyre dy ministritë gjegjësisht zëvendës ministrin Tom Hajdaraj dhe ministrin e planifikimit Ardian Gjini.

Ministri i Bujqësisë ka prezantuar në takim dhe sipas asaj çka ne kemi diskutuar në Komision, jam i bindur se kjo ministri duhet t'u japë përparësi investime kapitale, kurse nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor ministri nuk ka qenë prezent me

arsyetim se ka qenë në mbledhjen e Qeverisë, thua se ministri i Bujqësisë nuk paska pasur mbledhje të Qeverisë dhe ka ardhur zëvendësministri, i cili na ka sjell një tabelë ku shihet se të gjitha investimet kapitale të parapara për vitin 2006 barten në vitin 2007.

Atëherë ky është një shembull më i mirë se si menaxhohen investimet kapitale në kuadër të një ministrie.

Edhe një gjë dua ta them për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, se me Ligjin për ujërat kjo ministri është përgjegjëse për sigurimin e ujit të pijshëm, kurse ministria tjeter, gjegjësisht e Shëndetësisë, në sektorin e saj është e autorizuar apo përgjegjëse për kontrollimin e kualitetit të ujit të pijshëm. Ne edhe sot nuk kemi strategji të ujërave në Kosovë dhe ende ballafaqohemi me epidemi nga ujërat e papastratë të cilat shfrytëzohen për pije.

E pastaj kërkojmë një përgjegjësi më të madhe të sektorit shëndetësor që ballafaqohet me këta pacientë të sëmurë nga epidemitë mungesë e ujit të pastër për pije, apo të ujit me kualitet për pije, dhe pagën e lëmë në nivelin më të ulët në kuadër të qeverisë vetëm 212 euro, ndoshta një arsyetim mund të jetë në ministrinë e shëndetësisë ka shumë kuadër shëndetësor me nivel të mesëm shkollor. Kjo nuk mund të merret si arsyë. Edhe një herë po e përsërisë kërkoj që të bëhet një rishikim ose të bëhet nivelizimi në afatin sa më të shpejtë të mundshëm, ose të ngritën pagat në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të mos ketë një dallim kaq të madh.

Ministria e Financave ndanë vetë buxhet dhe ka mesatare 317 euro, kurse ministria e shëndetësisë vetëm 212 euro. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi**

**DEPUTETI BAJRAM KOSUMI – Ju faleminderit kryetar i Kuvendit, të ndërruar ministra deputetë. Fillimisht dëshiroj të konstatoj se ka disa rrjedha pozitive në buxhetin e vitit 2006, e në disa pika është një proces i këtyre rrjedhave pozitive edhe në vitet paraprake, siç është rritja e të hyrave 4% ma shumë se në vitin e kaluar e po ashtu në vitin e kaluar ka qenë një përqindje më tepër se në vitin paraprak. Po ashtu ka një zvogëlim të balansit midis të hyrave dhe shpenzimeve duke sjellë këtë shifer te 34 milionëshi që është një sukses i Qeverisë, po ashtu ka një klimë më të mirë për investorët e jashtë kështu që është vlerësuar pozitivisht prej institucioneve ndërkombëtare që ka një rëndësi të madhe për prosperitetin ekonomik të Kosovës. Po ashtu ka një rritje tregues shumë pozitiv për zhvillimin e ekonomisë në Kosovë.**

Për këtë pjesë që e thashë nuk do të ndalem më gjatë vetëm kisha dashur nga ministri Shatri që të na jepë një sqarim-ku-thotë se mungesa prej 34 milionëve ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve do të plotësohet nga rezerva në kesh që në fund të vitit 2007 duhet të jetë 75 milion euro. Nëse nuk gaboj rezerva në fund të vitit 2006 duhet të jetë rrëth 50 milion euro, a mund të na e jape një një sqarim për këto diferenca, te kjo rezervë që dihet që është shumë e rëndësishme që të jetë e sigurt.

Për pjesën tjetër, unë e di sa vështirë ka qenë të hartohet një Projektligj buxhetor për vitin 2007 sa mundin e kanë pasur Qeveria, ministrat, kryeministri dhe Fondi Monetar Ndërkombëtarë bashkë me ta. E kuptoj atë, po ashtu e di se edhe ne deputetët sot këtu e kemi vështirë të diskutojmë, sepse dy të tretat e këtij buxheti shkojnë në paga, në mallra, në shërbime, por cilat janë fikse nuk dallojnë shumë prej viti në vit.

Prandaj, realisht ne sot nuk mund të bisedojmë për, ose s'kemi shumë çka të themi për 480 milion, eventualisht për këtë pjesë të buxhetit mund të diskutojmë për politikat afatgjata, jo për ato politika që mund të ndikojnë në këtë vit, sepse nuk mund t'i ndryshojmë në këtë vit pagat, mëditjet, mallrat, shërbimet, sepse janë fikse dhe nuk ndërrojnë, por mund të bisedojmë për politikat afatgjata në këtë pjesë të buxhetit, siç është, ndryshimi i politikave sociale në Kosovë në favor politikave arsimore. Qe shtatë vjet në Kosovë është udhëhequr një politikë e fortë sociale, por pavarësisht prej argumenteve pro kësaj politike sociale. Unë e ftoj Qeverinë që të debatojë dhe në Kuvend për ndryshimin e këtyre politikave sociale në favor të ngritjes dhe të forcimit të politikave arsimore, sepse e ardhmja e shtetit të Kosovës nuk mbështetet në ndihma sociale, por në arsimimin, edukimin e gjeneratës që do të udhëheqë m Kosovën.

Po ashtu një çështje tjetër që duhet të diskutohet në kuadër të kësaj pjese të buxhetit, është reforma e administratës publike. Kisha ftuar Qeverinë që të fillojë me hapa shumë të vendosur në këtë drejtim, sepse administrata publike në Kosovë është e stërgarkuar, prandaj duhet të lirohet. Unë nuk kisha thënë të lirohet me përqindje, qysh po bëhen tash disa përpjekje me 10% ose 20%, po të bëhen në bazë të analizave ku mund të reduktohet administrata publike që ta lirojë buxhetin.

Tash vijmë te letra e qëllimit ose te letra e qëllimit të mirë e nënshkruar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, e cila krijon disa kufizime për buxhetin e Kosovës. Është e vërtetë se kjo letër na shtrëngon ne sikur darët. Po të kemi parasysh që respektimi i kësaj letre është berë për Qeverinë e Kosovës dhe për Kosovën që të hyjë në programet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankës Botërore, por nuk i respektuam kriteret e kësaj letre, ne mund të mos i respektojmë, por dera për të hyrë në programet e Bankës Botërore do të jetë e mbyllur për ne. Prandaj, duhet t'i respektojmë në mënyrë strikte ato që kemi nënshkruar vetë me letrën e qëllimit të mirë.

Tash po flas për një të tretën e buxhetit.

Një e treta e buxhetit është në investime kapitale. Fatkeqësisht në projektligj shkruan që me këtë projektligj është edhe tabela e investimeve kapitale, por nuk është, do të thotë edhe këtu nuk kemi çka të diskutojmë, por e kisha lutar ministrin që sa më parë t'ua shpërndajë deputetëve programin e investimeve publike dhe listën prioritare për investime për vitin 2007, sepse në këtë listë shihen politikat e ministrive. Këtu e shohim për secilin ministri çfarë politika ka udhëheq, si mendon të udhëheqë në vitin 2007.

Unë tash do të ndalem në dy propozime që kanë të bëjnë për këtë projektbuxhet dhe për buxhetet e ardhshme.

Duke e ditur se nënshkrimi i marrëveshjeve për tregti të lirë në një, ndërsa nën dy, zgjidhja e statusit final të Kosovës dhe procesi i integrimeve evropiane do ta na detyrojnë që t'i ndryshojmë politikat doganore. Ende nuk e dimë sa s do t'i ndryshojnë këto politika doganore, por sigurisht 50% dy vjet e para do t'i ndryshojmë dhe ky tregues tregon që dy

vjet pas statusit final të Kosovës ne do të ballafaqohemi me faktin që të hyrat në buxhetin e Kosovë të jenë ndoshta nga doganat 50% më të vogla.

Kur e keni parasysh këtë fakt kisha ftuar Qeverinë e Kosovës dhe partitë politike, sepse kjo nuk ka të bëjë vetëm me këtë qeveri, por, që të fillojnë ta hartojnë projektin për politikat e reja fiskale në Kosovë, të cilin ne do të kemi parasysh si të krijohet një sistem ku tatimet të vilen brenda, jo në dogana por të vilen brenda, kjo e anashkalon rrezikun me të cilën mund të ballafaqohet shteti i Kosovës në momentin kur të krijohet, për mungesë të mallit e të buxhetit.

Pra, i kisha lutar Qeverinë e Kosovës, kryeministrin dhe të tjerët, por edhe partitë politike që e bëjnë këtë Qeveri, por e bëjnë partitë në zgjedhjet e ardhshme nacionale, do të krijojmë politika të reja fiskale.

Çështja e dytë që kisha ftuar Qeverinë është të mendojë edhe ndoshta të negocijë me Fondin Monetar Ndërkombëtarë për krijimin e fondeve të veçanta në kuadër të buxhetit të Kosovës. Si për shembull krijimi i fondit për rrugët, një fond i veçantë për rrugët ose krijimi i fondit të veçantë për bujqësinë. Kjo nënkuption ndryshimin amendamentimin e ndryshimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike, por nëse hyjmë në këtë rrugë të jeni të sigurt që ne mund të kemi sukses më të madh në shumë fusha dhe do të hapim një derë që do të na krijojë mundësinë për sukses.

Dhe në fund, nëse më lejohet, si për shaka ta them, gjithë ata deputetë që e kritikuan buxhetin e Kosovës duke thanë se është i njëjtë me vitin 2006 i faleminderoj, për komplimente që po i bëjnë.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ragip Zekoll me kartelën e Naser Osmanit.

**DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI** – Faleminderit z. kryetar. Unë do të ndalem vetëm te një çështje e buxhetit, që është tejet e rëndësishme, fjala është për arsimin dhe në këtë sferë do të mundohem të fokusohem vetëm në çështjen e buxhetit kapital. Nuk mund ta mos filloj me një thënie të Bone Millerit në librin e saj” Nëse do të financosh për një vit mbill arën, për dhjetë pemën, a nëse do ta arsimosh për 100 vjet popullin - financo në arsim.” Mua më vjen mirë që Qeveria ka krijuar politikën tri e-sh që u përmend edhe më herët qoftë nga kolegët po edhe është duke punuar në dy strategji edhe në strategjinë e arsimit edhe në atë për zhvillimin e Kosovës.

Por desha të ndalem tek çështja e buxhetit kapital, e cila mendoj se në Kosovë duhet të jetë njëri ndër prioritetet kryesore.

Kryetari i Komisionit për Arsim paraqiti një të dhënë që 120 milion euro nuk janë shfrytëzuar, andaj mendoj që Ligji për prokurimin, i cili është pikërisht në fazën e amendamentimit të jetë një ligj i cili krijon mundësi më të shpejta të këtyre rrjedhave dhe në anën tjeter në planin e ardhshëm pesëvjeçar të kemi një infrastrukturë më të mirë shkollore për arsy se Kosova për momentin është edhe në vendin e fundit në Ballkan. Kur po e them këtë unë u mundova të shoh statistika dhe të dhëna të cilat kanë ofruar edhe komunat dhe Ministria e Financave dhe janë vetëm 8 komuna që në sferën e arsimit ndajnë një shumë të caktuar të mjeteve për investime kapitale.

Ndërsa nga radhitja buxhetore e 33 komunave, sa janë, vetëm 12 prej tyre do të thotë e kanë në fordin e tyre buxhetin për shpenzime kapitale ,ndërsa te 21 mungon. Cili do të ishte faktori që do të na ndihmonte më së shumti që me dalë nga kjo situatë. Unë mendoj se deri në vitin 2012, nëse do të arrinim ne që të eliminojmë mësimin në tri ndërrime që thashë jemi të vetmit, mendoj se ka formë edhe mundësi për ta kaluar këtë. Ajo formë edhe mundësi që mendoj se janë për t'u tejkaluar ,që e përmendi një nga kolegët e mi dhe mendoj që Ministria duhet ta ketë parasysh këtë çështje dhe ajo mund të kalonte nëse do tas vendoste një taksë të veçantë për arsimin qoftë në duhan, qoftë në alkool apo qoftë edhe në derivatet e naftës. Dhe për ta realizuar një mësim më cilësor të arsimit, si po përmendim reformën në këtë fushë, ju lutem ju dini që kriteri i Bankës Botërore është 21.3 e Përmendëm për numrin e nxënësve në paralele, por unë po ju jap të dhënat e fundit që nxënës në këtë vit me sukses shumë të mirë edhe të shkëlqyeshëm nga Prishtina kemi çuar edhe në Fushë Kosovë edhe komunat përreth për arsy se nuk kanë mundur të vendosen në objektet shkollore. Faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Sala Ahmetaj, le të përgatitet deputetja Safete Hadrgjonaj.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ – Inderuari kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë. Projektligjin për buxhetin e vitin 2007 edhe pas një vështrimi të gjatë nuk arrita ta zbërtheja dhe ta kuptoja se cilat do të janë çështjet parësore të Qeverisë për vitin e ardhshëm, apo ndoshta edhe kësaj radhe buxheti do të shpenzohet vetëm për paga dhe mëditje për mallra e shërbime. Pra, faktet nuk janë shpresëdhënëse, sepse ky nuk do të jetë buxhet zhvillimor e as i projektuar.

Vendet si Kosova do të duhej të kishin prioritete që u sigurojnë zhvillim ekonomik. Ne mendojmë dhe jemi thellësish të bindur se zhvillimi i mirëfilltë do të ndodhë vetëm në qoftë se arsimi trajtohet si çështje parësore. Reforma në arsim për të cilën po flitet zëshëm duket vetëm formë ,por jo përbajtje. Për këtë mund të numërojmë shumë fakte, sa ka investuar dhe sa po investon Qeveria e Kosovës që këto reforma të ndodhin realisht, fare pak. Kjo është për të ardhur keq. Sipas tabelave tejet abstrakte,të paqarta ,pa të dhëna të detajuara dhe me shkronja të cilat mund të shihen vetëm me mikroskop, ne nuk dimë cilat do të janë investimet në arsim dhe sa do të janë ato.

Ne dhe arsimtarët e Kosovës do të donim të dinim sa do të jetë paga e tyre për këtë vit, a do të vazhdojnë institucionet e Kosovës të sillen me përbuzje dhe me përcëmim ndaj tyre? Kam frikë se po. Prandaj kërkoj nga ministri i Ekonomisë që të na japë sqarime shtesë dhe të përgjigjet në pyetjen të cilën e presim me shqetësim. Pyetja është?

A do të ketë rritle të pagave për punonjësit e arsimit dhe sa do të jetë ajo? Jemi të vetëdijshëm se Kosova ka shumë prioritete si për shëndetësi, për familjet e dëshmorëve, për memorialet, për çështje sociale etj, por së pari do të donim të dinim a ka strategji dhe cilat janë ato projekte kapitale për arsim, a mund të shpresojmë që mësimi në qytet do të mbahet në vetëm dy ndërrime ose edhe vetëm me një ndërrim.

16 milion që janë ndarë për projekte dhe investime për arsim nuk e dimë se për çfarë prioritetesh janë përzgjedhur. Ku do të investohen këto par?. Për arsim është paraparë të janë vetëm 4.7% e buxhetit të përgjithshëm. Shumë pak si buxhet për ata që pohojnë se

prioritet e kanë edukimin, sepse për të qenë arsimi prioritet do të duhej të ishte së paku 10 ose 15% e buxhetit të Kosovës e planifikuar për arsim.

Prandaj, unë ftoj deputetët që të dalin në mbrojtje dhe përkrahje të vlerave. Duhet të gjenden shtigje dhe mundësitë që ta shpëtojmë arsimin dhe ta vëmë në binarë të duhur. Dje punonjësit e arsimit dhe Ushtria Çlirimtare mbanin mbi supe satin e Kosovës, kurse sot ato janë keqardhja jonë, janë të përbuzurit tanë. Kështu nuk krijohet sistemi i vlerave, as shteti, këto ndërto dëshiron dhe bëhen vetëm duke ia rikthyer dinjitetin dhe vlerën mësuesit dhe arsimit. Nuk mund të shpëtojë nga rrënimimi sistemi arsimor që paguan mësuesin 170 euro e që i ofron klasë me 45 nxënës e në tri ndërrime. Reformimi bëhet me strategji afatgjatë, qoftë edhe me kosto të lartë, të detajuar dhe që do të zbatohet me përpikëmëri, por kjo arrihet vetëm duke ndërruar mendësinë tonë, qasjet tona, kjo bëhet duke rritur përqindjen e buxhetit të arsimit. Kështu kanë vepruar shumë vende. Shiheni ta zëmë shembullin e Irlandës, investimin në arsim atë e ka ngritur në mesin e vendeve më të zhvilluara.

I ftoj deputetët, që të mbështesin propozimin tonë për të shikuar mundësitë për të rritur bindshëm përqindjen e buxhetit të arsimit, nëse e bëjmë këtë sot frytet do të shohim në të ardhmen dhe kjo mund të bëhet duke i rrudhur disa veprimtari të cilat mund të presin, duke i mënjanuar lukset dhe komoditetin e tepruar. Jemi të bindur se kur ka gatishmëri shtigjet dhe mundësitë gjithmonë gjenden.

Unë do të doja të diskutoja edhe për detaje të tjera por ato nuk na janë ofruar. Ne nuk dimë a ka strategji dhe cilat janë priorititet kapitale. Nga të dhënat që kemi shohim se ende nuk jemi mësuar të kursejmë dhe të shpenzojmë më pak. Prandaj, është e domosdoshme të bëhen korrigjime të vijave buxhetore në mënyrë që një pjesë e buxhetit të paraparë për çështje të tjera për mallra dhe shërbime, për mëditje ose edhe një pjesë nga buxheti shtesë ose edhe me caktimin e taksave përmirësuar të barten në buxhetin e arsimit dhe të qartësohet në mënyrë të detajuar destinimi i tij. Dhe në fund, vetëm investimi në resurset njerëzore në një vend siç është Kosova mund të jetë garantues për zhvillimin e saj. Ju faleminderit për vëmendje.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Safete Hadrgjonaj, le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

**DEPUTETJA SAFETE HADRGJONAJ** - Faleminderit z. kryetar të nderuar deputetë. Askush nuk ndjehet mirë kur shikon këtë projektbuxhet që na është ofruar në shqyrtim nga se buxheti nuk është një tabelë shifresh por instrument i rëndësishëm me të cilin Qeveria përmbytë obligimet për rritjen ekonomike, për rritjen e punësimit, për përmirësimin e gjendjes në arsim, shëndetësi, infrastrukturë. Nuk ndihesh mirë sepse buxheti është arka jonë e përbashkët është shpresa për një jetë me të mire për qytetarët. U bënë 7 vite pas lufte dhe ende miratohet buxhet tërësisht konsumues, buxhet me trende varféruese, pa kurrfarë efekti në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Buxheti i vitit 2007 si ai i vitit 2006 rrit numrin e të papunëve, i shkakton dëme ekonomisë me miliona euro.

Projektbuxheti i vitit 2007 që kërkohet të miratohet në parim, është buxhet i territ informativ, nuk ka transparencë në planifikimin e shpenzimeve as në planifikimin e të ardhurave i është shëmangur debatit publik dhe kërkohet të kalojë me shpejtësi, krejtësishtë nëpër terr. Projekt buxheti për vitin 2007 na vije në Kuvend pa u bërë përgatitjet e duhura pa të dhëna të detajuara edhe pse përgatitj a e këtij buxheti ka filluar që në muaj in prill

2006. Projekt buxheti vije në shqyrtim kurse organizatat buxhetore nuk i ka dhënë formën përfundimtare proj ekteve te veta buxhetore.

Unë kamë kërkuar formularët me të dhëna për buxhetin e secilës organizatë buxhetore në MEF, kame marr përgjigjen se "organizatat buxhetore janë duke punuar ne nuk i kemi këto të dhëna, presim që se shpejti organizatët buxhetore qeveritare dhe komunat të na i dërgojnë sipas sugjerimeve që ne ua kemi dhënë". Atëherë shtrohet pyetja çfarë buxheti po diskutojmë ne sot? Fakti se buxheti na vije në shqyrtim ende pa i harmonizuar të dhënat e organizatave buxhetore me MEF, të jep të kuptosh se MEF përdor veton në përcaktimin e prioriteteve të njësive buxhetore, po ashtu është një dëshmi e mire se kjo qeveri është e dështuar kjo qeveri nuk di të projektoi buxhetin, kjo qeveri di të shfrytëzoj mjetet e taksapaguesve për luks dhe korruption qeveritar.

Neve na mungon një analizë e detajuar e realizimit të pritshëm të buxhetit për vitin 2006, sepse Ministri i MEF nuk e ka pa të arsyeshme të jetë transparentë ndaj Kuvendit, siç e obligon ligji. Në kuvend nuk kemi shqyrtau asnjë raport për rrjedhën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2006. Nuk e dimë cilave mjete u është ndërruar destinacioni me rivlerësimin e buxhetit, edhe pse disa here kam kërkuar nga Ministri në Komisionin për buxhet e financa që të paktën ne si komision funksional të analizojmë orientimin e mjeteve në destinacionet e caktuara në gjashtë mujorin e dytë. Ministri i MEF nuk i përgjegjet ftesës së Komisionit për buxhet e financa, për t'i diskutuar priorititetet buxhetore për vitin 2007 që i është bërë në fillim të tetorit të këtij viti. Nuk di si të kuptohet nënverësimi që Ministri i MEF i bënë Kuvendit.

Prandaj është krejtësisht e natyrshme që Projekt buxheti i paraqitur ka konfuzitet dhe shumë mangësi.

Së pari ai vjen në një moment kur buxheti i vitit 2006 në kategorinë mallra dhe shërbime është shpenzuar për luks marramendës të qeveritarëve. Në 9 mujorin e këtij viti janë shpenzuar 35 milion e 15 mijë euro për telefona, udhëtime, derivate, mirëmbajtje e të makinave, qira të objekteve, kurse 21 milion janë shpenzimet tjera për të cilat askush nuk di se për çka janë shpenzuar, vetëm për këto pozicione janë shpenzuar afërsisht aq mjete sa janë shpenzuar për investime kapitale.

Së dyti ai vjenë në një moment kur buxheti i vitit 2006 shënon një përvojë negative për sa i takon realizimit të investimeve publike. Kështu realizimi për periudhën janar-shtator 2006 është vetëm 15.4% në raport me shpenzimet e përgjithshme, nga 176 milion të planifikuara për shpenzime kapitale janë shpenzuar vetëm 61 milion euro. Është shumë e vështirë të pranosh që kjo qeveri, mbi këtë eksperiencë negative që ka krijuar të jetë në gjendje të realizojë nivelin e investimeve që parashikon për vitin 2007.

Së treti projekt buxheti nuk shoqërohet me parametrat makroekonomik në bazë të se cilave është konstruktuar struktura e të hyrave buxhetore. Ministri deklaron se është miratuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve në Kuvend. KASH kurrë nuk është diskutuar në Kuvend dhe as nuk është miratuar. KASH kemi mundur ta shikojmë vetëm përmes faqes së internetit të MEF.

Së katërti në buxhet nuk zënë vend asnjë prej prioriteteve të shpallura nga Kryeministri „ekonomi, energji, edukim”. Nuk investohet në arsim sepse kjo qeveri nuk e kupton se

çfarë do të thotë të investosh në kapitalin njerëzorë, çfarë do të thotë të krijosh kushte për një sistem cilësor shkollar. Nuk investojnë në arsim sepse nuk e kuption se të investosh në arsim do të thotë të investosh në zhvillimin ekonomik të vendit sidomos tek ne ku 50% e popullësisë është nën moshen 23 vjeçare.

Së pesti buxheti nuk parasheh ndonjë reformë të mirëfilltë por bënë vetëm arnime me levizj e të vogël të mjeteve, që është mjaftë shqetësuese kur pretendojmë që në vitin 2007 Kosova do të jetë e pavarur.

GP i PDK nuk pajtohet me projekt buxhetin për vitin 2007 sepse ky buxhet është vazhdimi e politikave dhe praktikave të dështuara të viteve të mëparshme. U bend 3 vite radhazi që PDK nuk pajtohet me dokumentin kryesore ekonomiko financiar nga se nuk ka mundur të pajtohet me paaftësinë e qeverisë dhe demagogjinë e përditshme, që i kanë kushtuar Kosovës me miliona euro, me buxhetin që diskriminon pushtetin vendor, që nuk i merr parasysh projektet e komunave që historikisht kanë qenë të diskriminuara, që nuk i jep prioritet në ndarjenë e granteve për projekte komunave me të pazhvilluara.

Nuk është pajtuar dhe nuk do të pajtohet kurrë që buxheti të orientohet në projekte të natyrës mafioze, asnjëherë PDK nuk do të miratoj buxhet që krijon klimë abuzive ndaj bizneseve, që shpenzon miliona euro në vlerësim e rivlerësim të tenderëve të telefonisë mobile dhe ruan monopolin në telefoni, që lejon mjetë për të blerë energji elektriqe me çmime enorme, që bënë shkarkime dhe emërime politike në administratë, që nuk realizon projektit investive ngase në zbatimin e buxhetit mbizotëron korruzioni i tenderimeve.

Qeveria në programin e saj ka premtuar se do orientohet drejt taksave vendore por vazhdon të mbështet në të hyrat në kufi. Gjatë këtyre dy viteve të qeverisjes abuzimi në ATK është rritur administrata fiskale përditë e me shumë mbushet me militant partiak të pa përgatitur profesionalisht apo të mbingarkuar negativisht, ekspert të kualifikuar janë larguar nga administrata fiskale, prandaj edhe nuk ka rezultate. Është shqetësues fakti se edhe këtë vit parashihet që 64.11% e të hyrave të sigurohen në kufi, 20% nga tatimet e brendshme, 4.30% nga të hyrat vetanake, tashmë kur Kosova është në proceset integruese dhe është në negociata për nënshkrimin e MTL, ku përfshihen edhe vendet e Evropës Juglindore, ku faktikisht doganat do të janë vetëm evidentuese po jo ekzekutuese.

Nga këto pak të dhëna me të cilat disponojmë vërehet se nuk parashikohet asnjë masë kundër evazionit në funksion të rritjes se të ardhurave dhe mire zbatimin e buxhetit, nuk ka kurrfarë ndërrimi të politikave fiskale në favor të biznesit. Prandaj edhe nuk ka rritje të të ardhurave buxhetore dhe ruhet trendi i buxhetit të varfér.

Në nenin 9.6 parashihet që bashkë me këtë projektbuxhet të aprovohet lista e shpenzimeve kapitale, pasqyra 4 që ne nuk e kemi, kjo pasqyrë i mungon këtij projekt buxheti. Votohen 199,658,000 euro për kategorinë shpenzime kapitale dhe nuk dihet se për çfarë projekte votohet. Votohen projektet që njëherë janë votuar në vitin 2006 dhe janë bartur në këtë vit sipas dëshirës apo simpatisë politike të MEF apo votohen projekte të reja.

Vota për këtë buxhet do të thotë të thotë vote për luksin e shfrenuar të qeveritarëve, sy mbyllur votohen 132 milion euro për kategorinë mallra e shërbime, kjo është kategoria me e përshtatshme për të lulëzuar korruzioni qeveritar, nuk ka vend në botë që i ofron

Kuvendit për miratim një buxhet kësisoj pa i ofruar të dhënat se për çka Janë të destinuara mjetet e taksapaguesve.

Vota pro këtij buxheti është votë për votë për vazhdimin e trendit të rënies së rritjes ekonomike, e shoqëruar me pérkeqësim të treguesve të përgjithshëm makroekonomikë dhe veçanërisht me rritje të papunësisë dhe varfërisë relative.

Vota pro këtij buxheti është vote për thellimin e krizës së funksionimit të pushtetit për shkak të anarkisë dhe korruptionit, vote për thellimin e krizës në shkolla e universitete, mësimdhënësit duhet të kënaqen me pagat që i kanë sepse qeveria as me këtë buxhet nuk ka arritur të ngrisë nivelin e jetesës së mësimdhënësve dhe as cilësinë e procesit mësimor.

Vota pro këtij buxheti është votë për krizë në shëndetësi sepse fondet e akorduara për sektorin e shëndetësisë, ndonëse janë rritur në krahësim me një vit me parë, janë të pamjaftueshme. Buxheti është larg shpresës për reforma në sistemin shëndetësor, aq shumë të përfolura nga koalicioni qeverisës.

Vota pro këtij buxheti është votë për ta thelluar krizën në bujqësi sepse nuk ka politika për subvencionimin e saj, është votë për krizën në administratën publike e cila çdo ditë po dëmtohet politikisht duke larguar specialistë dhe udhëheqës të aftë, për t'i vendosur aty militantët politikë, është votë për goditje biznesin me politikat fiskale, është votë për thellimin e krizës energetike. Ky projektbuxhet është pasqyrë e efikasitetit të dobët të qeverisjes së koalicionit qeverisës. Kjo qeveri në thelb e ka paaftësinë për të përpiluar politika financiare, për të përpiluar politika ekonomike e sociale, këtë Qeveri e ka përfshire kriza e përgjithshme, krizë nga e cila vështirë se do dijë të dal.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputeti Gani Koci.

**DEPUTETI RAMADAN KELMENDI** – Faleminderit, i nderuari kryetar, të nderuar ministra të çmuar kolegë deputetë. Më lejoni që duke vlerësuar pozitivisht punën e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për përgatitjen e sotshme të shfrytëzimit të Propozimligjit për buxhetin e Kosovës të shpreh mendimet e mia pak sa më ndryshe, duke u bazuar çdo herë në mundësitetë dhe në urtësinë popullore “Shtri këmbët aq sa është jorgani.”

Vlerësoj se në shqyrtimin e Propozimligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe shpërndarjen e autorizimeve të shpenzimeve për vitin 2007 po përbushet një obligim ligjor nga vetë Ministra e Ekonomisë dhe e Financave dhe nga Kuvendi i Kosovës, si dhe po dëshmohet mundësia e ekzistencës dhe e qëndrueshmërisë ekonomike vetanake të Kosovës si shtet në kuptimin edhe të bazueshmërisë ekonomike.

Deputetë të nderuar,

Duke përkrahur miratimin e buxhetit për vitin 2007, më lejoni t'i paraqes disa vërejtje dhe sugjerime, të cilat duhet të zënë vend në procedurën e mëtutjeshme. Mendoj se tanimë pas 7 vitesh të zhvillimit të proceseve politike dhe ekonomike, si dhe të atyre juridike, kompetencat dhe mundësitetë për ndryshimin e këtij buxheti nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KS OKB-ës në një urdhëresë administrative është më se e arsyeshme të barten te vendorët dhe ky proces vazhdon. Ndarja dhe shpërndarja e mjeteve,

si dhe përshtatja e tyre për komuna duhet bazuar në specifikat e komunave dhe në priorititet politike në to, duke krijuar një fond së paku modest në pozicionet buxhetore për lagjet veriore të Mitrovicës, në të cilat do të ruhej substanca e qytetarëve shqiptarë, boshnjakë, turq, ashkali, rom etj. pasuria e të cilëve ofertohet nga qeveria e Serbisë për t'u blerë me çmime shumë të larta, andaj edhe ne si Qeveri në mundësitet tona ekonomike duhet të planifikojmë një buxhet të tillë për një fond të tillë për t'u garantuar këtyre qytetarëve qëndrim të mëtutjeshëm atje. Dihen pasojat dhe sugjerimet ngase kjo ka marrë përmasa të mëdha.

Mendoj se duhet bërë ndikim më të madh ligjor e financiar në komuna, si njësi buxhetore, të cilat nuk po arrijnë dhe nuk po angazhohen profesionalisht për të përbushur obligimet tativore nga burimet vetanake dhe ky duhet të jetë kriter i sasisë buxhetore ,si element stimulues në efikasitetin e grumbullimit dhe të balancimit të të hyrave në to.

Përcaktimi në buxhetin e Kosovës që secila komunë të bëjë alokimet për bashkësitë joshumicë si subvencionet. Kjo deri më sot në komunat veriore në veçanti në komunën e Zveçanit ,për shqiptarët nuk është realizuar tani pas shtatë viteve edhe pse nuk dihet se ku janë dedikuar dhe si janë shfrytëzuar ato mjete tona buxhetore . Në këtë drejtim dhe si deputetë nuk kemi një pasqyrë informative së paku sa janë të hyrat vetanake të komunave serbe veriore në veçanti në realizimin e obligimeve qytetare ndaj shtetit nga ana e serbëve, kur dihet se nga po këto dhe po nga ky buxhet ndahen mjete të konsideruara për Universitetin e Mitrovicës, për Qendrën Rajonale Spitalore në Mitrovicë, për tepricën shumë të madhe të punëtorëve në arsim, me nga dy drejtorë me klasë të boshatisura etj.

Vlerësoj se në këto kushte të rënda ekonomike me numër të lartë të papunëve, është e domosdoshme që në Propozimligj të propozohet ulja e dukshme e mallrave dhe e shërbimeve për të gjithë shfrytëzuesit ,në veçanti për nivelet udhëheqëse komunale, të cilët nuk arrin t'i përbushin këto obligime ndaj shtetit. Ndonëse dihet se kompetencat ende janë të kufizuara ,në disa sfera mjetet e trustit pensional , mjetet e privatizimit tani e tutje duhet të gjenden në qarkullimin e mjeteve financiare në Kosovë dhe të përcaktohen me dedikimet e shfrytëzimit sipas buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Në veçanti duhet të kemi specifikacion financier mbi ndarjen e mjeteve të buxhetit të Kosovës për KEK-un, Trepçën, AKM-ën, skemat sociale në vlera dhe për mënyrat e shfrytëzimit për të gjithë këto mjete duhet transparencë më e madhe.

Vlerësoj se është mirë të miratohen me buxhetin e konsoliduar të Kosovës, derisa të ekzistojnë këto rrethana të padefinuar për Mitrovicën Veriore ,të ketë investime të privilegjuara nga Qeveria edhe të premtuara si inkurajim për qëndrim të atjeshëm si përcaktim dhe si fond stimuluese me një fond sado të vogël, por me interes shumë të madh dhe të përgjithshëm, për të cilin këtu nuk dëgjojmë asnjë fjalë dhe në të gjitha fushatat e kemi përdorë dhe besoj se do ta përdorim si mekanizëm për të fituar vota.

Kërkoj nga Kuvendi që ta aprovojë kërkesën, nëse e arsyeton që mjetet për shpenzimet për projektet e komuniteteve në komunat Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok të bartën edhe në këtë vit. Por të harxhohen për ndikimet të cilat s'duhet të janë mjete të bllokuara ose të shfrytëzuara për rajone të tjera serbe. Fondi i rrugëve ,patjetër, duhet të jetë fond i paraparë me ligj për shfrytëzimin që e paguajnë dhe jo për forma të tjera. Duke konfirmuar edhe një herë miratimin e buxhetit unë ju falënderoj për vëmendje dhe kërkoj që vërtet kjo qeveri të

ketë një vëmendje më të madhe në aspektin edhe buxhetor për Veriun e Mitrovicës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOçi – Faleminderit z. kryetar. I nderuari ministër i Ekonomisë dhe i Financave.

Ne sot para vetes e kemi Projektbuxhetin për vitin 2007. Konsideroj se diskutimit të këtij Projektbuxheti do të duhej t'i paraprinte diskutimi për shpenzimet buxhetore të nëntëmujorit të vitit të kaluar dhe pastaj mbi bazë të atij diskutimi dh të analizave të shpenzimeve buxhetore për vitin e kaluar të na ofrohet edhe projektbuxheti i këtij viti. Shikuar realisht edhe në strukturën e të hyrave dhe në strukturën e shpenzimeve Projektbuxheti i vitit 2007 nuk dallon absolutisht nga Projektbuxheti i vitit 2006 dhe i viteve të tjera paraprake.

U tha këtu edhe nga ju z. ministër se keni paraparë një rritje të të hyrave buxhetore për vitin 2007. Kështu është thënë në çdo kohë kur kemi diskutuar projektbuxhetin, por shuma e tërësishme e buxhetit kur nuk ka kaluar më shumë se 650 milion euro ose 670 milion euro. Po të ishte ajo rritje do të **kalonte mbi 700- mijë**. Unë e kam para vetes sot edhe Projektbuxhetin e vitit të kaluar edhe këtë projektbuxhet dallimet janë shumë të vogla. Prandaj nuk di prej nga ajo rritje që ju e konsideroni. Po kështu edhe në strukturën e shpenzimeve që ju keni paraparë janë e njëjtë gjendje dhe përqindje. Dua të them vetëm një gjë se me këto tabela jemi mësuar tash e gjashtë vjet të projektbuxheteve dhe keni marrë një shablon, pr. nuk keni ndryshuar absolutisht. Ju përgëzoj vetëm për aftësinë e ndryshimit të tri shifrave të fundit të numrave që ne i keni dhënë këtu dhe asnje ndryshim tjetër.

Pastaj në këtë projektbuxhet ju thoni se jeni duke përgatitur planin zhvillimor ekonomik të Kosovës, ndërsa gjatë diskutimit tuaj thatë se këtë projektbuxhet e keni bazuar mbi kornizën e investimeve afatmesme. Unë nuk jam economist, por dua t'jua bëj një pyetje ty edhe atyre që merren me këtë çështje. A duhet t'i paraprijë kornizës së investimeve afatmesme plani zhvillimor apo planit zhvillimor korniza afatmesme e investimeve? Më duket këtu jemi ngatërruar në këto koncepte dhe ose e kemi thënë vetë vetëm sa për ta thënë.

Një çështje tjetër që e thanë edhe parafolësit, këtij projektbuxheti i mungon lista e investimeve kapitale. Unë para vetes kam listën e investimeve kapitale për vitin 2006 për secilën ministri veç e veç dhe a mos kjo është bërë me qëllim që nesër të na ofrohet e njëjtë listë me të njëjtë numra dhe pastaj të vijmë tek ajo që kemi ardhur sot, kur në raportin 9-mujor menaxhimi i buxhetit dhe i shpenzimeve buxhetore kanë qenë vetëm 54%, që është në kundërshtim me planifikimet që ju i keni bërë dhe me të gjitha rrëgullat dhe principet e ekonomisë dhe të shfrytëzimit të buxhetit, por edhe në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Duhet të përmend vetëm një fakt: Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit ka realizuar për 9 muaj buxhetin vetëm 37%. Ne e dimë që këtë tremujorin e fundit do të jenë muajt kur më së shumti do të shpenzohen dhe do të vijmë në atë situatë të themi pastaj ku

na kanë mbetur dhe si u shpenzuan 170 milion dhe nga na shkuan? Dhe mbi bazë të gjitha këto që janë realizuar në vitin 2006 është dashur edhe të projektohet edhe buxheti i vitit 2007.

Tjetra çështje, ju sa keni qenë edhe kryetar i Komisionit për Buxhet e kemi ngritur këtë çështje që është shumë e rëndësishme. Ndryshimin e kritereve për ndarje dhe për projekttime buxhetore. Sidomos e kam fjalën për ndarjen buxhetore të komunave. Ne tash e 7 vjet kemi marrë vetëm një kriter për bazë, kriterin demografik ose kriterin e popullsisë dhe këtë kriter e mbështesim mbi një bazë të statistikave, që është shumë e lartë e vitit 1981 ose shpesh për të t' t'I ikë kësaj po thoni mbi bazë të dhënavë që janë marrë, baza e të dhënavë për zgjedhësit që ka qenë e krijuar në kohën ..... që nuk është e saktë dhe **mbi këtë bazë pastaj bëhen** edhe ndarjet buxhetore nëpër komuna.

Nuk keni marrë dhe nuk keni përfshirë asnjë kriter ekonomik, as social, as arsimor, as shëndetësor, në mënyrë që vërtet këto ndarje të jenë ndarje përafërsisht të sakta dhe përafërsisht të qëlluara.

U përmend këtu nga disa kolegë që të krijojen fonde ose ka ardhur koha të ndryshohet Ligji mbi menaxhimin e financave publike. Unë pajtohem plotësish me ndryshimet e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike. Por edhe si i tillë nuk ndalon që buxheti të orientohet atje ku duhet të orientohet. Merrne vetëm linjën e mallrave dhe të shërbimeve. Kosova harxon në përqindje mjete më së shumti nga vendet regionit në mallra dhe shërbime. Nuk konsideroj se Kosova është në një pozitë shumë më të lakuueshme sesa Shqipëria që ndoshta në vitin 2004 vetëm 9% e buxhetit e ka shfrytëzuar për mallra dhe shërbime, ndërsa ne në Kosovë deri në 26% e tash kemi mbërritë deri 20, 22-23% të tërësisë së buxhetit në mallra dhe shërbime.

Në këtë çështje krijimi i fondevë është shumë i rëndësishëm dhe atyre fondevë që e tha dikush për rrugë dhe disa fonde të tjera, unë do t'i shtoja edhe krijimin e fondit për komunat jo të zhvilluara. Është keq të përmend një periudhë para 30 –vjetëve, por edhe në atë kohë ka pas do farë fondesh për krahinat edhe republikat e pazhvilluara ose në kuadër të Krahinës për komunat e pa zhvilluara. Pra, në këtë drejtim duhet të mendojë kjo qeveri dhe sidomos ministri i Ekonomisë dhe i Financave.

Një çështje tjetër që dua të shtroj këtu. Ne kemi krijuar disa agjensione të pavarura që quhen të pavarura, por me shkurttime buxhetore që u bënë, pikërisht këtyre agjensioneve i bëjmë më të varura ose në shërbim të Qeverisë, të Kuvendit ose të mekanizmave të tjera, që nuk e luajnë dhe nuk e kryejnë misionin e vet. Duhet përmendur vetëm agjensionin e pavarur të Rregulatorit të Energjisë Elektrike që ka një ligj dhe me ndarje buxhetore të këtij viti për këtë rregulator Qeveria do edhe në normë të ndërhyjë në kundërshtim me vetë Ligjin për Rregulatorin e Energjisë Elektrike.

Çështja tjetër është edhe tek Agjensioni i Telekomunikacionit, përkatësht të Rregulatorit i Telekomunikacionit, po një çështje të veçantë dua ta theksoj që tani e ka krijuar Kuvendi dhe ka mbështetje “shumë të madhe” nga Qeveria te Agjensioni Antikorrupsion.

Në Projektbuxhetin e këtij agjensioni kanë ndërhyrë Qeveria pa e lexuar fare Ligjin antikorrupsion. Të gjithë ata që janë të punësuar ose të angazhuar në këtë agjension nuk

janë shërbyes civilë, por janë persona të autorizuar dhe kanë statusin sikur Shërbimi Policor ose njerëzit që punojnë në shërbimet e tillë. Me buxhetin që e ka ky agjension, jo që do ta parandalojë korruptionin, por mund të ndodhë edhe më e keqja që të zhytet edhe vetë në korruption, kjo nuk i shërben askujt, absolutisht askujt.

Dikush e përmendi këtu buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë. Bujqësia në Kosovë është një sector, që vërtetë do të duhej të premtonte më shumë, por me buxhetin që i është ndarë, të mos presim shumë. Ne kemi pas dhe jemi ballafaquar me protestat tash kohëve të fundit të sektorit të shëndetësisë. Në këtë planifikim të investimeve kapitale ka një numër shumë të madh të projekteve në këtë sektor do të dëshiroja shumë të vinë nga ministri, vërtet këto projekte në sektorin e shëndetësisë a do të bartën në buxhetin e vitit 2007 dhe kush do të mbajë përgjegjësinë për mosrealizimin sipas planifikimit të buxhetit të vitit 2006.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Pushim për drekë deri në orën 15.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju lutemi, t'i zëmë vendet. Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, le të përgatitet Teuta Hadri  
Aktualisht në sallë janë 54 deputetë

**DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI** - Zotri kryetar i Kuvendit! zonja dhe zotrinjë! Pasojat e bllokimit dhe të izolimit të Kosovës, si rrjedhim bllokimi ekonomik e finansiar që e ka përfshirë vendin, më së miri shihet në këtë projektbuxhet të ofruar. Derisa shpenzimet rriten, të hyrat kanë stagnuar, gjithashtu, nuk kanë ndërvart struktura e të hyrave. Vazhdojnë të dominojnë të hyrat nga doganat. Sipas Projektit unë, këtu do të ndalem vetëm në disa pika konkrete. Sipas Projektbuxhetit të ofruar në tabelën e UNMIK-ut përkatesisht fuqive të rezervuara u jepen në dorëzim 209 milion €, afërsisht një e katërtë e gjithë buxhetit. E para, Kuvendi ka kërkuar kalim të kompetencave te Kosova dhe do të ishte kundërthënëse të ndahet buxhet që të financohet diçka që na është usurpuar. E dyta, këto nuk janë ofruar fare s' disa tabela, siç u thase ku do t'i shpenzojë UNMIK-u këto mjete edhe asnjëherë për to nuk ka dhënë llogari. UNMIK-u ka pasur, por edhe tash ka ende kohë t'i kalojë kompetenca brenda vitit 2006 te Qeveria e Kosovës.

Të ndeuara zonja dhe zotërijn nuk ka asnjë kuptim të financojmë diçka jashtë vullnetit tonë. Tash te tabela nr. 2 është kënaqësi që në buxhet janë përfshirë pensionet e invalidëve të luftës, por për çudi në buxhet nuk kam parë të jetë përfshirë me ndarje zë të veçantë pjesa për familjet e dëshmorëve të luftës së UÇK-së. Ka një ligj të cilin e ka aprovuar Kuvendi i Kosovës për këtë kategori dhe kërkoj të parashihet me zë të veçantë. Ndërsa po në tabelën dy është ndarë me zë të veçantë bisedimet për statusin, që nuk jam vetëm unë që e kam vërejtur këtë. Nuk e di Ministria e Financave dhe Qeveria a po i dëgjon anëtarët e Ekipit Negociator. Ata po përbehen se nuk ka më bisedime. Pse atëherë Kuvendi duhet të ndajë një milion euro për bisedime? Buxheti i paraparë për pikat që i përmenda më lart duhet të orientohet me intervenime urgjente, ku i ka vendi ynë ato nevoja dihen, d.m.th. në: shëndetësi, arsim dhe në sferën sociale. Ndërsa, siç e thanë të gjithë deri më tash, pothuaj gjithë Projektbuxheti i vitit 2007 ka te meta serioze. Përmendimin e subjektit që e përfaqësoj LPK-së ky buxhet duhet të kthehet në ripunim, pastaj të sillet për shqyrtim të parë brenda javësh. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, le të përgatitet deputeti Nexhat Rexha

DEPUTETJA TEUTA HADRI – I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën janar deri më 31 dhjetor 2007, para deputetëve tanë në këtë seancë mendoj se po të punohej më me sinqueritet deputetët nuk do ta pranojnë, por do ta shtyjnë që ky projektligji të shqyrtohet më vonë në një seancë më të vonshme, të jetë më i kompletuar, më transparent dhe më përgjegjës. Vetëm po të shikosh nga përbajtja teknike dhe forma teknike e shtuar e këtij projektligji, shihet se ky projektligji është shkruar me shkronja aq të vogla saqë as ne nuk mund ta lexojmë pa përdorur lupën zmadhuese. Është një lëshim jo vetëm teknik që mund të themi, por jo edhe i paqëllimshëm dhe them se qëllimi i të shkruarit të imët është për të mos u lexuar ky projektligji, pra që të pengohet analiza e tij dhe të humbet koncentrimi në lexim dhe të miratohet ashtu me një ngritje dore a vote, siç bëhet zakonisht nga deputetët, ku si keqpërdorim është shfrytëzimi i votës nga mazhuranca. Ta shqyrtosh Raportin e buxhetit të Kosovës për një ditë, në një séance, ose për dy ditë, është qesharake, mashtuese bile edhe spekulim i qeveritarëve dhe hartuesve të tij. Shtetet që hartojnë buxhetet e vendeve të tyre vërehet se aty ku ka demokraci e transparencë për shqyrtimin e këtij projektligji, ato harxhojnë ditë të tëra, javë pune për miratimin e buxhetit. Si një ndër projektligjet më të bazuar për rrjedhën e punës dhe miratimit të projektligjeve tjera që rrjedhin nga ky ligj, siç tha edhe Afrimi pak më pare, ishte e pamundur që deputeti t'i shprehë mendimet e veta për një ligj aq të rëndësishëm siç është ai për buxhetin e Kosovës. Andaj mosmiratimi transparent i Ligjit të buxhetit dhe puna shkel e shko dëmton edhe ecurinë e projektligjeve të tjera në miratim, me çka ne sot po ballafaqohemi në mosbatimin e tyre me vite dhe ngecje në sirtarë të "dikujt" të Qeverisë apo të UNMIK-ut, ashtu siç kanë mbetur edhe sot e kësaj dite Ligji për sigurimet shëndetësore që është baza e të gjitha ligjeve të tjera në shëndetësi.

Ligi për duhanin, i cili u miratua para shumë muajsh sot në mënyrë joligjore nuk zbatohet apo mbetet në sirtarin e kyçur me çelës e po keqpërdoret nga ata që po e keqpërdorin, e bëjnë përfitime të veta materiale. Pastaj Projektligji për mjekësinë ligjore i cili u miratua në Parlament para një viti nga deputetët që pastaj u ngri sikur të jetë ushqim për ngrirje apo të shkrihet pastaj kur do dikush. Ky ligj nuk iu ka lejuar as Departamentit të Drejtësisë as Ministrisë së Shëndetësisë për t'u zbatuar, por kanë mbetur në kompetencën e ngrirë të dikujt dhe pse? Dhe kujt i intereson kjo shqiptarëve apo UNMIK-ut? Janë bërë 7 vite, shtatë festa të flamurit festojnë të gjithë qytetarët e Kosovës dhe familjet e të zhdukurve janë ende në ankth të rëndë, ende për t'i gjetur varret e familjarëve për t'i siguruar, për t'i çuar nga një kurorë lule për ditën e flamurit në varret e tyre. Kanë mbetur në mëshirën e tokës dhe të qiellit, e që fati i zbardhjes së të vrarëve, familjarëve të tyre të shpejtohet si nga Qeveria apo zbatimi i shpejt i këtij projektligji, siç është Ligji i mjekësisë ligjore. Nuk di sa vlerë ka të diskutohet për buxhetin kur veç sa e kemi të freskët diskutimet e deputetëve dhe të grupeve parlamentare në seanca të kaluara për zhdukjen e parave të qytetarëve tanë të buxhetit të Kosovës nga individët qeveritarë, nga ata që e bëjnë këtë ligj sot, e nesër do të bëjnë fushatë për të ndërtuar ligje të tjera në vazhdim. Ministria për Ekonomi dhe Financa asnjëherë në raportin e vet nuk ka qenë transparente ndaj të hyrave, të dalurave buxhetore, si dhe ndaj proceseve buxhetore. Asnjëherë në formë transparente nuk u informua për suficitet e ato janë

zhdukur e lanë ashtu si është dashur pa i njoftuar deputetët. Të gjitha këto janë bërë dhe po bëhen ende edhe tani nga qeveritarët edhe pse partitë politike dhe grupet parlamentare opozitare e kanë ngritur mjaft zërin në këtë Parlament, madje e kanë lëshuar edhe sallën e Parlamentit në shenjë proteste kundër keqpërdorimeve të buxhetit e ato ende po vazhdojnë. Cili është ai që ka një kontroll kur dihet sa herë Grup Parlamentar i PDK-së e ka kërkuar për ta formuar një komision për kontroll të keqpërdorimeve të parave të qytetarëve dhe kundër korruptionit. Shiko e bëni krahasimin e raporteve tremujore që i keni marrë nga kjo punë, është punë e Komisionit dhe e ekspertëve të ekonomisë edhe aty ku nuk ka pasur transparencë edhe aty u bë ndryshimi i vlerave numerike sipas tremujorëve në tremujor. Nuk janë shënuar qartë shpenzimet për arnimin e asfalteve që janë bërë copa copa. Sa janë keqpërdorur ato? Nuk janë shënuar të dhëna për ndërtimin e trotuareve në kryeqendrën tone, ku brenda një viti dy tri herë janë bërë ndërtimë të tyre. Asnjëherë prioritetet e vogla e as ato të mëdhatë nuk janë paraqitur qartë dhe bindshëm, nuk dihet ende sa prej tyre janë realizuar e sa nuk janë realizuar nga Qeveria dhe nga buxheti i saj. Asnjëherë Raporti i buxhetit të konsoliduar të Kosovës nuk u paraqit drejt dhe qartë me faturat e shpenzuara për drekat e darkat nga Zyra e Kryeministrat e deri te ministritë. Këto shpenzime deputetët i njojin vetëm përmes mjeteve të informimit dhe jo të Raportit të buxhetit.

Do të përmend sipas mjeteve të informimit, vetëm nga Ministria e Kthimit për dreka dhe darka janë shpenzuar për mbi shtatëdhjetë e tremijë euro.....

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju lutem, po flasim për buxhetin e vitit të ardhshëm. Nuk e kemi raportin e vitit të përparshëm**

- **VAZHDMI DEPUTETJA TEUTA HADRI –** Po mirë kjo është ajo forma e keqpërdorimit që edhe në të ardhmen, ku shihen se nuk ka raporte të sakta në këtë projektligj. Çfarë luksi primitiv është bërë? Nuk janë paraqitur as shpenzimet e qirave të lokaleve dhe hapësirave të punës. Po themi për vitin e ardhshëm të 2007, kur do t'i lënë këto ministri lokalet e veta që i kanë marrë me qira. Kanë ndarë qeveritarët tanë, sot po ndërtojnë katër katërshe dhe pesëkatëshe. Një shpërndarje jo e drejtë e buxhetit të Kosovës po vazhdon qe disa vite e nuk po shpërndahet në formë të drejtë sipas prioriteteve, por po dominon politika ndaj komunave. Komunat që kanë shërbyer gjatë luftës dhe kanë qenë më të shkatërruara nga lufta, sot në këtë projektligj janë ndër komunat më të varfra dhe kanë shumë pak ndihmë materiale. Shikojeni: Drenicën, Gjakovën, Vushtrrinë, Mitrovicën dhe Pejën. Edhe shpërndarja e buxhetit këtyre komunave u bë me hile. Unë do të ndalem në tabelën 2 të këtij projektligji ku nuk paraqitet asnjë kryetar i shpërndarjes së parave, as numri i banorëve si territor, as numri i stafit punues e as nevoja dhe prioritetet që kanë. E ato komuna të shkatërruara më parë as nuk janë kthyer në gjendjen e mëparshme ekonomike të vitit 1988, siç kanë qenë. Shiko tabelën, po të krahasosh nuk është e drejtë që Drenica, Skenderaj, Malisheva nga numri i të punësuarve sipas tabelës 2, stafi punues është 1273, po të krahasohet me komunën e Besianës, ku stafi punues është 1875, ka shpërndarje jo të drejtë të parave, ku nga kjo shumë totale për Drenicën janë ndarë 4.480.219 € a për Besianën 7.564.045 €. Po ta krahasosh me komunën e Gjakovës, ku numri i stafit punues është 2188, ndërsa shuma totale është 8.466.316 më pak se komuna e Besianës. Kjo nuk është shpërndarje e drejtë. Zotrinjë deputetë, të gjithë ne ishim të shqetësuar dhe ende jemi të shqetësuar për shëndetësinë e Kosovës dhe nuk di si do të kemi fytyrë të dalim para elektoratit në zgjedhjet e ardhshme e çka do të flasim për prioritet në shëndetësi, që janë ndërtuar nga

ky buxhet në këto tabela. Çka kemi bërë dhe çka do të bëjmë për të ardhmen? Ato u ndalen jo nga .. grevat që u bënë nga personeli shëndetësor, por u ndalën nga qeveritarët jo me presion, por nga nderi dhe morali i punëtorëve shëndetësorë. Sot shihet se sipas këtij raporti buxheti për shëndetësinë vitin e kaluar ka qenë 49 milion €, ndërsa tanë janë ndarë 51 milion € për vitin 2007, pra do të thotë 3 milion € më shumë. Unë dua ta di dhe kërkoj nga Qeveria që t'i bëjë transparente për vendimin që e kanë marrë qeveritarët se deri në fund të këtij viti për shëndetësinë, si ndihmë do të jepen 800 mijë €, ndërsa për barëra 1.830.000. A janë ndarë këto mjete apo veç janë diskutuar? Pse nuk janë shënuar askund në këto tabela të këtij projektligj?

Në fund do të përmend edhe në seancën e prillit të vitit 2006, është njoftuar se Qeveria i ka shpenzuar 200.000 € për blerjen e një aparatit inserenator....

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA-** Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Nexhat Rexha, le te përgatitet deputetja Teuta Sahatqija

**DEPUTETI NEXHAT REXHA –** I nderuari zi. kryetar, ministra dhe të nderuar kolegë deputetë.

Në Projektligin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2007, në lexim të parë nuk duken problemet dhe vështirësitë të cilat mund të dalin në praktikë. Besoj se ministritë tona me përvojën që e kanë krijuar në këto vitet e kaluar, kanë arritur t'i rrumbullakojnë nevojat e domosdoshme për kryerjen e obligimeve që dalin para tyre. Nëse shikohen harxhimet nëpër burimet e tjera shihet se shpenzimet nuk kanë qenë të njëjtë në të kaluarën dhe në të ardhmen e çka është edhe arsyeshme. Paraqitura e tërësishme përsëri nuk të lë hapësirë për shpenzimet e drejta brenda kornizës buxhetore në institucionet e Kosovës. Mirëpo, diskutimi im ka një shqetësim tjetër. Planifikimi i buxhetit për vitin 2007 nëpër komuna ka mangësi të mëdha. Unë po ndalem në problemet e vështirësitë që janë paraqitur tanë në komunën e Kamenicës, nga vi unë si deputet. Edhe pse institucionet komunale me kohë i kanë marrë këto masa dhe kanë bërë vërejtje me shkrim, aty ku duhet, por nuk kanë hasur në përkrahje të arsyeshme. Parashikimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës për këtë komunë është i mangët për 496.000 €, kur dihet se në këtë komunë për këto shtatë vite e kemi të njëjtën strukturë të popullatës dhe nuk kemi rënje të numrit të popullatës dhe vështirësitë krijuhen me mangësi të mëdha, ndërsa hartuesit e buxhetit dhe ministritë tona mendojn se duhet të kenë parasysh specifikat e çdo komune. Në komunën e Kamenicës (Dardanës) ë 70% të popullatës së saj u takojnë viseve rurale, pra kodrinoro-malore. Këtu dalin problemet nga terreni, sepse mosnjohja e pozitës gjeografike e njerëzve nëpër zyre krijon vështirësi për zhvillimin e jetës së institacioneve në praktikë. Nëse mbetet ky buxhet, sipas planifikimit të përgjithshëm, në këtë komunë arsimi, shëndetësia dhe një pjesë e administratës komunale nuk do të mund të funksionojnë gjatë vitit 2007.

Si duket disa komuna të Kosovës si komuna e Kamenicës janë lënë anash në shumë sfera të jetës së tyre dhe kështu këto dëmtohen në çdo reformë si në decentralizim, në zhvillim të infrastrukturës e në çështjet e tjera.

Nëse nuk plotësohet buxheti komunal me këto mjete financiare të planifikuara nga kuvendi komunal i Kamenicës, siç mund të plotësohet sipas nenit 3, pika 1 e këtij projektligji, përgjegjësia do t'i mabetet edhe këtij institucioni për mbylljen e disa shkollave fillore në të gjitha fshatrat e malësisë së kësaj komune.

Unë besoj se pjesa më e madhe e juaj e njeh pozitën gjeografike të kësaj komune, pra të gjitha këto vendbanime kufizohen me Serbinë edhe ne sikur me qëllim dëshirojmë t'i zbrazim ato edhe në atë numër të paktë të popullsisë që kanë mbetur dhe kështu krijojmë probleme për të ardhmen e Kosovës.

Të nderuar kuvendarë,

Kërkoj nga ju për një strategji më nationale për të ardhmen edhe të skajeve të Kosovës, të cilat janë lënë pasdore në të kaluarën, prandaj, nëse në një sistem kanë ekzistuar programet për zbrazjen e disa pjesëve të vendbanimeve shqiptare së paku ne të mos e vazhdojmë atë strategji të gabuar. Konsideroj se në komunat me specifika të tilla, si dhe pozitën e tyre gjeografike jo të mirë, mund të gjenden mekanizma ligjorë ekzistues për t'i ndihmuar në disa faza zhvillimin dhe ekzistencën e tyre.

Shpresoj se në punën e mëtutjeshme, për aq sa kohë ka mbetur në finalizimin e këtij projektligji, do të bëhen ndryshime pozitive për komunën e Kamenicës dhe për ndonjë komunë tjeter me këto specifika. Ju faleminderit për mirëkuptim!

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA**- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija, në kartelën e Nazmi Jasharit dhe le të përgatitet deputetja Drita Statovci

**DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA** – Ju faleminderit z. kryetar!

Së pari shpreh keqardhjen që kryeministri sot nuk është me ne, kur diskutohet për buxhetin pasi është hera e parë gjatë qeverisjes së tij të diskutohet për buxhetin. Buxheti i vitit 2007 është buxhet i kontinuitetit, pasi edhe Qeveria është qeveri e kontinuitetit. Mbulimi i prioriteteve është mbulimi i këtij buxheti është në të vërtetë mbulimi i nëvojave të administratës. Nuk është buxhet analistik dhe mungojnë detalet. Kjo gjë krijon mundësinë për dyshim për mostransparencë dhe për keqpërdorime të mundshme. Në këtë buxhet mungon vizioni për politikat zhvillimore dhe definitivisht nuk është buxhet zhvillimore e investiv. Edhe në 2007, parashihet që përbushësi kryesor i buxhetit të vazhdon të jetë dogana, me tri të katërtat e vlerës së tatimeve. Vazhdon vizioni i kësaj qeverie është importi e jo eksporti. Po të ekzistonte vizioni i zhvillimit do të ishin paraparë politikat e strategjitë për mbrojtjen e prodhimeve vendore, për stimulim të prodhuesve dhe të bizneseve tona vendore dhe për subvencionimet në bujqësi.

Kur flasim për ndërmarrjet publike të cilat normalisht do të duhej ta mbushnin buxhetin e konsoliduar të Kosovës, ato sot e kësaj dite vazhdojnë ta ngarkojnë dhe t'i marrin paratë e gatshme nga ky buxhet. Si për shembull KEK- u, i cili e ka privilegjin t'i lejojë , siç kemi parë nëpër media, të cilat e kanë përshkruar bukur këtë leje të blerjes se tokave në Sibovc me paratë e buxhetit pa e pyetur fare Kuvendin. Gjithashtu tash së fundit u shndërruan ministritë në inkasantë të KEK-ut. KEK-u në vend se të përdorë mjetet ligjore për inkasim dhe në vend se Qeveria të bëjë ndryshimet rrënjësore në shëndrrimin e KEK-ut në kompani të suksesshme, me ndërtimin e politikave dhe mbikëqyrjen e implementimit të tyre, kjo bie në nivel të inkasantit të KEK-ut. Ndoshta kjo i tregon edhe maksimumin e aftësisë dhe kapaciteteve të kësaj qeverie, kontinuiteti i deficiteteve të planifikuar e më vonë i suficieve në tremujorin e fundit të secilit vit të rrjedhës, Është dukuri tashmë e zakonshme në Qeverinë e Kosovës, Në tremujorin e fundit parat e mbeturat t'i buxhetit shpenzohen me procedura të përshpejtura të nevojshme e të panevojshme zakonisht në shpenzimet luksoze që të mos mbetet për vitin e ardhshëm. Kjo tregon mungesën e vizionit të qeverisjes, Njerëzit e përgjegjshëm nuk sillën në këtë mënyrë as ndaj pasurisë së huaj e le më ndaj pasurisë së vet. Në nenin 6 të këtij projektligji irregullohen ndarja dhe

rindarja e mbetjeve të tepricave të fondevë të bartura. Shpresojmë që Qeveria duhet të raportojë pas kësaj here për këto ndarje të mbetjeve dhe të tepricave. Në vitin 2007, periudhë e cila e mbulohet me këtë buxhet, nuk është planifikuar si duket ndryshimi kualitativ statusor, i cili do të ndodhë gjatë këtij viti siç janë ministritë e ardhshme, sektorët e rinx, transferi i kompetencave, politika e jashtme. Pra nuk është shpjeguar se si është planifikuar kjo ndarje prej këtyre 3,5 milionëve, të cilat i shpjegoi ministri i Ekonomisë në ekspozenë e vet që tha se Kosova është vendi më i pazhvilluar i rajonit, me infrastrukturë më të pazhvilluar etj. Kisha përshtypjen se po u drejtohet donatorëve potencialë të huaj e jo deputetëve, por në qoftë se u paraqitet donatorëve do të duhej të dihej edhe si të tërhoqen parat prej atyre. Në qoftë u është drejtuar deputetëve, atëherë pason pyetja: Pse Kosova vazhdon të jetë e tillë kur tërë kohën Qeveria juaj e ka udhëhequr vendin, e ka planifikuar buxhetin i ka planifikuar prioritetet, prandaj, nëse dini si krijohen politikat zhvillimore për të cilën Qeveria e ka gojën plotë, nisjani të tregoni atë edhe në përpilimin e prioriteteve në buxhete. Për fund edhe ky buxhet është kopje e pestë e buxheteve të tjera dhe e traditës së buxheteve të varfërisë së ideve për zhvillim dhe të varfërisë së planifikuar për qytetarët. Ju faleminderit

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit.** Fjalën e ka deputetja Drita Statovci, le të përgatitet deputeti Mazllom Kumnova.

**DEPUTETJA DRITA STATOVCI -** I nderuari kryetar, ministra, të nderuar të pranishëm. Sot kur po debatojmë për Projektligjin përbuxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe për autorizimin e shpenzimeve për vitin 2007, e kam vështirë të flas pa shprehur dy shqetësimë dhe pa mohuar rezultatet profesionale. Shqetësimi im i parë është shqetësim për mënyrën se si është përpiluar ky projektligji, përkatësisht projektbuxheti për vitin 2007. Këtu në Kuvend projektbuxheti na vjen shumë i thjeshtë, pa ofruar mundësi për të bërë ndonjë analizë me peshë për ndonjë fushë të caktuar, së cilës i referohet, po ashtu, fare nuk sqarohen rrethanat parametrat shoqërorë dhe ekonomikë, si tregues mbi bazat e të cilëve është ndërtuar ky projektbuxhet. Mendoj, se një arsyetim i tillë ka qenë i domosdoshëm. Shqetësimi i dytë është i ngjashëm me të parin, por tanë për mua vjen më i përqendruar në mënyrën e ndarjes së mjeteve buxhetore për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Po të shikohen shifrat e mundimshme mikroskopike dhe kolonat e tabelës së dhënë dhe po të analizohen elementet e saj horizontale konform vertikales, pra zërat buxhetorë, do të shohim se fare pak mësojmë për diçka konkrete. Kjo ministri ngërthen në vete veprimtarinë e gjerë të arsimit, të shkencës dhe të teknologjisë. Çfarë mësohet nga ky projektbuxhet që na është ofruar sot? Të nisemi nga arsimi. Së pari në këtë projektbuxhet për vitin 2007 nuk mësojmë dot orientim më të qartë dhe transparent të mjeteve financiare, nuk e dimë sa dhe si janë financuar arsimi dhe edukimi që nga ai parashkollar, fillor e deri në shkallën superiore, cilat janë prioritetet në këtë drejtim? Në këtë rast unë nuk mund të mos shprehi admirim dhe respekt të thellë për mësimdhënësit dhe pedagogët e të gjitha niveleve, sepse këta evitojnë krizën në arsim, punojnë shumë, por shpërblehen fare pak. Ky projektbuxhet as kësaj radhe nuk tregon ndonjë përkujdesje më të madhe në këtë drejtim.

Edhe një çështje tjeter, arsimi i shoqërisë kosovare, domosdoshmërisht ka hyrë në reformat, por edhe domosdoshmërisht duhet të ecë më tutje. Ata që gjenden në këtë vorbullë thonë se janë arritur rezultate të mira, porse u mungon mbështetja akademike edhe institucionale, financiare. Sipas këtij projektbuxheti vërtet është vështirë të deshifrohet sa mjete ndahen

dhe si ndahan këto për këtë aspekt. Reformat e transformimi nuk mund të arrihen vetyetiu, por funksionalizimi i një sistemi të tillë duhet të gjëzojnë përkrahje dhe qasje më të madhe qeveritare, institucionale, që për habi, nuk mund ta lexojmë në këtë projektbuxhet. Në fushëveprimin dhe në obligimet e veta Ministria e Arsimit ka pjesë fushëvepruese shkencën dhe teknologjinë. Në çështjet shkencore të kësaj fushe të arriturat maten me projekte dhe me punë hulumtuese, shkencore, me rezultate në këtë fushë. Këto të arritura besoj se pajtoheni që të gjithë synojnë dhe pretendojnë institutet shkencore, universitetet, akademitë dhe institacione natyrash të tjera, mirëpo është e habitshme se në këtë projektbuxhet nuk shihet nëse ndonjë shumë sado simbolike të jetë orientuar a projektuar në këtë drejtim në hulumtime shkencore, mirëpo kjo në projektbuxhet nuk është pasqyruar, prandaj debatimi në këtë drejtim shfaqet i myllur dhe kështu mund të shtrohen edhe shumë të panjohura për projektbuxhetin 2007, përkatësisht të panjohura si janë trajtuar arsimi, shkenca dhe teknologjia në përgjithësi në aspektin e mbështetjes funksionale institucionale. Dëshiroj të theksoj edhe në formë se investimi në arsimasnëjëherë nuk mund të jetë i shtrenjtë, arsimi e mban dhe e ndryshon shoqërinë, e çon gjithënë përparrë dhe e bën të krahasueshëm me të tjerët. Projektbuxheti 2007 nuk i reflekton këto përkujdesje dhe mbështetje institucionale, Besoj se pajtohem që duhet të bëjmë dhe të mendojmë ndryshe për mbështetje më të mirë të arsimit. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Mazllom Kumnova, le të përgatitet Xhevdet Neziraj

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA – Zoti kryetar, ministra. Kur shqyrtohet dokumenti kryesor i vitit ,Projektligji për buxhetin duhet pritur edhe interesimi i gjerë i këtij kuvendi. Edhe sivjet jemi në dilemë si ta klasifikojmë këtë projektbuxhet. Të gjithë treguesit çojnë në favor si buxhet shpenzues përmbylli këtë gjendjeje ekzistuese. A ka tregues të rritjes ekonomike dhe sa parashikohen, **sa reflekton ..... konkretisht sa.** A krijon kjo rritje mundësi të investimeve kapitale ose rritjen e të ardhurave kombëtare, domethënë, një tregues që premton nxitje të zhvillimit ekonomik të Kosovës.. Këtë e kemi thënë edhe para një viti, fatkeqësisht e besoj se edhe sivjet përgjigjen e dimë të të gjithë.

Treguesit e paraqitur të buxhetit të 2007 në krahasim me këtë vit që po e lëmë nuk jam optimistë, por më tepër i shohim me shqetësim shifrat e dhëna. Pse ka ndodhur kështu ne jemi të vetëdijshëm se rrëthanat politike në të cilën po jeton Kosova e kanë kushtëzuar këtë gjendje. Duke krahasuar me buxhetin që jemi duke shfrytëzuar ,por projektbuxheti i vitit 2007 shënon një fillim të rritjes së shpenzimeve qeveritare, mirëpo nuk janë dhënë parashikime përmbylli rritjen e ministrite të reja , të Integrimit dhe të Punëve të Jashtme, të Mbrotjes që do të janë shpenzues të këtij buxheti. Nuk vie në dyshim metodik në hartimin e projektbuxhetit si i vitit të kaluar vetëm kanë ndryshuar shumat, ndoshta përvëç pasqyrës të investimeve me financim të brendshëm nuk e di sa janë mundësítë . Në një shtesë të këtij projektbuxheti ma merr mendja se duhet të shënohen edhe investimet e huaja, bashkëfinancimet me investime të huaja dhe financimi i brendshëm, pastaj vënia në qarkullim të brendshëm dhe jo jashtë Kosovës e fondit të Trustit Pensional . Pra.mëgjithatë këto janë para publike. Këtë e them për shumë arsyë ,sepse këtu e kemi një pasqyrë më reale se çfarë janë gjasat e investimeve në përgjithësi.Kjo është praktikë e njojur edhe në shtetet e huaja dhe shkon si shtesë e Projektbuxhetit.

Tjetër, sa premtojnë këta tregues në bartjen e deficitit të përgjithshëm buxhetor në nivel të përbushur, po ashtu në këtë projektbuxhet nuk vërehen shenja të precizitetit të zhvendosjes, Pasi nuk janë vërejtur ndryshime inkurajuese në transferet ekzistues nga buxheti qendoror te qeverisja lokale.

Janë shqetësuese format e propozuara, sidomos për arsim edhe pse është shënuar një rritje në krahasim me këtë vit. Propozoj që gjatë propozimit në Komisionin për Buxhet dhe Financa të rishikohet edhe një herë neni 6 pikat 9 deri në pikën 14, sidomos te pozicioni i AKM-së, për të cilën folën edhe parafolësit që asnjëherë deri më tanë nuk është diskutuar domosdoshmëria e kuotës së raportimit të propozimit të kërkësave financiare. Por edhe kjo çështje duhet t'i mbetet komisionit të këtij Kuvendi. Kuota për AKM për afërsisht merr sa janë edhe investimet kapitale. Po ashtu nuk e kam të qartë si reflekton vendimi i fundit i Këshillit Evropian për krijimin e lehtësive doganore në Ballkan. A do të pësojnë kuotat e pozicionit të hyrjes buxhetore nga doganat në buxhetin e Kosovës, unë mendoj se shkon në dëm dhe e godit edhe buxhetin tonë.

Edhe ky projektbuxhet nuk jep zgjidhje për problemet që kanë të bëjnë me uljen e varfërisë, të papunësisë, mbështetjen e reformës së arsimit dhe me kërkësat e tjera sociale. Për çdo ditë jemi duke u përballur me tendencat e përshkallëzimit. Unë, mendoj se treguesit e këtij projektbuxheti nuk do të janë të qëndrueshëm dhe do të pësojnë oshilime në vitin 2007, për realitetin e ri politik që do të ndodë në Kosovë dhe për faktorët e tjerë. E përkrah parimi si dokument të domosdoshëm financiar, mirëpo duhet të jemi të vetëdijshëm se ndryshimet do të ndodhin. Mbetim me shpresë se këto ndryshime do të ndikojnë për kapërcimin sadopak të gjendjes së përdorueshme sociale. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka Xhevdet Neziraj, le të përgatitet deputetja Fatmire Mulhaxha.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ – Ju faleminderit! Inderuari z. kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë. Ligji mbi menaxhimin e financave publike paraqet kornizën dhe procedurën për përgatitjen dhe operimin e buxhetit. Për dallim nga vendet e tjera përgatitja e buxhetit është një proces më i ndërlikuar, sepse në proces janë të inkuadruar si aktorët vendorë ashtu edhe ndërkombëtarë që reflekton edhe natyrën specifike të organizimit të shoqërisë kosovare. Në përgatitjen e buxhetit të Kosovës rol të rëndësishëm dihet se luajnë Këshilli Ekonomik Fiskal dhe Përfaqësuesi Special, ku mund të themi se roli i Qeverisë dhe i Parlamentit më tepër janë të natyrës formale, mirëpo besojmë se në të ardhmen këtë do ta ndryshojmë.

Qëndrueshmëria e buxhetit të Kosovës është në varfëri të madhe nga rritjet e të hyrave të brendshme nga tatimi dhe taksat të cilat duhet të zëvendësohen në të hyrat nga dogana. Mua më gjzon fakti se z. m. inistëri tha se në këtë drejtim kemi të hyra më të mëdha të brendshme dhe tatime e taksa me 12.5%. Kjo rritje është në varshmëri me zhvillimin ekonomik, sepse nuk mund të pritet qëndrueshmëri buxhetore pa një qëndrueshmëri ekonomike. Prandaj, Qeveria duhet të ndërmarrë edhe masa të mëdha stimuluese, sidomos në sferën e prodhimtarisë për nevoja për një ofisencë të shfrytëzimit të mjeteve buxhetore, që do të verë shfrytëzimin dhe destinimin e arsyeshëm të këtyre mjeteve, me qëllim që të

japin rezultate të caktuara në shëndetësi, arsim, sigurisë e rend dhe kështu të bëjë justifikim më të mirë të shpenzimeve të parave të tatimpaguesve..

Më gjzon fakti se në vitin e ardhshëm do të ketë investime më të mëdha kapitale. Unë për këtë i përgëzoj Qeverinë dhe Ministrinë. Nga buxheti i Kosovës janë ndarë edhe fondet e mëdha për AKM-në dhe për disa agjensione rezervë. Vetëm dua ta marr një shembull që për AKM-në edhe viti tjetër do të jetë 75 milionë, ndërsa janë marrë 300 milionë. Unë do të kisha kërkuar nga ministrat që marrin pjesë në Bordin e AKM-së që një pjesë e këtij fondi të dedikohet diku tjetër. Ta marrim p.sh. në Ministrinë e Bujqësisë nuk ka ndarje të mjeteve për subvencione, ndërsa në Kosovë hyjnë mallra dhe produkte ushqimore bujqësore më tepër sesa gjysma e buxhetit të Kosovës. Atëherë shumë është më mirë që ata 5 milionë t'i dedikohen për subvencione Ministrisë së Bujqësisë sësata t'i lihen AKM-së, do të thotë një fond i ngrirë. Gjithashtu do ta marr një shembull. Departamenti i Industrisë ka vetëm 1 milion e 600 mijë. Sa mund të zhvillohet industria e Kosovës me 1 milion e 600 mijë euro unë do të them se nuk mund ta përfundojë as parqet industriale që ka filluar t'i ndërtojë. Unë them se këso mjetesh të merren pak nga AKM-ja dhe të fillojë zhvillimi i industrisë, për arsy se janë dy sfera industria dhe bujqësia, që duhen të rigjenerojnë të ardhurat e hyra në buxhetin e Kosovës. Unë do ta bëj një krahasim tjetër në ndarjen e drejtë buxhetore ku edhe aty ka një larmani që fillon prej 1 deri në 49%, më duket te Suhareka, për 49, Novo Brda edhe aty është një problem se duhet të analizohet për arsy se në ato zyra lokale të komuniteteve varet se cili komunitet e udhëheq dhe e harxon atë buxhet pa u planifikuar, do të thotë duhet të gjendet një mekanizëm që të përfitojnë nga ky buxhet të gjitha komunitetet që jetojnë në atë komunë edhe pse personalisht jam kundër ndarjes së drejtë buxhetore se askund në botë nuk ka ndarje për shumicën dhe ndarje për pakicën. Një krahasim tjetër do ta bëja edhe te ndarja e buxhetit për komuna. Unë pasi vij nga Peja do të bëj një krahasim. Peja është duke u dëmtuar që pesë vjet me radhë. Nuk ka mundësi që komuna e Prizrenit të jetë me numër të banorëve dy herë më e madhe se Peja. Komuna e Prizrenit merr afro 16 milionë, komuna e Pejës merr 8 milionë. Kjo është një, mund me qenë një rritje e vogël e jodyfishtë. Tani komuna e Prizrenit ka mundësi të bëjë investime kapitale shumë më të mëdha deri në 5 milionë, ndërsa komuna e Pejës 1 milion, ndërsa dihet se komuna e Pejës ka qenë tërësisht e shkatërruar gjatë luftës. Përkundrazi ajo është dashur të ketë një stimulim dhe është dashur që të ketë edhe grante stimuluese, por është dashur të ketë buxhet më të madh për shkak të shkatërrimeve që janë bërë gjatë luftës. Prandaj besoj që diçka mund të ndryshojë, sidomos në ndarjen e komunave për arsy se z. ministër për të shkuar në vendlindje ju duhet të kaloni nëpër Pejë se kështu mund t'i ndihmosh Pejës në këtë aspekt dhe ka bazë të qëndrueshme për arsy se 5 vite nuk mund që komuna e Prizrenit të jetë dyfish. Nëse ka deputetë dyfish, nuk ka banorë, jam i sigurtë dhe të merren përqindja e regjistrimit të popullsisë e vitit 1981 me indekse se dihen përafërsisht mund të ketë një numër shumë të vogël të banorëve në krahasim me Pejën. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në sallë i kemi 72 deputetë. Fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha, le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – Ju faleminderit z. kryetar!

Ne sot këtu po diskutojmë për një buxhet që kushtmisht ta them buxhetin e pavarësisë së Kosovës. Ky buxhet do të jetë një ditë pas a para pavarësisë dhe një ditë pas pavarësisë.

Qytetarët e Kosovës do të bijnë një natë në gjumë, do të zgjohen të nesërmen, por do ta kenë këtë buxhet. Prandaj, donacionet nuk do të vijnë nga qelli as nuk do të vijnë pa një vizion dhe strategji e qartë e Qeverisë, kur do të dëshmojmë se jemi të gatshëm së pari t'i menaxhojmë ato të hyra vetanake që i kemi, pastaj do të vijnë donacionet që shpresojnë të tjerët që do të vijnë si prej qiellit

Një buxhet që e kemi para nesh, faktikisht është dashur të jetë këtu objekt studimi vetëm nga profesionistët – ekonomistët, se këtu pretendohet që të tjerët nuk kanë fortë dijeni dhe nuk është dashur shumë me folë për këto çështje të buxhetit, por unë po ju siguroj qe edhe qytetari i fundit i Kosovës është shumë i preokupuar për çështjet e buxhetit,aq më parë është shumë i irituar për derdhje të shpenzimet, për luksin të cilin , qeveritarët tanë edhe faktikisht nuk mundohen ta fshehin, por e eksponojnë në mënyrën më, si ta them, pretencioze edhe ajo qytetarëve u siguron shumë irritim, , bile merren çdo ditë me këto punë, por edhe ne të tjerëve na takon, së paku t'i them dy tri fjalë. Unë po fokusohem, nuk po shkoj tash me folë për të gjithat që u përmenden këtu , përveç edhe një herë po e përsëris,por kur flitet për investime kapitale të jepni vetëm shifra e vlera e të përmendni shembull shëndetësinë një institut onkologjik, i cili filloj shumë herë, nuk dihet sa u investuar dhe nuk dihet a kërkohen prapë investime për to çdo vit dhe kërkund nuk është në përfundim. Është një shembull si ne nuk dimë ku na shkojnë këto investime kapitale, se për ne është një iks i panjohur kët, gjithashtu edhe për mallra e shërbime. Shifrat marramendëse vetëm ata që i kanë për t'i shpenzuar dinë nga do të shkojnë.

Sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë shumë shpresëdhënës që e njëjta ka me na u përsërit si buxheti qysh e kemi kështu përpara të njëjtë me një rritje minimale që nuk ka kurrfarë peshe. Ne do të ballafaqohemi, po e dimë se buxheti është i limituar. Cili është vizioni ynë? Shumë herë këtu është ruajtur çështja e sigurimit shëndetësor . Z. ministër i Financave, jo një herë. në këtë kuvend është shtruar pyetja ju e keni proceduar, Ministria e Shëndetësisë si sponsor ka proceduar një ligj i cili nuk është i implementushëm. Nuk është shkur së paku në fazë, me atë çka është e mundur, d.m.th. jo një me qenë aq ambicioz , se ne po e dimë sa është e mundur sot me kaq punësim të vogël e sa mund të mbushet një fond, mirëpo ne duam me i ditë pengesat për krijimin e fondevë sot në Kosovë edhe qysh ju po i shihni, si do të krijohen. Nuk ka rrugëdalje, Është çështje numër një krijimi i Fondit për Sigurimin Shëndetësor. Me këtë buxhet këtu edhe pa një vizion qartë, pa na thënë ju, keni me e krijuar, unë nuk kam dëshirë, por situata e njëjtë do të na krijohet vitin e ardhshëm. Edhe ju leht në fund të vtit, por as mesi i vtit nuk do të na presë. Ju po e shihni, vetëm merreni e analizoni sa ndahet për kujdesin parësor. 80% të shërbimeve shëndetësore pretendohet të kryhen në shërbimin parësor, ndërsa sa ndahet për nivelin parësor?

Programi farmaceutik sa ndahet, sa ka mundësi me u mbush spitalet me ato pajisje dhe produkte elementare që të mos vijnë situata me na u myllë sallë salsa e operacionit për mungesë të dorëzve, të anestetikëv etj.. Atëherë trajtimi në botën e jashtme 500 mijë euro, ju lutem kur nonsens që sot radioterapi nuk kemi për pacientët që vuajnë nga sëmundjet malinje. Sot bëdhen në gjendje tejet të rëndë, kush i ka familjarët mund t'ju them se kemi epidemi të kancereve në Kosovë. Bëdhen sot dhe askush nuk brengoset që sot nuk ka mundësi radio-rrezatime, radio-terapia të kryhet ,përveç trajtimit kirurgjik dhe kemo-terapisë që paguhet nga xhepi i qytetarëve të Kosovës , plus kur mbahet një program humanitar qeveritarët nuk vijnë aty së paku si figura të ndihmojnë në mbledhjen e fondevë nga qytetarët, sepse nga xhepi i qytetarëve , donatorëve, njerëzve që janë zemërgjerë po mbushen disa fonde për t' u ndihmuar njerëzve që janë në situatë tejet të rëndë.. ndërsa, nëse ndahen 500 mijë për trajtim jashtë vendit duhet me i krijuar alternativa

në vend, sepse qe disa vite ka filluar ndërtimi i Institutit Onkologjik, janë blerë pajisje që rrinë nëpër bodrume dhe depo ku nuk përbushen kriteret për mbajtjen.pse blihet para kohe, a objekti kërkund.,kjo veç në Kosovë ndodh. Aparatura e sofistikume, e shtrenjtë, jokomplete, sikur që ndodhi edhe me koronarografinë , e cila ende nuk funksionon se blihet një pjesë, nuk blihen pjesët e tjera, sepse kërkush nuk e përcjell implementimin e investimeve që bëhen për investime kapitale për blerjen e aparaturave të shtrenjta për ndërtimin e objekteve. Kalojnë tendere, firma të dyshimta, japid çmime të ulëta, ndërtohet një objekt që nuk i plotëson kriteret, ndalet puna në gjysmë e tash në vitin tjetër duhen investime të reja .për të njëtin objekt, për të cilin n para dy tri –viteve është ndarë shuma e nevojshme për ndërtimin e atij objekti.

Këtu nuk po e shohim Inspektoratin sanitar. Ky kuvend e ka votuar një ligj në parim që është Ligji për ushqim dhe paramendoni që Ministria e Shëndetësisë e amputon si të panevojshëm Inspektoratin sanitar, dhe ia kalon Ministrisë së Bujqësisë. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka ngritur zërin këtu në vend të Ministrisë dhe ka thënë: kjo është nonsens t'i futë një inspektorat i cili nuk merret vetëm me ushqim, por e ka një sërë punësh tjera. Shikoni tash sa kërkohet për Inspektoratin sanitar këtu. Një inspektorat po qe se votohet Ligji për ushqim këtu, nesër i kalon Komisionit për Bujqësi që është në Kuvend dhe po lufton me e hedhë këtë inspektorat pa kurrsfarë bazushmërie në Ministrinë e Bujqësisë. Ku shkojnë këto mjete? Këto që janë cekur nëpër inspektorat sanitar nuk di as unë, se veç me ligj është amputuar.

Në anën tjetër për Inspektoratin Shëndetësor nuk shoh kurgjë që është ndarë, . Do të thotë, tash për Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie. E lexova edhe këto ditë që është kërkuar nga Fondi Monetar që tri ligje tërhiqen: Ligji për vlerat e Luftës, Ligji për sigurim pensional dhe invalidor dhe Ligji për punë se janë ligje me implikime shumë të mëdha buxhetore dhe nuk mund të implementohen. Tash po e përshëndes atë qysh keni deklaruar se nuk mund me ndodhë ajo që është për qytetarë. Kush e lexon në gazetë, me të vërtetë shumë shpresëdhënëse, por ku është realiteti, implementimi sa është i mundur Ju e dini në seancë kur është votuar Ligji për Punë ministri ju ka thënë: nuk ka para. Unë nuk po e shoh këtu pozicionin. Nesër mund me u votua këtu prapë Ligji për pensione.Ky tashmë është proceduar në Qeveri, d.m.th. ne prapë ju pyes fondet z. ministër , ju lutem përgjigju këtu. Ligji për sigurim është peng në këtë Kuvend, në opinion po del që është në Kuvend, po qe kryetari i Komisionit për Buxhet edhe ai e ceku sot, ai veç figurativisht është penguar në Kuvend, se ai është kryer nga Komisioni bazik që e ka Komisioni funksional, po ai ligj është stopuar edhe thjeshtë nuk ka zgjidhje. Z. ministër kaq. Ne i kemi sytë kah ju, që të na përgjigjeni edhe kisha dashur që kjo të jetë sot jo më vonë

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA-** Ju faleminderit për këtë relaksim që na e dhatë. Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori , le të përgatitet deputetja Zahirije Jusufi

**DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI -** Z. kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë!

Është mirë që kësaj radhe po debatojmë më herët për Projektligjin për buxhetin e vitit vijues dhe të vitit tjetër, sepse do të thotë shihet se ka nevojë për të debatuar dhe kjo është mirë. Secili mund ta paraqet vizionin e vet, secili mund ta paraqet mendimin e vet dhe është një e mirë e madhe që bashkërisht po vijnë në përfundim se nevojat janë shumë më të mëdha për të financuar projekte të ndryshme për të cilët realisht janë mundësítë. Natyrisht, me rastin e hartimit të këtij projektbuxheti kanë qenë parasysh edhe disa

parametra makroekonomikë mbi të cilët mbështetet Projektbuxheti në përgjithësi, sikur që është brutoprodukti vendor, konsumi publik, investimet për një kohë më të gjatë , rritja e eksporteve dhe e importeve, të cilat për momentin e bëjnë bërthamën e mbulimit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, duke u bazuar në legjislacionin mbi mbledhjen dhe grumbullimin e të hyrave tatinore. Kjo është ajo që ka shërbyer si një bazë edhe në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa. Në këtë rast unë diskutoj më tepër si deputet i Kuvendit të Kosovës, por që jeni thellësisht me këta parametra gjatë hartimit të projektbuxhetit në përgjithësi dhe të bashkëpunimit me agjencionet shpenzuese.

Pra, si krijohet buxheti? Momentalisht në mund të shohim strukturën e të hyrave tona . Të gjitha ato struktura dhe struktura e ty hyrave buxhetore që bazohen në rregullativën ligjore që mundëson mbledhjen dhe grumbullimin e të hyrave tatinore ,qoftë ato në kufi, qoftë brenda vendit. Derisa të mos ndryshojë ajo irregullore mbi grumbullimin e të hyrave ose Ligji mbi grumbullimin e të hyrave tatinore ,sigurisht se duhet t'i përbahemi asaj irregullative dhe ajo mund të ndryshojë në këtë rast përmes Kuvendit të Kosovës ose nëpërmes Zyrës të Përfaqësuesit Special në rastet e caktuara të irregulloreve që e mbulojnë këtë fushë.

Buxheti i konsoliduar i Kosovës, u tha edhe nga parafolësit,në masën më të madhe mbulohet nga të hyrat doganore dhe kemi një pjesë të konsiderueshme nga të hyrat brenda vendit. Është një tendencë e mirë që kjo të përmirësohet dhe ky është ai faktori kryesor ndoshta që ne duhet të na bëjë optimist që megjithë vështirësitë me të cilat po ballafaqohet ekonomia e jonë brenda vendit dhe kemi ardhur deri te, në bazë të këtyre parametrave deri te limiti i epërm i shpenzimeve buxhetore.Thnë kolegët së është në bazë dhe ai kufi duhet të jetë për këtë vit rrëth 717.5 milion euro që edhe një herë po them, të gjithë duke u bazuar në kërkeshat e agjensioneve buxhetore sigurisht se është i vogël, por kjo është ajo mundësia edhe më mirë është që të bazohemi në një buxhet real e të qëndrueshëm se sa të bazohemi në një buxhet i cili ndoshta mund të mbetet i shkurtër, për ta mbuluar me implementim në vazhdimësi. Ndarja e buxhetit për vitin 2007, të nderuar kolegë në Ligjin mbi menaxhimin e financave publike jemi të obliguar që dëgjimet buxhetore në agjpcionet shpenzuese të bëhen gjatë vitit për buxhetin që do të vijë dhe kjo praktikë është praktikuar edhe gjatë këtij viti. Në të gjitha agjpcionet buxhetore të nivelit qendror edhe në ato të pjesës së rezervuar, edhe në ato të pjesës tjetër , janë zhvilluar dëgjimet buxhetore dhe janë harmonizuar parametrat buxhetorë dhe shpenzimet në këtë rast , duke u bazuar në kërkeshat e agjencive shpenzuese, por natyrisht duke pasur parasysh limitin buxhetor - kufirin e epërm të buxhetit.

Unë dua ta pranoj në këtë rast se ka shumë projekte që mund të kenë qenë më prioritare se sa ato që janë vu, mirëpo këto prioritete janë vu nga vetë agjpcionet shpenzuese dhe në këtë rast ne mendoj se janë prioritetet më primare . Thuhet se agjpcionet janë të tjera për t'i implementuar gjatë vitit fiskal 2007 ,që ne tanë po hymë. Natyrisht se shumë projekte, sigurisht se ka pasur nevojë që të financohen në masë më të madhe, por është dashur të kihet kujdes në racionalizim të financimit, jo në racionalizim të shpenzimeve se ajo do të shihet në vazhdim dhe do të bëhet sigurisht një kujdes shumë i madh, një monitorim shumë i madh i Ministrisë. E kam fjalën në racionalizim të ndarjes me qëllim të mbulimit të një numri sa më të madh të projekteve që t'u ndihmojë në realizimin e projekteve të caktuara nga agjpcionet shpenzuese.

Derisa konstatojmë se buxheti është i pamjaftueshëm, në njëren anë dhe në tjetrën anë, konstatojmë se kërkeshat janë shumë më të mëdha, atëherë shtrohet nevoja çka duhet bërë më tutje. Unë do të sugjeroje tri-katër elemente të cilat nuk janë të reja , siç i kemi thënë, por do të përërisja vitin e ardhshëm se ne kemi nevojë të ballafaqohemi dhe sigurisht se

do të ballafaqohemi edhe me gjendjen më të re të statusit politik të vendit, jo vetëm në vitin 2007, por në vazhdimësi më tutje me qëllim të ndërtimit të një politikë më afatgjatë ekonomike në përgjithësi.

E para do të ishte nevoja e rritjes së buxhetit nëpërmes përmirësimit të politikave fiskale, që mendoj se është një çështje që ta trajtojmë dhe do të ndikojë në përgjithësi në përmirësimin e gjendjes buxhetore në vend.

Aspekti i dytë do të ishte të kemi disiplinë financiare në përgjithësi në grumbullimet e të hyrave që po ashtu do të jemi shumë të vëmendshëm dhe besoj se në këtë drejtim do të ketë hapa konkretë në përmirësimin e kësaj gjendje në përgjithësi.

Të nderuar kolegë!

Ne së shpejti do ta kemi këtu në Kuvend ose e kemi pasur Ligjin për tatimin në vlerën e shtuar, kemi pasur leximin e parë, do ta kemi në amendamentim e tutje dhe do të shohim se çka biznesi në këtë rast çka mund të përfitojmë nga një shkallëzim ose përshkallëzim i normave të tatimeve në tatimin në vlerën e shtuar për të bërë një praktikë të ngjashme në vend dhe rajon që ndoshta do të ndikonte sado kudo në përmirësimin e gjendjes buxhetore në përgjithësi, sikur edhe ngritjen apo uljen e pragut buxhetor në përgjithësi. Praktika e vendeve të rajonit tregon se disa vende këtë prag e kanë shumë më të ulët se sa që parashihen në Ligjin mbi tatimin e vlerës së shtuar tash për tash, ose që mund të jetë i amendamentuar në vijim në Kuvendin e Kosovës. Dhe çështje të tjera që do të ndihmonin në përgjithësi në shfrytëzimin sa më efikas të buxhetit, racionalizimin e tij të atyre mjeteve që i kemi përmes një transparence tepër të lartë dhe një monitorim shumë të madh, duke e zbatuar Ligjin mbi menaxhimin e financave publike, Ligjin mbi kontrollin financier dhe raportimet dhe natyrisht Ligjin mbi prokurimin publik në Kosovë. Një shkurtim i afateve në këtë drejtim i Ligjit të prokurimit që ne po ashtu do ta kemi shumë shpejt në amendamentim, do të ndihmojë që të kemi një efikasitet më të madh të shfrytëzimit të mjeteve të dedikuara për investimet publike, përkatësisht investimet kapitale dhe kjo sigurisht se do të ndikoj që mos të kemi një mbetje buxhetore në fund të vtitit sa u përket investimeve kapitale. Unë mendoj se Ligji, përkatësisht ky buxhet në vitin 2007 është shumë më kualitativ dhe tregon lëvizjen e lehtë nga investimet kapitale që nuk ka qenë praktikë ndoshta në të kaluarën, ndoshta për shkak të nevojave emergjente në fushat e tjera. Kemi zbritje të lehtë të kategorisë së mallrave e të shpenzimeve që po ashtu tregon një tendencë të ecjes në përmirësim të strukturës në dobi të investimeve kapitale. Nuk do të lëshohem në projekte të caktuara, sepse të gjitha agjensionet shpenzuese kanë projektet dhe unë mendoj se ato duhenj të përbahen në bazë të prioriteteve të cilat i kanë dhënë në rastin e dëgjimit buxhetor të hartimit të buxhetit se deri tash e kemi sjellë në Kuvend. Unë kërkoj një angazhim konkret të Kuvendit që të bëjë një implementim të suksesshëm dhe besoj se angazhimi gjithnjë nuk do të mungojë në këtë drejtim. Ju faleminderit z. kryetar!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Fjalën e ka Zahirije Jusufi, le të përgatitet deputeti Berat Luzha

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI - I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë! Në programin e vet Qeveria premtoi se do t'i kushtojë kujdes pozitës së pensionistëve. Premtoi se do të punojë për përmirësimin e gjendjes së tyre materiale. Është brengosëse se edhe në këtë vit me projekcionet e buxhetit skema sociale po thuaj se nuk ka ndryshuar nga rregulloret e UNMIK – ut.

Buxheti i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale është po thuaj se i njëjti me vitin e kaluar 129 milion e 356.000 në këtë buxhet pensionistët nuk do të përfitojnë asgjë më shumë seç kanë përfituar edhe pse buxheti është i limituar i përbushë të gjitha nevojat dhe se përballet me kufizime të shumta buxhetore. Qeveria mban përgjegjësi për të siguruar përkujdesje sidomos për familjet e dëshmorëve dhe për invalidët e luftës, për pensionistët dhe të të sëmurët. Qeveria pati pak vullnet për detyrimet për përkujdesje edhe ndaj kategorive me aftësi të kufizuara, sidomos ndaj fëmijëve. Skemat ekzistuese sikur janë kopjuar nga viti i kaluar, vazhdojnë të njëjtat. Në buxhet nuk parashihet kurrrafë rritjeje krahasuar me vitin e kaluar. Për pensione bazike janë ndarë 64 milion e dyqind e katërmijë euro. Për pensionet e invalidëve të luftës është paraparë një rritje minimale prej 1 milion euro, janë ndarë 8 milion e treqinde njezetedymije euro. Qeveria duhet të gjejë mundësi e rrugë, gjithnjë duhet të ekzistonjë për ta përbushë obligimin institucional ndaj atyre që u kemi borxh. Me këtë buxhet të ndarë nuk mund të sigurohet përkujdesje ligjore ndaj tyre. Mendojmë se ka zgjidhje shumë më të vlefshme.

Në planifikimet buxhetore, buxheti u nda pa analiza rigorozë të prioriteteve. Për pensionistët rekomandimet e Kuvendit nuk u kuptuan seriozisht. Ligji për pensione nuk u shqyrtua. Edhe nëse aprovohet, a do të implementohet me këtë buxhet? Për zbutjen e problemeve buxheti duhet të planifikohen në mënyrë më racionale të gjitha problemet e sferës sociale, duke i paraparë drejt shpenzimet. Qeveria mban përgjegjësi si për mohimin e së drejtës për pensionistët e pleqërisë, invalidorë e familjar, të fituar në punë dhe në bazë të punës së kryer, ata u privuan nga statusi i tyre dhe u shndërruan në kategori sociale. Struktura e shpenzimeve me vendosje duhet të ndryshojë, duhet të shqyrtohen evidencat, që të evitohen mundësitë që të mos përfitojnë, ata që nuk i plotësojnë kriteret për pension të parakohshëm. Të planifikohen zbritjet e shpenzimeve të panevojshme, e adresimi i tyre, për sfera jetike. A kontrollohen agjensionet buxhetore kur planifikojnë pa kriter, pa bërë analiza, pa i përfillë prioritetet, a kontrollohen kur shpenzojnë pa kriter, për mobile dhe mirëmbajtjen e tyre, për vetura dhe mirëmbajtjen e tyre, për karburante, për telefona, për dreka dhe darka zyrtar?, Sa shpenzohen pa nevojë para të buxhetit, a analizohet, duke i reduktuar këto shpenzime, këto mjete mund të shfrytëzohen për pensione, për spitale për shkolla.

Papunësia shënon ngritje. A ka politika të punësimit, a ka në këtë buxhet projekte për zbutjen e papunësisë. Sa do të zbatohet kontrata kolektive me këtë buxhet?

Edhe pse kryeministri, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit, gjatë grevës në QKU pat premtuar që shëndetësinë ta trajtojmë si prioritet dhe do të gjejmë mënyra ta përmirësojmë gjendjen shëndetësore dhe standardin e personelit shëndetësor. Gjithmonë ka rrugë dhe mundësi, pat deklaruar kryeministri. Me buxhetin e vitit 2007, shëndetësia nuk mbështetet si prioritet, Qeveria nuk e kishte vullnetin e duhur ta trajtojë si prioritet, ajo edhe këtë vit trajtohet si në vitet e mëparshme. Me një përqindje të ndarjes buxhetore më të ultën në rajon nën 8%, krahasuar me vitin 2006, buxheti u rrit nga 88 milion në 51 milion e 780 mij. Me këtë ngritje minimale, nuk plotësohen premtimet e Qeverisë për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, për kushtet e punës dhe pajisjet nuk mund të ngritën në nivel më të lartë. Është brengosëse se edhe këtë vit, bazuar në projektbuxhetin struktura e shpenzimeve nuk ka ndryshuar.

Krahasuar me vitin 2006 edhe në projekcionet e buxhetit të vitit 2007, shpenzimet për pagë janë pothuajse të njëjta. Ndërkaq, për pagesën e kujdestarisë për ndryshim, janë ndarë 1

milion e 200 €, por me këtë nuk përmbushen kërkuesat për implementimin e Ligjit për shëndetësi, për pagesën e kujdestarisë. Mendoj se struktura duhet të ndryshojë, duke i llogaritur drejt shpenzimet për shfrytëzim racional të buxhetit. Në këtë buxhet nuk janë parashikuar drejt edhe vlerësimet e shpenzimeve të spitaleve në bazë të kriterit të numrit të banorëve, të numrit të punëtorëve, numrit të shtretërve dhe shfrytëzueshmërisë së tyre. Në buxhet po ashtu nuk janë projektuar shpenzimet për ngritjen e nivelit të shërbimit terciar. Nuk u mbështetën realizimet e projekteve për kardiologjinë invazive, për kardiokirurgji, për onkologji. Edhe këtë vit, për këto shërbime pacientët do të udhëtojnë jashtë vendit. Është brengosëse se edhe këtë vit nuk kufizohen mundësitë për të mos harxhuar për gjëra të kota. Bazuar në projekcionet e buxhetit dhe në raportin e përkohshëm të nëntëmujorit të vitit 2006, trendi i këtyre shërbimeve, do të vazhdojë edhe këtë vit. Si caktohen limitet e shpenzimeve përmallra dhe shërbime?

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, e bënë hartimin e buxhetit në bazë të kërkuesave, është e kuptueshme se buxheti është i kufizuar për t'i plotësuar të gjitha nevojat. Pse nuk drejtohet vëmendja në sektorë ku duhet, në programin farmaceutik janë ndarë 9 milion e 50 mijë €. Ky buxhet nuk i përmblidhet as përafërsisht nevojat minimale. Qeveria duhet të gjejë mundësi për zgjidhjen e problemit. Në projekcionet e buxhetit ka fusha ku duhet kursyer. Aty ku ka mundësi. Përmallra dhe shërbime, për agjensione, për borde, për autoritetet regullative, planifikime të gabuara, për shpenzime të pakontrolluara.

Ju faleminderit!

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Berat Luzha, le të përgatitet deputetja Flora Brovina.

**DEPUTETI BERAT LUZHA** – Zotëri kryetar, ministra, kolegë deputet!

Unë mendoj se Projektligji për buxhetin e Kosovës për vitin 2007 është një tabelë numrash shumë konfuze, pa pasë shpjegime për të hyrat e mjeteve dhe për mënyrën e shpenzimit të tyre. Se ky projektligji, nuk paraqet pasqyrë të qartë të hyrave buxhetore, tregon edhe rasti i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku nga 9636 mijë €, mbi 4 milion e gjysmë apo gjysma e buxhetit janë mjete të bartura nga viti 2006. Prandaj do të ishte mirë që Qeveria të na tregojë se sa mjete barten nga viti 2006 në vitin 2007 dhe sa është përqindja e këtyre mjeteve? Për shkak se edhe ministritë tjera kanë bërë bartjen e mjeteve buxhetore nga një, në vitin tjetër. Kur jemi te Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duhet theksuar se kjo Ministri nuk ka asnjë projekt të planifikuar për vitin 2007, por vetëm planifikon të vazhdojë projekte që i ka filluar që dy tri vite më parë, si evakuimin e fshatit Hade, i cili është stërvitje tepër, mbylljen e kampit të Plemetinit që ka qenë dashtë të përfundojë qysh para më shumë se një viti, ndërtimin e memorialit Adem Jashari të cilin ende nuk ka filluar as ta ndërtojë dhe disa banesa sociale.

Të përmendim këtu vetëm rastin e kampit të Plemetinit, i cili vërtet është një histori në vete dhe që paraqet edhe sot e kësaj dite një turp për Kosovën. Është shqetësuese se si buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural, as në vitin 2007 nuk arrin një përqindëshin e buxhetit të Kosovës. Buxheti i kësaj ministrie as në vitin e ardhshëm pra, nuk premton zhvillim, përkundrazi garanton stagnim në këtë degë shumë të rëndësishme ekonomike. Madje as në buxhetin e vitit 2007 nuk është paraparë formimi i fondeve zhvilluese, si është fondi për zhvillim dhe përparrim të bujqësisë, fondi për fatkeqësitet elementare natyrore, fondi për subvencione në bujqësi, e për zhvillimin e pylltarisë etj. Nëse është pengesë ligji për menaxhimin e financave, atëherë pse deri tash, plotësimi dhe

ndryshimi i këtij ligji edhe rasti i fondit përrugët, për të cilin fond paguajnë qytetarët, me rastin e regjistrimit të automjeteve të tyre, por ky fond nuk ekziston dhe është një hyrje e paligjshme në buxhetin e Kosovës.

Duhet të theksoj edhe një fakt se disa komuna të Kosovës janë të diskriminuara nga Qeveria, kur është në pyetje ndarja e granteve buxhetore për investime kapitale.

Theksoj se komuna e Kaçanikut, dihet, nuk përfitoj asnjë projekt nga kjo Qeveri qe dy vjet dhe as në vitin e ardhshëm nuk planifikohet që të ketë në listë një projekt të tillë. Te AKM-ja, ne kemi disa pozicione të cilat nuk janë të mbuluara në shifra, si për numrin e të punësuarve, për paga dhe mëditjet, për mallra dhe shërbimet, për shpenzimet komunale dhe të tjera dhe tash këtu krijohet një vakum se vërtet si mund të caktohen këto mjete kur nuk ka shifra të duhura.

Ju faleminderit!

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** - Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Flora Brovina, le të përgatitet deputeti Ferid Agani.

**DEPUTETJA FLORA BROVINA** – Ju faleminderit, i nderuari kryetar, ministra, kolegë dhe kolege.

Diskutimi për buxhetin në çdo kuvend zgjon debat të gjerë, sepse aty në buxhetin dhe me ndarjen e tij, projektohen zhvillimi dhe ecuria, vizioni i një shoqërie. Ky draftligj për buxhetin e Kosovës, në vitin e ardhshëm, a paraqet një vizion të tillë, çfarë e presim, e çfarë duhet të jetë. Sigurisht që jo. Të gjithë e konstatuam edhe në debatin e sotëm se buxheti i Kosovës vazhdon të jetë buxhet i varfër. Buxheti i cili akumulohet nga mjetet në dogana edhe tani kur Kosova ka marrëveshje për tregun e lirë, se i mungon një vizion tjeter i akumulimit të mjeteve, se ky buxhet në të vërtetë, nuk e përmbrush kërkësen e Qeverisë, për realizimin e tri e-ve ekonomisë, energetikës dhe edukimit. Pra nuk e ka vizionin e zhvillimit, por e ka vizionin e një mbijetese edhe ecje në vend të një hapi të breshkës.

Qytetarët tanë nga ky buxhet, nuk do të kenë përfitime të mëdha, as në përmirësimin e gjendjes sociale, as të shëndetësisë, as të arsimit dhe as të kulturës, as të shërbimeve dhe as në hapjen e vendeve të reja të punës. Në të vërtetë ne nuk patëm një pasqyrë reale të programeve, sepse kjo nuk na u ofrua, e i programeve investive të cilat u fol se duhet të kishin ardhë bashkë me buxhetin, d.m.th. të kemi një pasqyrë se ku do të shkojnë ato mjetë. Ato munguan edhe për ministritë që kanë investime të vogla edhe për ministritë, që kanë investime të mëdha. P.sh. Ministria e Transportit nuk i jep prioritetet se cilat rrugë do të ndërtohen dhe as cilat do të riparohen, ose kur flitet për bujqësinë dhe buxhetin e saj, ku mjetet nuk mjaftojnë, e me të dhënët mjafton shpjegimi i dhënë se shifra prej 1 milion e 457 mijë janë shpenzime kapitale, për çka dhe si do të harxhohen ato?. Por dihet se bujqësia pa këto mjetë nuk mund të ecë pikërisht, të ketë një zhvillim më të madh, kur dihet se popullata jonë 60% është popullatë rurale. Në pjesn rurale është pjesa më e varfër dhe jeton në varférinë më të skajshme, e ka mbi 16%, se papunësia është më e larta pikërisht këtu dhe njerëzit madje kanë humbë edhe interesimin që të paraqiten në tregun e punës nga pjesët rurale, se niveli i arsimimit është gjithashtu i ulët. Pikërisht ky sektor është njeri ndër sektorët nga të cilët pritet zhvillimi dhe hapja më e madhe e tregut të punës.

Një mosangazhim në bujqësi pikërisht do të thotë, moskuptim i politikës së zhvillimit, aq më tepër kur dihet se sa mjete harxon Kosova për importin e mallrave që mund të prodhohen dhe madje edhe të eksportohen nga Kosova.

Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, ajo mjete, pjesën më të madhe të buxhetit dhe mjetet e ndara prej gati 1/3 (një e treta) e mjeteve, -  $\frac{1}{4}$  e mjeteve ku pjesa më e madhe janë e subvencioneve transfere ,shpenzimet kapitale mbresin pikëpyetje, sepse nuk kemi shpjegime të mjaftueshme, cilat do të janë këto shpenzime kapitale, ndërsa shuma prej 89400-e ,sa jepen për pensionet bazike. Nuk dihet se këto pensione bazike a do të rriten apo jo? As pensionet për personat me paftësi, gjithashtu d.m.th. që hyjnë në këtë kategori, nuk rriten as në vitin e ardhshëm .Këto duhet të rriten.

Një shumë e konsiderueshme ndahet edhe për skemën sociale, mjete që nuk mundësojnë që të varfërit të dalin nga varfëria, por atyre nuk u mundësohet as të mbijetojnë me këto mjete që ndahan. Nga kjo pasqyrë e buxhetit nuk kuptohet se a do të fillojë aplikimi i ligjit për veteranët e luftës, invalidët, për familjet me persona të zhdukur, për viktimat civile, etj. as çka do të bëhet me pensionet, ose formimin e fondit pensional. A do të kemi plan nacional kundër varfërisë shumë të nevojshëm për momentin, si dhe a do të formohet planin nacional për hapjen e vendeve të punës për aftësimin ose riaftësimin, për punë. Në këtë draft nuk ka shpresë as në sektorin tanimë të elaboruar shumë herë, për mangësitë dhe kërkesat për dalje nga gjendja e rëndë e që është shëndetësia. Vërtet kjo ministri është e dyta për nga ndarja e mjeteve, mirëpo mjetet e ndara nuk kanë shpjegime se ku do të shkojnë. Shihet se shumica do të shkojnë për të ardhurat e punëtorëve, por në anën tjetër kur flitet për investime nuk ka shpjegime. Sa i përket shëndetësisë- sektorit primar, shëndetësor shihet se këtu mjetet nuk mjaftojnë në asnje mënyrë.

Në një vend ku sistemi primar shëndetësor është i zhvilluar, nuk ka nevojë për investime të mëdha, në sektorin sekondar dhe terciar. Kjo vetveti flet për mungesën e vizionit të politikës shëndetësore të Qeverisë. Në buxhetin e vitit të kaluar u ndanë mjaft mjete për agjensionin për ushqim dhe veterinë, mjete që u alokuan edhe sivjet, edhe pse ligji për agjensionin nuk është aprovar dhe për çudi këto mjete ndahan në linjen buxhetore të Ministrisë së Bujqësisë, ku nga 3 milionë e 109 mijë €, për shpenzime kapitale jepen 2 milion e gjysmë. Nuk dëgjojmë për reagimin e Ministrisë së Shëndetësisë, sepse me këtë rast nëse ky agjension futet në kuadër të bujqësisë, sikur është paraparë me mjetet e buxhetit, atëherë një sektor shumë i rëndësishëm i Ministrisë së Shëndetësisë, siç është inspekioni sanitari, duhet të kalojë tek bujqësia, që është e pakuptueshme.

Kur jemi te shëndetësia, për programet farmaceutike u ndanë 9 milionë e 50 mijë, por nuk dihet cilat janë këto programe, nuk dihet dhe nuk na është dhënë lista e qartë e barnave esenciale, a është zvogëluar kjo listë, a është zgjeruar, a hyjnë këtu edhe statikët dhe insulinë aq e këruar. Çka po ndodhë me mjetet për asgjësimin e barërave të shumtë, tanimë të grumbulluar, që u ka skaduar afati. A u ndanë mjete për specializime dhe për subspecializime të mjekëve të cilët duhet ta zënë hapin kaherë të humbur në sektorin e shëndetësisë?

Më lejoni edhe pak, në nivelin e kulturës, në një popull, niveli i kulturës së një populli dhe qëndrimi ndaj kulturës flet vetveti për nivelin e një shteti dhe sa mjete ndan një vend për këtë qëllim. Edhe kjo lëmi kërkon një debat të veçantë, sepse përpos kulturës në këtë

Ministri, përfshihet edhe kujdesi i rinisë, sporti dhe çështjet rezidente, që të cilave ne nuk po u kushtojmë rëndësinë e duhur dhe është sigurisht do të jetë vonë për këtë arsy.

Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit, vazhdon të menaxhojë mjete të mëdha të buxhetit, duke pasur edhe harxhime të mëdha, për ne shumë të panjohura. Në ndarjen e buxhetit të komunave, gjithashtu vërehet se nuk ka kriteri dhe politikë të zhvillimit të zbutjes së varfërisë. Komunat siç janë: Mitrovica, Shtimja, Lipjani, Malisheva, Skenderaj, Kaçaniku, etj. kanë buxhet sa një hotel i mesëm, e dihet shkalla e zhvillimit të këtyre komunave dhe dëme të mëdha të luftës. Mangësia e këtij drafti, pa dyshim, është mospasja e vizionit për të ardhmen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

Është i paraparë buxheti për bisedime, por jo edhe buxheti për institucionet e reja që i dihen një shteti të pavarur, jo edhe ..

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Ferid Agani, lë të përgatitet deputeti Bajrush Xhemajli.

**DEPUTETI FERID AGANI** – Ju faleminderit zotëri kryetar, të nderuar kolegë deputetë, i nderuari ministër, të nderuar ministra.

Të flasësh në këtë moment tash në lidhje me buxhetin, projksionin e buxhetit 2007 pas të gjitha këtyre diskutimeve, është në njëfarë mënyre rrezik, që të përsëritësh për shumë pika. Jam koshient për këtë, do të mundohem që, në fjalën time të përqendrohem në disa aspekte më specifike, në qoftë se mund të jap një kontribut. Për fat të keq edhe sivjet jemi duke u ballafaquar me një dokument buxhetor, i cili është e qartë i improvizuar dhe natyrisht se reflekton nevojat e një shteti të improvizuar, i cili është larg prej funksioneve të tij shtetërore. Një buxhet i cili synon zgjidhje të thjeshta dhe realizimin e ambicieve elementare, paaqet një buxhet të kontinuitetit të varfërisë së shoqërisë sonë, që siguron vetëm mbijetesën e sistemit të brishtë, të shërbimeve publike, që janë larg nevojave të qytetarëve, por afér nevojave të zyrtarëve vendorë dhe ndërkombëtarë, për të cilët është me rëndësi të dëshmojnë suksese, para njeri tjetrit, por jo edhe para qytetarëve.

Ky buxhet është shprehje e një qasje të skajshme tekno-burokratike, pa projekte reale zhvillimore, veçanërisht në sferën e skenave të reja financiare. Është befasuese se si në mënyrë të përsëritur nëpër vite, shprehet mungesa e ideve të mbështetura në rezultatet profesionale dhe shkencore, si dhe në përvojat e shteteve të tjera në situata të ngjashme. Ndërsa është ofenduese mungesa e guximit politik për të promovuar kësot idesh. Modelet e organizimit dhe të financimit të shërbimeve publike, në mënyrë shumë jo kritike janë përqafuar si modele të vetme dhe definitive dhe lidhur me to nuk është duke u bërë asnjë përpjekje, që të ndryshohen. Në vitet e kaluara po e shohim edhe në këtë dokument të projeksionit buxhetor.

Është interesant se si projektuesit dhe dizajnuesit e buxhetit, e kanë anashkaluar një fakt shumë evident, e këto janë resurset ekonomike financiare, të qytetarëve të Kosovës, të cilët jetojnë dhe punojnë në shtetet perëndimore. Ne e dimë se mbi një e katërtë e popullatës së Kosovës jeton dhe punon jashtë vendit dhe ka qenë njëra prej bartësve të aktiviteteve të cilat kanë mundësua mbijetesën e këtij populli, në periudhën e okupimit dhe në periudhën e pasluftës.

Këto resurse nuk merren parasysh fare, anashkalohen plotësisht në procesin e përpilimit të politikave fiskale dhe në negociatat në qoftë se ato ekzistojnë me faktorët ndërkombëtarë relevantë, nuk paraqiten si një adut, si një resurs ekonomik financiar i Kosovës.

Se sa është larg planifikimi buxhetor për vitin 2007, nga realiteti i nevojave të shoqërisë kosovare, unë do të përmendi vetëm disa shembuj nga sektori i shëndetësisë, u përmendën nga shumë kolegë deputetë, do të mundohem që të mos i përsëris. Buxheti prej 70 milion € për shëndetësinë kosovare, përfshirë këtu edhe grantin për shëndetësi, i cili u jepet komunave, bëhet fjalë për kujdesin parësor shëndetësor, e siguron një kontribut nga burimet publike prej 35 € për kokë të banorit. Kjo është sasia më e ulët, e cila ndahet për sektorin e shëndetësisë në të gjitha shtetet në rajon. Me këtë ndarje Kosova nuk mund as të imagjinojë, se do të ketë shërbime kualitative shëndetësore. Situatën po e shohim ajo çka bëhet dramatike punëtorët shëndetësorë janë aq të frustruar me zhvillimet e fundit dhe me ngjarjet e fundit që po i shohim, saqë me të vërtetë puna në këto institucione është bërë jashtëzakonisht e vështirë, si për punëtorët shëndetësorë ashtu edhe për shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore,

Tash unë shtroj pyetjen, Si mund ta përkrah një buxhet i cili e parasheh këtë nivel të financimit të shëndetësisë për vitin tjetër, i cili nuk jep asnje alternativë, posaçërisht në situatën ku alternativa ka ekzistua dhe atë prej vitit 2004. Është paraparë shumë mirë se prej 1. janarit me Ligjin për sigurime shëndetësore është paraparë se me 1 janar të vitit 2005, duhet të fillojë funksionimi i fondit për sigurime shëndetësore.

Ky fond ende nuk punon, nuk është as i themeluar, sepse ligji nuk është i miratuar. Unë shtroj pyetjen. Kisha pasë dëshirë me dëgjua përgjigjen, a ka ekzistua ndonjëherë një grup i punës i formuar ndërmjet Ministrisë, se Ekonomisë dhe të Financave dhe Ministrisë së Shëndetësisë, i cili do të negacione me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore rrëth nevojës për tejkalimin e problemeve dhe vështirësive për themelimin e këtij fondi. Sa jam unë i njoftuar ky grup kurrë nuk është themelua, Asnjëherë këto diskutime nuk janë zhvilluar në mënyrë serioze dhe për këtë arsy e kemi këtë situatë qe dy vite. Ky fond do të siguronte një ngritje të të hyrave private 25% si është kalkuluar, në vlerën e buxhetit të tanishëm për sektorin e shëndetësisë, që do ta zbuste pak situatën.

Se sa është larg planifikimi buxhetor nga nevojat reale të qytetarëve të Kosovës, flet e dhe fakti se p.sh. për shërbimet e shëndetit mendor të Kosovës, janë ndarë 936 mijë €. Kjo paraqet 1.3%, të buxhetit të shëndetësisë së Kosovës, në një vend i cili ka dalë prej një lufte të tmerrshme, në një vend i cili është i ballafaquar me pasoja të rënda të traumave psikologjike dhe psikike, pra në një vend i cili është larg prej standardit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, kur për shërbimet e shëndetit mendor do të ndahen rrëth 5%, të buxhetit të shëndetësisë në përgjithësi. Pra, këtu flitet edhe për mungesa serioze, në planifikim brenda Ministrisë së Shëndetësisë.

Gjetja e skenave të reja financiare, për sektorin e shëndetësisë, të cilat janë evidente në këtë projekcion të buxhetit të vitit 2007, nuk janë gjetë dhe nuk ekzistojnë, paraqet domosdoshmëri të kohës. Radhët e pacientëve kosovarë të cilët ja mësyjnë lartë e poshtë institucioneve të tjera shëndetësore, në Maqedoni, Serbi, Turqi, Shqipëri, janë me të vërtet ofenduese për punëtorët shëndetësorë nuk janë të nevojshme, mund të parandalohen, por për këtë nevojiten zgjidhje të reja dhe kreative. Ku dokument buxhetor ka dështuar që t'i japë këto zgjidhje. Ky dokument është vetëm përsëritje e dokumenteve paraprake dhe nuk e reflekton seriozitetin e situatës.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni – Kaloshi

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Ju faleminderit zotëri kryetar, përshëndetje për ju, për ministrat e pranishëm, për kolegët deputetë!

Ky projektligj për buxhetin 2007, mund të diskutohet, por vetëm në vija të përgjithshme. Vetëm në vija të përgjithshme buxhetore, e në asnjë mënyrë nuk mund të dimë se vërtet, për çka po ndahet ky buxhet, sepse mungon materiali. Për të konstatuar një gjë të tillë, u tha një mënyrë nga të tjerët, andaj edhe nuk mund të jepen ide, vërejtje, sugjerime konkrete se si të bëhet një ndarje më e mirë dhe një buxhet më efikas. Sidoqoftë që mund të marrim shembuj konkretë, p.sh., po e marrim ndarjen për Ministrinë e Energetikës dhe Minierave. Janë ndarë 2600 mijë €, për paga 360 mijë, për mallra dhe shërbime 954 mijë dhe shpenzime kapitale 1.2 milion. Prej krejt këtyre shifrave nuk besoj që dikush mund të konstatojë se realisht a thua është nda mirë a keq, po që janë nda për këtë Ministri po.

Për Ministrinë e Tregtisë e Industrisë ku janë nda 3.5 milion rrith 05, milion paga dhe mëditje, 850 mijë €, dhe 2.1 milion €, për shpenzime kapitale. Po të dija se në çfarë vije, brenda Ministrisë janë nda besoj se kisha dhënë sugjerime. P.sh. zoti ministër Dugolli mua shumë më intereson, me ditë p.sh., sa mjete janë nda për inspektoratin e tregut apo për të gjitha inspekcionet që ka Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, janë shumë të rëndësishme dhe që ju e dini çfarë gjendje keni. Në këtë aspekt d.m.th. të financimit, apo sa është ndarë për mbrojtjen e konsumatorëve. Ne po monitorojmë një projektligj për mbrojtjen e konsumatorit dhe faktikisht konsumatori nuk mbrohet fare. Mund të them lirisht se deri sot sa është mbrojt dhe një ndër çështjet pse nuk është mbrojt është edhe çështja financiare. Po tani ku e di unë sa janë nda, a janë nda më shumë a më pak a.., sa nevojitet etj.. E mora veç një segment, desha të them, se prej këtij raporti absolutisht nuk mund të konstatohet bashkurgja konkrete.

Në vija të përgjithshme mund të flasim sa të domë. Unë fola edhe këtu shumë mendoj, bile pak në të përgjithshmen është folë tepër, por nuk kemi të tjera pasqyra. Unë për veti nuk kam. Për këto dy ministri dhe për Ministrinë e Transportit që kisha pasë dëshirë të flas, nuk kam mundësi se nuk ka të tjera shifra. Jonë transportit ashtu diçka, janë dhe nuk kemi çka të flasim. Po në mënyrë përgjithësuese mund të flasim edhe megjithatë diçka dua të them dhe ajo çka më së shumti më shqetëson është se, totali i shpenzimeve buxhetore në organizatat buxhetore të nivelit qendror. Ku janë ndarë 553 milionë, dhe atë vetëm përfuqi të rezervuara, janë nda 209 milion. D.m.th. ajo pjesa e luanit, e ndajë ata që edhe janë, që nuk na pyesin fare, faktikisht për buxhet na i kanë lënë do pjesë ashtu të kujdesemi pak ma kështu, ashtu, po pjesën e luanit, e marrin ata, edhe atë rrith 40% nga organizata buxhetore e nivelit qendror, dhe këta i kanë nda ashtu qysh ua ka marrë mendja, e ma merr mendja që andej kah mund të ketë ndonjë interes, besoj.

Për energjinë p.sh. është 76 milionë, është thënë për energjinë nuk do të ndahan më para. Megjithatë i është nda gjatë këtij viti si borxh, unë nuk besoj që ua ka kthye atë borxh juve dhe prapë ua keni nda 76 milion. Është e çuditshme që këtu hudhen para në baltë do të kisha thënë, se në vend që këto para me një menaxhim të mirë, me një organizim të mirë të Qeverisë, ishin mbledhë në mënyra të tjera që duhet të mblidhen, prej konsumatorëve, kjo nuk është bë, dhe tash këtu hudhen 76 milion, po për Trepçën vetëm 6 milion, fik sa janë

nda vjet. Kopje, 6 milion për vjet 6. milion sivjet, as vjet nuk kanë mjaftua as sivjet nuk mjaftojnë.

Çështja shتروhet pse, janë nda kaq pak para? E kam thënë në raste të tjera, po dua ta them këtu në Parlament, se këtu e kanë vendin edhe disa gjëra, në Trepçë është duke u penguar puna, madje është duke u sabotuar, është duke u sabotua fort, me qëllim, ka çështje të caktuara që donë ta qesin në dy gjunjët, dhe thjeshtë ta rrëzojnë për tokë që kujt mos t'i' vyen dhe të themi siç po themi për disa gjiganten të tjera, që kemi thënë, hajt po i qesim në privatizim. se i merr dikush e ndoshta fitojmë ndonjë send ne e tj.

Këtu unë pashë që për paga dhe mëditje në Trepçë nuk ka as një €. Pse është bë, edhe për këtu është thënë që nuk do të ndajmë më, se Trepça duhet të mbetet mbi këmbë të veta vetë. Po ju as më elementare si Qeveri nuk i keni krijuar mundësinë për me qenë në këmbë të veta Trepça, juve ju ka thënë UNMIK-u qashtu, dhe nuk e keni ngritë zërin asgjë. Në këtë drejtim absolutisht asgjë nuk e keni ngritë zërin. Edhe ju që jenë në bord të AKM-së, që jeni tre ministra mos gabofsha, apo sa jeni, bile e kemi provuar që ka me ardhë një administrator që do me ia vu çelësin, drynin Trepçës edhe fund, edhe ju e keni aprovua, do në heshtje, do bile edhe jeni deklarua. Këtu është problemi pse po punohet me dy kute. Pse është thënë që nuk do të jepim për energji dhe jepen dhe nuk jepen pak, por 76 milion që me ja pas dhënë Trepçës vetëm gjysmën, Trepçëa jo që do të dilte rentabile, po sigurisht që në vitin tjetër na kishte pru 76 milion që po i qesim aty. Po kjo dihet ata që pak e dinë matematikën e thjeshtë, jo atë matematikën e lartë që është, po të thjeshtë besoj që ju del kjo llogari që po ju them unë. Po kjo bëhet me program dhe programin si Qeveri, mirë janë duke e çuar për falimentim.

Këtu nuk dua të ndalem se edhe ashtu jam i lodhur mjaft por ka edhe gjëra të tjera janë të çuditshme, edhe natyrisht joprofesionale, ta zëmë këtë tabelën 1. që është, nën 5. bilansi bankar i vlerësuar i vitit 2007. Ju mund të më ndihmoni zoti ministër, po disi e keni programua që kanë me iu teprua një 75 milion. A është ashtu, e meqë është ashtu, mbasi e keni programua këtë suficit që ka me ju dalë, po pse nuk i keni bërë mend ku me e shti, po të teprojnë. Kjo është, s'e di cila logjikë ekonomike e rrok këtë. Na jemi duke programuar qysh ta bëjmë këtë punë, qysh t'i harxhojmë dhe si të teprojnë, e t'i mbajmë në xhjep, sikur do plaka këtyre herë, ose në palë për qefin apo ku e di unë çka i kanë lënë përpara në shervete. Me këto pasqyra zoti ministër, që këtu i keni prurë, në qoftë se doni ju, ta bëni shqyrtimin e dytë, absolutisht nuk do të mund ta bëjmë nëpër komisione.

Komisioni jonë funksional ka thënë, që do ta shqyrtojmë, edhe pse nuk jemi për buxhet, po jemi për ekonomi, tregti, industri etj. do ta bëjmë një shqyrtim. Unë qysh tan po them si nënkyetar komisioni, unë nuk di se si kam me shqyrtua më tutje, se nuk kam kurfarë tabele, shqyrtimin më të madh që këtu po ia bëjmë se nuk ka më tjetër. Lirisht mos e çoni më tutje se është më mirë me me e kthye prapë dhe me i pru ato pasqyra, masandej me e shikua me të vërteta është për me shkua më tutje. Absolutisht nuk kemi çka të shkojmë më tutje, pa i pasë pasqyrat e tjera. Ju faleminderit!

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputetja Nafije Berisha dhe kandidati i fundit është.

**DEPUTETI HYDAJET HYSENI** – Ju faleminderit zoti kryetar, zonja e zotëri deputet!

Në këtë periudhë, në këtë fundviti çdo parlament shqyrton e debaton buxhetin, por vetëm Parlamenti ynë e shqyrton buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Shtrohet pyetja çka do të thotë kjo buxhet i konsoliduar dhe a është vërtet i konsoliduar zoti ministër?, Po të ishte i konsoliduar zor se do të quhej kështu, por një gjë me gjithatë duhet pranuar, nëse ka qenë synimi për të bërë një propozimbuxheti të mbështjellë, për të na e mbështjellë pak me gazetë siç thonë dhe për të na e bërë të pamundurën që ta shqyrtojmë si duhet mund të them që keni qenë plotësisht të suksesshëm. Jo vetëm që duhet lexuar me thjerrzë, zoti ministër, por kështu siç na e keni dërguar propozimin, pa shpenzimet kapitale, pa tabelat krahasuese me vitin paraprak, kurse në buxhetin e një viti më parë, ato ishin, pa e shqyrtuar madje as raportin e shpenzimeve të këtij viti. Ne praktikisht jemi vënë në situatën që të flasim, por pa mundur që të bëjmë një vlerësim të duhur e të përgjegjshëm. Edhe mua më ka bërë përshtypje ai planifikimi i suficitit që vazhdimit po na përsëritet, edhe nuk u konsolidua kjo çështje. E kam pasë dëgjuar një tezë se duhet të planifikohet deficit buxhetor. Unë i quaj të rrezikshme këto ndërhyrje dhe lojëra, qoftë me suficit, qoftë me deficit buxhetor.

Për më tepër për mua mbetet shqetësim serioz çështja e ashtuquajtur dhe fonde për shpenzimet e paplanikuara që janë paushalle dhe për më tepër një prej tyre është rezervë për statusin. Propozimi është bërë në fillim të nëntorit. Do të duhej të ishte përgatitur më herët, pyesim përfaqësuesit e Qeverisë, e keni ditur ju që po shtyhet statusi edhe për vitin 2007, apo, pse nuk na e keni thënë atëherë ju lutem. nejse...

Mirëpo shtrohet çështja si janë shpenzuar mjetet e parapara për fonde të pa planikuara, a janë planifikuar pastaj ato, me gjithatë një përgjigje të tillë nuk e kemi marrë, e presim zoti ministër, janë me gjithatë miliona, Mua po ashtu më ka bërë përshtypje dhe dua të vë theksin te një debalans paradoksal, që vihet midis, në trajtimin e subjekteve buxhetore, për të mos shkuar më shumë po tërheq vërejtjen deputetëve në trajtimin ta zëmë që u bëhet disa bordeve, zyrave të pavarura, komisioneve të pavarura, krahasoni shifrat ju lutem, dhe krahasoni po e zëmë me këshillin gjyqësor, drejtësi., Në drejtësi nëse nuk më gënjejnë shifrat shumë të ngatërruara, është ulur shuma e paraparë për diku 2 milion, kurse janë shtuar diku tjetër, kur se buxheti për këshillin gjyqësor që është pushtet i tretë, është qesharak zotëri. Praktikisht e pamundëson funksionimin e degës së tretë. Ju e dini çka do të thotë për Kosovën e re sundimi i ligjit dhe i ashtuquajturi pushtet i tretë, dega e tretë. Çka do të thotë edhe për balansin midis pushtetit.

Nuk është paraparë zonja e zotërinj asnjë zgjidhje për problemet që janë paralajmëruar për t'u zgjidhur siç është çështja e zgjidhjes me ligj, të padrejtësive të sistemit të mëparshëm të drejtësisë. Janë diku mbi 30 mijë të burgosur politikë , që presin më në fund trajimin adekuat, si gjithë bota. Kosova nuk ka bërë asgjë për ta, nuk na takon vetëm ne, që ta ngrehim çështjen e padrejtësisë që është bërë. Ministria për Punë dhe Çështje Sociale ka paralajmëruar se do të jetë ligji i parë që do të përgatitet, nuk u bë. Do të thuhet përsëri nuk ka mjete, për më tepër i nxirren pengesa edhe funksionalizimit të Ligjit për kategoritë e luftës. Presim përgjigje nga përfaqësuesit e Qeverisë.

Ju keni paraparë përsëri 3 milion, avans për Përfaqësuesin Special, 3 milion kanë qenë paraparë edhe vitin e kaluar, kurse është paralajmëruar se mandati i UNMIK-ut do të jetë i shkurtër, apo jo, si shpjegohet kjo? Në raportin që kemi për 9-mujorin pashë një shifër se janë shpenzuar diku 2. milion e diçka, për Përfaqësuesin Special, pse tash parashikohen 3 milion avans dhe çka do të thotë kjo në procesin e transferit të kompetencave të tjera? Për mua ka rëndësi po ashtu të madhe, pjesa e buxhetit të Kuvendit të Kosovës, më duhet ta

përsëris atë që e kam theksuar edhe ndonjëherë tjetër. Kuvendi i Kosovës duhet të japë shembullin e hartimit të rregullt të buxhetit, shpenzimin transparent dhe të rregullt të buxhetit të tij dhe metodologjisë së rregullt të ndërtimit të buxhetit. Megjithatë ky Kuvend, ende nuk është ngritur në këtë nivel, për pasojë ju e dini ne shpesh dëmtojmë punën e Kuvendit, sidomos të komisioneve për disa nevoja elementare për të cilat nuk gjinden mjete, nuk paska para, kurse në fund na ndodhin para, ashtu që taprojnë shuma të mëdha parash që nuk e di pastaj çka bëhet në fund të vitit.

Unë prandaj nëse mund t'i lidh të gjitha këto çështje, insistoj që shqyrtimi i sotëm të jetë vetëm hapje e debatit. Angazhohem për një debat të gjerë, të plotësuar me informacione që këtu po mungojnë, për hapje të debatit publik, në shoqërinë kosovare dhe buxhetin ta bëjmë duke sintetizuar edhe qëndrimet, propozimet dhe kërkesat e të gjitha segmenteve të shoqërisë kosovare, tek atëherë buxheti ynë do të mund të ishte i konsoliduar dhe kur të jetë vërtet i konsoliduar, mendoj nuk ka nevojë të quhet më buxhet i konsoliduar. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, Fjalën e ka deputetja Nafije Berisha, kandidati i fundit që është paraqitë për diskutim.

**DEPUTETJA NAFIJE BERISHA** – Ju faleminderit zoti kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra që jeni prezentë, të nderuar kolegë deputetë!

Unë nuk do të bëjë një debat, por vetëm do t'ua shtroj një pyetje jo vetëm ministrit të Financave, po kisha pasë dëshirë që të jenë këtu edhe kryeministri, edhe zëvendëskryeministrin, ndoshta komplet krejt Qeveria.

Me këtë buxhet të cilin na e keni dhënë, në këtë formë të shkruar zotëri ministër i Financave, çka mendoni Ju, se sa ky projekt-buxhet garanton ose në një farë mënyre siguron, një qetësi sociale, në pjesën e dytë të vitit 2007, se po e llogaris që në pjesën e parë do të merremi me pavarësinë edhe me krijimin e shtetit. Atëherë unë u mundova ta analizojoj, ta shtjelloj por, nuk i gjeta parametrat të cilët do të siguronin një qetësi sociale. Nuk më pëlqen përgjigja se një përqindje mjaft e madhe e këtij buxheti shkon për çështjet sociale, për shkak se kam pritë që ky buxheti në një farë mënyrë të riformohet, të riorganizohet, sepse në këtë mënyrë në të cilën është plotësish i ppaqëndrueshëm dhe vështirë i mbuluar me këtë buxhet të cilin e ka Kosova. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, meqenëse nuk ka të tjerë të interesuar për diskutim ia jap fjalën ministrit nëse ka diçka, urdhëroni zoti ministër!

**MINISTRI HAKI SHATRI** – Ju faleminderit zoti kryetar, të nderuar deputetë, Unë dëgjova me vëmendje diskutimet e juaja dhe do të them që respektoj shumë mendimet e juaja, por nuk them dot se pajtohem me të gjitha ato.

Shumica e pyetjeve që janë bërë dhe e çështjeve që janë shtruar si diskutim, mendoj që përgjigjen e kanë në vetë materialet, në qoftë se lexohet materiali. Po ashtu, nuk e konsideroj të nevojshme të përgjigjem në çështjet që nuk kanë të bëjnë me dokumentin që po e shqyrtojmë dhe për të pasë ju në konsideratë situatën time gjatë këtij diskutimi, po ju tregon vetëm një rast që është shumë simbolik, por që tregon shumë. Njëri nga diskutuesit në këtë Kuvend sot, i cili ka kërkuar që me çdo kusht të ngritten taksat përbizneset, me qëllim që të plotësohen shumë nevoja publike të qytetarëve të Kosovës, një herë përmes një

ndërmjetësimi ka ardhë tek unë dhe ka kërkua që, për subjektin që menaxhon, t'i zbriten taksat dhe ngarkesat fiskale.

Tani dëshiroj që në disa pyetje parimore shkurt të përgjigjem, sepse ato kanë të bëjnë me materialin dhe janë shumë esenciale për punën e mëtejshme të trupave të Kuvendit. Në pyetjen e zotit Kosumi se si mbulohen 34 milion deficit të projektuar, unë përgjigjem që: deficiti i projektuar për vitin buxhetor 2007, do të mbulohet nga rezerva e keshit e Qeverisë e cila aktualisht është 105 milion dhe pas mbulimit të deficitit do të mbetet 75 milion. Kjo rezervë për institucionet e Kosovës është një shumë parash e domosdoshme, që të mbetet si rezervë për funksionimin normal në vazhdimësi të institacioneve të shtetit. Kurse në qoftë se dëshirojmë që të jemi edhe pak më të relaksuar, atëherë them, këta që shpresojnë me marrë pushtetin pas këtij mandati u vyejnë 105 milion, nëse mbeten rezerva. Është një çështje tjetër që është shtrua këtu, për buxhetet e kuvendeve komunale, Të nderuar deputetë! Kompetent për nxjerjen e buxheteve komunale janë vetë kuvendet komunale dhe Qeveria vetëm i siguron grantet për kuvendet komunale. Kriteret për ndarjen e granteve komunale nuk i cakton Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, por Komisioni i granteve, në të cilin hyjnë tre kryetarë komunash, nga të cilët njeri është nga pozita, njëri nga opozita dhe njeri është nga komunitetet.

Dëshiroj që zotériut nga Kamenica, i cili bëri shumë vërejtje në buxhetin e komunës së Kamenicës, t'i them që komuna e Kamenicës hyn në grupin e komunave që nuk e kanë aprovuar buxhetin për vitin 2007, e që nuk i kanë respektuar kufijtë e përcaktuar të limiteve dhe kjo d.m.th. bashkë me katër komunat të tjera hyn në grupin e komunave të cilat bëjnë pjesë edhe Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, dhe unë në fjalën e hyrjes, prezantova që, na nuk kemi mundësi ligjore që këtyre komunave t'ua lëshojmë mjetet e propozuara deri sa këto komuna të aprovojnë buxhetet e tyre, sepse është rregull ligjore që komunat duhet t'i aprovojnë buxhetet e tyre.

Diçka që vlen të përmendet këtu, që me meritë është diskutuar, janë politikat fiskale. Unë ju them që buxheti i këtij viti, pra buxheti i vitit 2007, është përpiluar dhe përgatitë në bazë të ligjeve në fuqi, sepse ne nuk mund të nxjerrim buxhet në bazë të ligjeve që do të nxirren, por po ju them me përgjegjësi, jemi në kontakt me asociacionet e biznesit, me strukturat profesionale dhe po i diskutojmë. Kemi grupe punuese për të ndryshua politikat fiskale në vazhdimësi dhe këto janë veprime konkrete që po i bëjmë.

Pyetjes se a do të ketë rritje të pagave në sektore të veçantë, them, në bazë të këtij propozimbuxheti, nuk do të ketë rritje nominale të pagave për asnjë sektor. Ju e keni pa, shuma e pagave ka mbetë gati në nivelin e vitit 2006 dhe kjo nënkuption që nuk do të ketë rritje të pagave, përvèç asaj mase të vogël që kemi mbështet sigurimin e mjeteve për kujdestaritë në Qendrën Klinike Universitare.

Sa i përket AKM-së, është shtruar si dilemë d.m.th.me të drejtë dhe pa dashtë me diskutua shumën e rekomanduar, sepse ajo shumë po investohet në një sferë që, Qeveria ka më prioritet në energetikë, por dyshime se këto mjete a shpenzohen sipas kriterieve të caktuara? Edhe Qeveria iu ka bashkuar dhe ka kërkua nga Auditori Gjeneral që të bëjë një auditim të përgjithshëm, që është aprovuar edhe nga bordi i AKM-së dhe ky auditim ka filluar të bëhet në AKM. I presim rezultatet e raportit e auditorit gjeneral.

Edhe diçka përfundet dhe po e përfundoj. Fondet të cilat po përmenden dhe të cilat thuhet se janë pengesë ligji, ka një dilemë esenciale, Në qoftë se na kërkojmë të ndërtojmë fonde nga burimet të cilat ndajnë mjete nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, nuk janë kurrfarë ndyshimi kualitativ, por është vetëm një ndryshim formal i cili ja mundëson një sektori të caktuar të menaxhojë atë pjesë të buxhetit pa i pyetur Qeverinë dhe Kuvendin, prandaj kjo nuk është shumë punë që do të ishte dashtë të përkrahet pa siguruar burime ekstra, që nuk prekin burimet aktuale të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Në fund, kisha dasht meiu kërkuar falje por ndoshta, në mungesë të kohës për t'u përgjigj në ndonjë pyetje që meriton të përgjigjem, na jemi në dispozicion, që në periudhën deri në leximin e dytë, Ministria e Financave komplet është në disponim të Kuvendit, dhe trupave të tij, të jemi çdo ditë bashkë me ju dhe t'ju mundësojmë çdo shënim që i duhet deputetit, për të marrë vendim lidhur me këtë dokument na do t'ia bëjmë të mundur me e pa dhe do t'ia vëmë në dispozim, qoftë këtu në Kuvend, qoftë brenda në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave. Edhe një herë ju bëj që këtë dokument ta miratojmë sot në parim, të fusim në shqyrtim nëpër komisione dhe ta nxjerrim dokumentin e buxhetit para përfundimit të këtij viti. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, ndërkohë u paraqiten edhe dy kandidatë. Unë mendoj se pas fjalës së ministrit nuk ka nevojë të merrni fjalën dhe duhet ta përfundojmë këtë. Ftoj deputetët dhe regjinë që të përgatitemi për votim, Votojmë ligjin e miratojmë në parim. Në sallë i kemi 84 deputetë, votojmë tash:

PËR .....	50
KUNDËR.....	26
ABSTENIME.....	0

Ju faleminderit për kontributin që keni dhënë. Me kaq përfundon seanca plenare.